



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në subjektin Bashkia Vorë**

## **RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**Auditim Financiar**

**Tiranë, mars 2025**

| <b>NR.</b> | <b>PËRMBAJTJA</b>                                                                                                                                                                                                                                                                    | <b>FAQE</b>   |
|------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|
| <b>I</b>   | <b>PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE</b>                                                                                                                                                                                                                                                        | <b>4-8</b>    |
| 1.         | Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit                                                                                                                                                                                                                                        | 4-5           |
| 2.         | Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve                                                                                                                                                                                                                                      | 5-7           |
| 3.         | Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit                                                                                                                                                                                                                                  | 7-8           |
| <b>II</b>  | <b>HYRJA</b>                                                                                                                                                                                                                                                                         | <b>8-14</b>   |
| 1.         | Objektivat dhe qëllimi                                                                                                                                                                                                                                                               | 9-9           |
| 2.         | Identifikimi i çështjes                                                                                                                                                                                                                                                              | 9-9           |
| 3.         | Përgjegjësitë e strukturave drejtuese                                                                                                                                                                                                                                                | 9-10          |
| 4.         | Përgjegjësitë e audituesve                                                                                                                                                                                                                                                           | 10-10         |
| 5.         | Kriteret e vlerësimit                                                                                                                                                                                                                                                                | 10-12         |
| 6.         | Standardet e auditimit                                                                                                                                                                                                                                                               | 12-12         |
| 7.         | Metodat e auditimit                                                                                                                                                                                                                                                                  | 12-13         |
| 8.         | Dokumentimi i auditimit                                                                                                                                                                                                                                                              | 13-13         |
| <b>III</b> | <b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>                                                                                                                                                                                                                                                        | <b>14-101</b> |
| 1.         | Informacion i përgjithshëm mbi subjektin                                                                                                                                                                                                                                             | 14-14         |
| 2.         | Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit                                                                                                                                                                                                                                | 14-14         |
| 2.1        | <i>Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik</i>                                                                                                                                                                                                                           | 14-22         |
| 2.2        | <i>Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit</i>                                                                                                                                                                                                       | 22-64         |
| 2.3        | <i>Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.</i> | 64-83         |
| 2.4        | <i>Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave Kullotave) të transferuara sipas VKM.</i>                                                                                                                   | 83-88         |
| 2.5        | <i>Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.</i>                                                                                                                                                                                                        | 88-98         |
| <b>IV</b>  | <b>REKOMANDIME</b>                                                                                                                                                                                                                                                                   | <b>98-117</b> |

## SHKURTIME

|                |                                                                 |
|----------------|-----------------------------------------------------------------|
| <b>AAJM</b>    | Aktive Afatgjata Jo Materiale                                   |
| <b>AAM</b>     | Aktive Afatgjata Materiale                                      |
| <b>AQT</b>     | Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara                             |
| <b>ASHK</b>    | Agjencia Shtetërore e Kadastrës                                 |
| <b>FZHR</b>    | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve                                  |
| <b>GMS</b>     | Grupi i Menaxhimit Strategjik                                   |
| <b>IFAC</b>    | Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve                         |
| <b>INOTSAI</b> | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit  |
| <b>IPSAS</b>   | Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik   |
| <b>ISA</b>     | Standardet Ndërkombëtare të Auditimit                           |
| <b>ISSAI</b>   | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit |
| <b>IT</b>      | Teknologjia e Informacionit                                     |
| <b>KLSH</b>    | Kontrolli i Lartë i Shtetit                                     |
| <b>MAB</b>     | Manuali i Auditimit të Brendshëm                                |
| <b>MFE</b>     | Ministria e Financës dhe Ekonomisë                              |
| <b>MFK</b>     | Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli                               |
| <b>NA</b>      | Nëpunës Autorizues                                              |
| <b>NJA</b>     | Njësi Administrative                                            |
| <b>NJAB</b>    | Njësia e Auditimit të Brendshëm                                 |
| <b>NZ</b>      | Nëpunës Zbatues                                                 |
| <b>PF</b>      | Pasqyrat Financiare                                             |
| <b>QKB</b>     | Qendra Kombëtare e Biznesit                                     |
| <b>SH.A</b>    | Shoqëri Anonime                                                 |
| <b>SH.P.K</b>  | Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar                              |
| <b>SKK</b>     | Standardet Kombëtare të Kontabilitetit                          |
| <b>UMF</b>     | Udhëzim i Ministrisë së Financave                               |
| <b>VKB</b>     | Vendim i Këshillit Bashkiak                                     |
| <b>VKM</b>     | Vendim i Këshillit të Ministrave                                |

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit**

#### **a. Përshkrim mbi institucionin dhe një informacion mbi buxhetin:**

Bashkia Vorë, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Në Raportin e Monitorimit për Buxhetin e vitit 2023 të datës 13.02.2024, të dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, janë evidentuar parashikimi sipas PBA 2023-2025, buxheti fillestar 2023, buxheti i rishikuar 2023 dhe realizimi i buxhetit 2023.

a. Për vitin 2023, nga Bashkia Vorë shpenzimet janë realizuar në masën 73%, ku nga vlera e planifikuar prej 1,748,708 mijë lekë, është realizuar vlera 1,275,699 mijë lekë, nga të cilat:

a. Shpenzime për investime në vlerën 470,000 mijë lekë; shpenzime operative në vlerën 514,044 mijë lekë; shpenzime për paga dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 291,254 mijë lekë.

b. Për vitin 2023, të ardhurat tatimore janë realizuar në vlerën 390,141 mijë lekë dhe të ardhurat jotatimore janë realizuar në vlerën 18,823 mijë lekë.

#### **b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij**

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Vorë krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt kontrolli nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

#### **c. Qëllimi i auditimit**

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, për periudhën e aktivitetit 01.01.2023-31.12.2023, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t'i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Organizimi dhe vlerësimi i veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm.
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.
- Auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

#### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave**

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të

auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin.* Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 20,179 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik, Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët, Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.*

## **e. 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve**

*Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:*

\* Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të Bashkisë Vorë, u konstatua se planifikimi fillestar i buxhetit për zërin shpenzime nga vlera 1,748,708 mijë lekë të planifikuara është realizuar në vlerën 1,275,699 mijë lekë ose 73%, për shkak të mos analizimit të të ardhurave.

\* Situata financiare e Bashkisë Vorë, sipas të dhënave të shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 dhe gjendjes së faturave të palikuidura në fund të periudhës ushtrimore, paraqitet në nivelin 34.67% të shpenzimeve vjetore të miratuara, të dhëna të cilat tregojnë se kjo bashki është në gjendjen e vështirësisë financiare.

\* Të ardhurat në total nga administrimi i taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023, u realizuan në shumën **408,964 mijë lekë** ose në **masën 72.34%**, duke shkaktuar pamjaftueshmëri burimesh financiare për likuidimin e shpenzimeve të parashikuara, me ndikim në shtimin e stokut të detyrimeve të prapambetura. Për vitin buxhetor 2023, të ardhurat e parealizuar janë në vlerën **156,336 mijë lekë** kundrejt me parashikimin vjetor prej 565,300 mijë lekë.

\* Bashkia Vorë për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023 nuk ka dërguar për kontabilizim në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, listat me detyrimet e pa paguara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë: për Bashkinë Vorë në vlerën 1,226,188 lekë; për Njësinë Administrative Bërxullë në vlerën 1,141,617 lekë dhe për Njësinë Administrative Prezë në vlerën 524,469 lekë; **në total 2,892,273 lekë;**

\* Detyrimi tatimor në Bashkinë Vorë rezultoi në vlerën 376,288,910 lekë deri 31.12.2023, kundrejt vlerës 302,825,456 lekë, të raportuar nga Bashkia Vorë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve në vlerën 46,244,026 lekë, si dhe mos raportimi për detyrimet e prapambetura që i përkasin periudhës 2004 - 2020 në vlerën 27,219,428 lekë, në total **73,463,454 lekë**, nuk paraqet situatën reale të debitorëve.

\* Nga auditimi i Llogarisë nr. 401-408 *"Furnitorë e llogari të lidhura me to"* u konstatua se Drejtoria e Menaxhimit Financiar nuk ka likuiduar faturat e viteve 2006 - 2020, për vlerën **11,506,064 lekë**, ndaj disa furnitorëve të cilët nuk i kanë ofruar Bashkisë Vorë, shërbimet dhe produktet në përputhje me kontratat e nënshkruara. Këto fatura nuk duhej të kontabilizoheshin në sistem, e të njiheshin si detyrime të Bashkisë Vorë, për aq sa nuk janë kryer furnizimet sipas kontratave të nënshkruara mes palëve. Gjithashtu, kryerja e pagesave me vonesë nga Bashkia Vorë, në shlyerjen e detyrimeve kontraktore e ekspozojnë njësinë ndaj risqeve gjyqësore.

\* Nga auditimi i Llogarisë nr. “467 “Kreditorë të ndryshëm” në listën analitike të kreditorëve të Bashkisë Vorë, për vlerën totale prej 363,290,371 lekë, rezultoi 1 subjekt me emër, datë dhe vlerë detyrimi të njëjtë, në total 888 mijë lekë. Gjithashtu, vlera 60 mijë lekë nuk ka destinacion subjekti apo individ i kreditor. Për pasojë vlera e kësaj llogarie, nuk paraqitet e saktë në bilancin e vitit 2023, si dhe rrit në mënyrë artificiale detyrimet e prapambetura të Bashkisë Vorë.

\* Nga pasuritë e transferuara në Bashkinë Vorë, 121 janë të pajisura me certifikatë pronësie, 93 pasuri janë të pajisura me certifikatë përdorimi dhe 455 pasuri nuk janë pajisura me certifikatë pronësie. Nga auditimi u konstatua se inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuara, nuk përbënin një pasqyrë reale të gjendjes faktike të tyre, për shkak se nga ana e Drejtorisë së Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës nuk është rakorduar me Zyrën Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë.

\* Nga auditimi u konstatua se subjekti “A D” sh.p.k, i cili ka lidhur kontratë me afat 99 vite, me sipërfaqe 9,240 m<sup>2</sup>, nuk e kishte paguar detyrimin për periudhën 2016-2023, në vlerën **7,921,949 lekë**, e cila përfshin qira vjetore 2,653,361 lekë, qira ndërtese 4,424,940 lekë dhe qira trualli 843,648 lekë.

### **Rekomandimet kryesore**

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

\* Kryetari i Bashkisë Vorë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të theksuara midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të marrin masa për saktësimin e hartimit të tij, mbështetur në realizimet e mëparshme dhe mundësitë objektive të të ardhurave dhe shpenzimeve, për të vijuar me analiza periodike të veprimtarisë për realizimin e buxheteve, për të siguruar buxhete reale në shërbim të qytetarëve.

\* Grupi i Menaxhimit Strategjik, të marrë masa për hartimin e metodologjisë për parashikimin e të ardhurave vendore bazuar në faktorët përkatës, duke identifikuar dhe vlerësuar kontrollin e risqeve që cenojnë arritjen e objektivave për realizimin e të ardhurave të planifikuara.

\* Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të vlerësojnë, analizojnë dhe nxjerrin përgjegjësitë për taksën mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj, për mos përditësimin e të dhënave të regjistrimit të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme me të dhënat e regjistrimit elektronik të pasurisë (Kadastra Fiskale) për të definuar individët, personat fizikë ose juridikë që i nënshtrohen taksimit/përrjashtimit për këtë kategori taksapaguesish.

\* Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik në Bashkinë Vorë, të marrin masa në ndjekjen e të gjitha hapave administrative e ligjore, për të arkëtuar vlerën prej **7,921,949 lekë** nga subjekti debitor “A D” sh.p.k.

\* GMS të marrë masa për uljen e stokut të detyrimeve të prapambetura nga mos pagesa e tarifave dhe taksave vendore nga subjekte fizike, juridike dhe familjare, në vlerën 376,288,910 lekë, të krijuar deri 31.12.2023, duke aplikuar në mënyrë shteruese masa shtrënguese të tilla, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokimi i shitjes së aktiveve në QKB, si dhe rritur informimin dhe sensibilizimin publik mbi pagesën e tyre në dobi të komunitetit.

\*Kryetari i Bashkisë Vorë të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse mbi menaxhimin e detyrimeve të prapambetura, ndaj kreditorëve. Drejtoria e Menaxhimit Financiar të marrë masa në saktësimin e kreditorëve dhe vlerave kreditore pa adresë, ndaj Bashkisë Vorë. Të kryejë kontabilizimin e duhur të Llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”,

për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm, si dhe të vazhdojë me likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

\* Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe drejtoritë e tjera që administrojnë të ardhurat vendore, të marrin masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pashlyera nga të ardhurat vendore, të krijuara për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, në vlerën 46,244,026 lekë dhe raportimin e stokut të trashëguar për detyrimet e prapambetura që i përkasin periudhës 2004-2020, në vlerën 27,219,428 lekë, në total **73,463,454 lekë**;

\* Këshilli Bashkiak Vorë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për shërbimet kontraktore ndërmjet institucionit dhe furnitorëve. Kryetari i Bashkisë Vorë të marrë masa që për çdo shërbim kontraktual i cili kryhet për nevoja të institucionit, personat përgjegjës të ndjekin të gjithë procedurat ligjore të marrjes në dorëzim të mallit me lënien e gjurmës së auditimit.

\* Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Bashkinë Vorë, të marrë masa të menjëhershme dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK të pasurive pa certifikatë pronësie dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, të përllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

### I.3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit

#### OPINIONI I AUDITIMIT

##### **Për drejtimin e Bashkisë Vorë mbi auditimin e pasqyrave financiare:**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Vorë, për periudhën ushtrimore 01.01.2023 - 31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në aktiveve neto/fondet neto, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare, si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

*Sipas opinionit tonë, bazuar në evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të **modifikuar** për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Vorë, duke arritur në përfundimin se anomalië apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura në llogaritë vjetore të vitit 2023, të shprehura në bazën për opinion.*

##### **Baza për opinionin e modifikuar<sup>1</sup>:**

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti Bashkia Vorë, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme bazuar në opinionin tonë.

Opinionin e modifikuar e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve

<sup>1</sup> **Opinion i modifikuar:** Audituesi duhet të shprehë një opinion të modifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalië apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, **janë materiale por jo të përhapura**.

monetare, si dhe shpjegimet mbi to, janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2023, ka marrë në konsideratë vlerën e materialitetit **20,179 mijë lekë** për shpenzimet dhe vlerën **20,537 mijë lekë** për të ardhurat.

U konstatuan:

- Në Llogarinë nr. 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune*” është përfshirë aktivi “Pemë dekorative” me kosto historike 796 mijë lekë, si dhe aktivi “Program kompjuteri Financa 5” me kosto historike në vlerën 390 mijë lekë; Në Llogarinë nr. 218 “*Inventari ekonomik*” ishin asgjesuar me procedurën e asgjesimit të aktiveve për vitin 2023, edhe aktivi “Kondicionerë” me vlerë totale 281 mijë lekë, veprim i cili ka sjellë klasifikimin në llogari të gabuara të këtyre aktiveve dhe mos pasqyrim të saktë të gjendjes dhe vlerës së plotë të tyre;
- Në Llogarinë nr. 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” u konstatuan fatura të pa likuiduara të viteve 2006 - 2020, për vlerën 11,506 mijë lekë;
- Në Llogarinë nr. 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” për vlerën totale prej 363,290 mijë lekë të vitit 2023, nga auditimi i listës analitike, rezultoi 1 subjekt me emër, datë dhe vlerë detyrimi të njëjtë, në total 888 mijë lekë. Gjithashtu, vlera 60 mijë lekë nuk ka destinacion subjekti apo individ kreditore;
- Detyrimi tatimor i papaguar në Bashkinë Vorë më 31.12.2023, rezultoi në vlerën 376,289 mijë lekë, kundrejt 302,825 mijë lekë të raportuara nga Bashkia Vorë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore të biznesit ose familjarë në shumën 462,440 mijë lekë, si dhe mos raportimi për detyrimet e prapambetura që i përkasin periudhës 2004 - 2020 në shumën 27,219 mijë lekë, në total +73,463 mijë lekë, nuk paraqet situatën reale të debitorëve. Mos regjistrimi i plotë i debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit mbi dokumentimin e proceseve dhe transaksioneve për vijueshmërinë nga lindja deri në arkëtimin e detyrimit.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH-së*”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1089/1 prot., datë 11.09.2024 “*Auditim financiar në Bashkinë Vorë*”, ndryshuar me shkresën nr. 1089/2 prot., datë 24.09.2024 “*Njoftim për ndryshim në programin e auditimit*”, të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, nga data 11.09.2024 deri në datën 18.10.2024, në subjektin Bashkia Vorë për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2023 - 31.12.2023, u krye “*Auditim Financiar*” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

E. B, *Përgjegjës Grupi*

E. K, *Anëtar*

B. Sh, *Anëtar*

J. P, *Anëtar*

E. S, *Anëtar*

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

**1. Objekti dhe qëllimi:** Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në

përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t'i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në këtë fazë të auditimit, hartohet Raporti përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Vorë.

**2. Identifikimi i çështjes:** Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bazë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Vorë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do të përdoren për procedura auditimi që janë më të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Vorë.

**3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:** Kryetari i Bashkisë Vorë (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Vorë, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar dhe aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për

financimin e projekteve të investimeve.<sup>2</sup>

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

**4. Përgjegjësitë e audituesve:** Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Vorë në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Vorë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH-së kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne, vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

**5. Kriteret e vlerësimit:** Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm publik*”; Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 100 datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar. Urdhër nr. 214, datë 01.12.2022, nr. 6910

---

<sup>2</sup> Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, neni 15.

prot., “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit, të Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative”.

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” dhe Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimi i MFE nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimi plotësues të MFE nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2023”; Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimi nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025”.

- Në fushën e mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligji nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, i përmirësuar; Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Vorë.

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKB 70/2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

- Në fushën e administrimit e pronës publike: Ligji nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave të bashkive”.

**6. Standardet e auditimit:** ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-

2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”, si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, etj.. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH-së.

**7. Metodatat e auditimit:** Në auditim është përdorur metoda mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

- *Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*<sup>3</sup>. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:*

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

---

<sup>3</sup> *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve.* Është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi.* Është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione.* Janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.* Grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

**8. Dokumentimi i auditimit:** Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar, si dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (Akt konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reklektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të akt konstatimeve, u përgatit Projektraporti i Auditimit i cili u dërgua në subjekt me shkresën nr. 1089/6 prot., datë 16.12.2024. Nga ana e Bashkisë Vorë, me shkresën nr. 358 prot., datë 21.01.2025 është dërguar njohja e Projektraportit të Auditimit, si dhe dakordësia me përfundimet e përcjella nga grupi i auditimit, duke mos pasur komente apo shpjegime / observacione të tjera. Në përfundim, nga audituesit u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

#### 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

##### Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik.

**Zona Gjeografike:** Bashkia e re e Vorës shtrihet në Shqipërinë qendrore dhe kufizohet në veri me Bashkinë Krujë, në lindje me Bashkinë Kamëz, në jug me bashkinë Tiranë, në jug-perëndim me Bashkinë Shijak dhe në lindje me Bashkinë Durrës.



**Popullsia:** Sipas Censurit<sup>4</sup>, më datë 18 shtator 2023, numri i banorëve në territorin e Bashkisë së re Vorë është 21,621 banorë. Me shpërndarje të popullsisë sipas gjinisë në 49.6% meshkuj dhe 50.4 % femra.

**Të dhëna të tjera:** Bashkia e re e Vorës shtrihet në kryqëzimin kryesor rrugor të Shqipërisë ku lidhet Tirana me Durrësin dhe veriu me jugun e vendit. Për rrjedhojë, në territorin e kësaj bashkie janë vendosur një pjesë e rëndësishme e industrisë së lehtë dhe të ndërtimit, ndërsa bujqësia është përqendruar në disa produkte me vlerë të lartë të shtuar. Në Bashkinë e Vorës janë të regjistruara mbi 800 biznese të mëdha. Në ish-komunën Prezë gjendet një kala mesjetare e cila përbën një resurs të vogël turistik. Vora dhe tri njësitë përbërëse kanë parë rritje të shpejtë të popullsisë përgjatë 25 viteve të fundit, gjë që ka sjellë edhe një numër të konsiderueshëm ndërtimesh jashtë planeve urbanistike dhe pa infrastrukturë.

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) realizimit të shërbimeve në formë të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

## **2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.**

### **2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.**

#### **1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së.**

Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Në zbatim të pikës 1, të Programit të Auditimit nr. 1089/1 prot., datë 11.09.2024, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm;
2. Plani Vjetor i Punës;
3. Harta e proceseve të punës;
4. Strategjia e Riskut për periudhën 2023;
5. Deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm;
6. Pyetësori i vetëvlerësimit të Bashkisë Vorë;
7. Plani i Kontrollit të Brendshëm;
8. Plani i Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin;
9. Plani i Veprimit për arritjen e objektivave;
10. Regjistri i riskut për periudhën 2023;
11. Urdhër i brendshëm për krijimin e grupit të GMS;
12. Vendime të Grupit të Menaxhimit Strategjik etj.

---

<sup>4</sup> **Burimi:** <https://www.instat.gov.al/media/14323/cens-2023-tirana.pdf>

Ky auditim u krye në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe kanë ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësive publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Vorë, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

#### **Mbi mjedisin e kontrollit**

Bashkia Vorë funksionon bazuar në Rregulloren e Brendshme të bashkisë, referuar në Urdhër nr. 214, datë 01.12.2022, nr. 6910 prot., “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit, të Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative”. Grupi i punës ngarkuar për zbatimin e këtij vendimi është gjithë administrata e Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative. Edhe për vitin 2023, Bashkia Vorë ka vazhduar të funksionojë bazuar në të njëjtën rregullore. Referuar formatit të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, përsa i përket pjesës për Rregulloren e Brendshme të Njësive Publike, vihet re se përgjithësisht është hartuar bazuar në këtë manual dhe mbështetet në legjislacionin përkatës, duke përmbytur disa nga elementët thelbësorë, që çdo rregullore duhet të ketë.

#### **Kodi i Etikës**

Bashkia Vorë funksionon bazuar në Kodin e Etikës, Urdhër nr. 235, datë 30.12.2022, nr. 7555 prot., që është hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vorë. Kodi është i bazuar në legjislacionin përkatës, në të cilin është mbështetur Njësia Publike për hartimin e tij.

#### **Mbi menaxhimin e riskut**

Nga auditimi u konstatua se, me Urdhrin nr. 94, datë 30.08.2023, të Kryetarit të Bashkisë Vorë është miratuar Regjistri i Riskut për vitin 2023, si dhe me shkresën nr 4373/1 prot., datë 30.08.2023 është miratuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut.

#### **Mbi veprimtaritë e kontrollit**

- Grupi i Menaxhimit Strategjik

Referuar shkresës, Urdhër nr. 02, nr. 119 prot., datë 09.01.2023, “Për ngritjen e Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS) dhe Ekipëve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024 - 2026”, në Bashkinë Vorë. GMS ka vazhduar funksionin për vitin 2023 bazuar kësaj shkrese. Mungesa e një urdhri specifik, që përcakton në mënyrë të qartë personin që do jetë koordinator i riskut, është veprim në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 10.

- Vendime të GMS

Në Bashkinë Vorë nuk janë të dokumentuara në formë shkresore minutat e takimit për mbledhjet që ka kryer GMS për vitin 2023. Nisur nga ky fenomen, vihet re mospërgatitja e disa dokumentave si plani i veprimit për arritjen e objektivave dhe plani për kontrollin e brendshëm, të cilat janë rezultat i mbledhjeve që duhet të realizojë GMS dhe vendimeve që merren në to. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 27, pika 1.

- Grupit të auditimit ju vendos në dispozicion, Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për periudhën 01.04.2022 – 31.12.2022, e jo Deklarata e cilësisë për vitin 2023.

- Nga auditimi u konstatua se, me shkresën nr. 1198 prot., datë 01.03.2023, është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në MFE, Pyetëtori i Vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2023.

Përgjithësisht, pyetëtori është hartuar dhe miratuar sipas formatit standard dhe mbështetur në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar. Vlerësimi i riskut është bërë sipas katër seksioneve, mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informacioni dhe komunikimi, monitorimi. Në çdo seksion janë analizuar parimet në të cilat mbështetet njësia publike, duke dhënë edhe përgjigjet e arsyetuara për secilën prej tyre. Disa nga parimet janë angazhimi për integritet dhe vlerat etike; Titullari/Nëpunësi Autorizues demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje; Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë; Njësia Publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave; Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale; Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve lidhur me këto objektiva; Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave; Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime; Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm; Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli; Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë; Njësia Publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave; Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor; Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm; Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm; dhe Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë.

- Nga auditimi u konstatua se, Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2023, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk rezulton si dokument në Bashkinë Vorë. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pika 3.5.

- Me shkresën nr. 318, datë 28.03.2023 është miratuar Harta e Proceseve të Punës për vitin 2023, në përputhje me pikën nr. 3.3, të Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar.

- Plani i Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin për vitin 2023, nuk është hartuar dhe nuk rezulton si dokument në Bashkinë Vorë veprim në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Nga auditimi u konstatua se është hartuar Plani për Kontrollin e Brendshëm për vitin 2023, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pika 3.3.

- Plani i Veprimit për arritjen e objektivave për vitin 2023, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Bashkinë Vorë. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, neni 8, pika 8 a).

- Nga auditimi rezultoi se, Plani vjetor i punës së Drejtorisë së Menaxhimit Financiar për vitin 2023, është miratuar me shkresën nr. 03 prot., datë 27.01.2023.

- Gjurmët standarde të auditimit të vitit 2023, si gjurma e zbatimit të Buxhetit, gjurma për prokurimet me vlerë nën 1.000.000 lekë dhe mbi 1.000.000 lekë pa TVSH etj., për procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në Bashkinë Vorë,

nuk janë hartuar dhe miratuar. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 16, pika 2 dhe 3.

### **Informacioni dhe komunikimi**

Mjetet e komunikimit për Bashkinë Vorë janë forma shkresore dhe email-et. Në aspektin organizativ dhe funksional, çdo drejtori raporton te Kryetari i Bashkisë Vorë nëpërmjet mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme. Për mënyrën e realizimit të komunikimit të brendshëm në Bashkinë Vorë, komunikimi zyrtar realizohet nëpërmjet sistemit elektronik (internetit). Komunikimi dhe shkëmbimi elektronik i dokumenteve zyrtare, brenda bashkisë, realizohet duke përdorur postën elektronike (e-mail) dhe dërgesa në institucionet e tjera bëhet në formë shkresore zyrtare, me shërbim postar. Ajo çfarë evidentohet nga praktika është se punonjësit përdorin më tepër postën elektronike personale, ndërkohë që duhet bërë e mundur që të mund të përdorin postën elektronike të bashkisë, për përmbushjen e detyrave të tyre funksionale. Bashkia Vorë garanton për publikun transparencën e veprimtarisë së saj, ku çdo akt i Bashkisë publikohet në faqen zyrtare të internetit (Web-it) dhe afishohet në vendet e caktuara për njoftimet publike. Për periudhën objekt auditimi në Bashkinë Vorë, nuk janë aplikuar programe elektronike për kontrollin, menaxhimin e veprimeve financiare, kontabilizimin dhe pasqyrat financiare si dhe ato për vjeljen e të ardhurave për tatim taksat lokale.

### **Monitorimi**

Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në përgjithësi, realizohet nëpërmjet organizimit të grupeve të punës ose komisionet përkatëse. Një formë e monitorimit, është edhe pyetëtori i vetëvlerësimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Gjatë auditimit u konstatua se funksionimi i kontrollit të brendshëm në Bashkinë Vorë për vitin 2023, nuk ka qenë i organizuar dhe plotësisht funksional, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, kjo vihet re edhe nga mospërmbushja e objektivave në mënyrë jo të plotë për komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

### ***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

1. z. B. Sh, me detyrë Kryetar i Bashkisë Vorë dhe në cilësinë e Nëpunësit Autorizues;
2. z. S. B, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, për periudhën 15.08.2022 – 22.08.2023;
3. znj. A. D, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, për periudhën 23.08.2023 e në vazhdim;
4. znj. M. M, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Teknologjisë dhe Inovacionit.

*Në lidhje me këtë drejtim të auditimit, nuk janë paraqitur pretendime/observacione nga subjekti i audituar Bashkia Vorë, për Projektraportin e auditimit të dërguar me shkresën nr. 1089/6 prot., datë 16.12.2024.*

### **2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm**

#### **3.Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.**

Në zbatim të pikës 1 të Programit të Auditimit nr. 1089/1 prot., datë 11.09.2024, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Plani Strategjik i vitit 2023, etj, dhe pasqyrat shoqëruese;
2. Planifikimi vjetor për vitin 2023 dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2023;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm për vitin 2023 së bashku me pasqyrat shoqëruese;
5. Dosjet e auditimit të njësive publike, (koherente);

6. Projekt - raportet dhe raportet përfundimtare të auditimit të brendshëm të njësive publike; për vitin 2023;
7. Raport mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga Njësia e Auditit të Brendshëm;
8. Pyetësi bashkëlidhur kësaj kërkesë.

**Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:**

Bashkia Vorë ka parashikuar në strukturën e saj shërbimin e Auditit të Brendshëm në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm.

Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Vorë është miratuar dhe ka funksionuar me Urdhër nr. 67, datë 18.05.2022, nr. 2647 prot., “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Vorë dhe njësive administrative Prezë dhe Bërxullë për vitin 2022” dhe ka vazhduar si e tillë edhe për vitin pasardhës 2023 (periudhën objekt auditimi), në të cilin përcaktohej se kjo njësi do përbëhej nga 4 punonjës, konkretisht 1 (një) përgjegjës dhe 3 (tre) specialistë. Pas daljes së këtij urdhri për vitin 2022, kjo strukturë ka patur realisht vetëm 1 (një) punonjës përgjegjës, për periudhën 31.05.2023 deri 22.08.2023, 2 (dy) punonjës në pozicionin specialistë, ndërkohë që në strukturë ishte planifikuar 3 (tre) punonjës në pozicionin specialist dhe 1 (një) punonjës përgjegjës i kësaj njësie. Për pjesën e mbetur të vitit 2023, struktura e NjAB ka qenë e paplotësuar, si rrjedhojë e mos pasjes së një përgjegjësi për gjatë gjithë vitit, si dhe të një specialisti tjetër.

Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryejë auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Vorë, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik.

Struktura e NjAB, për vitin 2023, në Bashkinë Vorë nuk ka funksionuar siç parashikohet në kuadrin ligjor në fuqi dhe bazuar në strukturën organizative të miratuar nga titullari i institucionit për këtë vit, pasi edhe pse ka pasur 1 (një) Përgjegjës të NjAB, ajo ka qenë për një periudhë të shkurtër 2 mujore. Ky veprim është në mospërputhje me VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë së Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik, pika 3.

Si rrjedhojë, rezulton se NjAB e Bashkisë Vorë për vitin 2023 ka qenë e paplotësuar dhe ka pasur vetëm 2 (dy) specialistë dhe vetëm për një periudhë të shkurtër 1 (një) përgjegjës. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 10.

Përsa i takon 2 (dy) specialistëve të NjAB gjatë vitit 2023, kanë qenë, znj. V. A. e emëruar në këtë pozicion nga data 11.08.2020, bazuar në Vendimin nr. 187, nr. 6398 prot., datë 11.08.2020, e pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm, si dhe znj. L. M. e emëruar në këtë pozicion nga data 06.01.2022, bazuar në Urdhrin nr. 08, datë 06.01.2022, nr. 79 prot., “Për zbatim akt emërimi”, e pajisur me certifikatë të audituesit të brendshëm. Përbërja e sektorit NjAB, për vitin objekt auditimi paraqitet në rubrikën, Aneksi AB1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Përsa i takon trajnimeve periodike, që duhet të realizojë stafi i audituesve që janë pjesë e Njësive të Auditit të Brendshëm, në Bashkinë Vorë vihet re se janë ndjekur rregullisht trajnime të vijueshme profesionale nga dy prej punonjësve që janë pjesë e NjAB, siç janë paraqitur edhe në tabelën në rubrikën Aneksi AB1, konkretisht nga znj. V. A. (specialiste) dhe znj. L. M. (specialiste).

*Nga auditimi rezultoi se:*

**Karta e Auditimit** për vitin 2023, ka vazhduar të jetë në fuqi bazuar me shkresën nr. 2775 prot., datë 26.05.2022, përgatitur nga Njësia e Auditit të Brendshëm dhe miratuar te titullari i

Bashkisë Vorë. Ky veprim është në përputhje me kërkesat e nenit 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe në përputhje me kërkesat e pikës 2.6.1, Kapitulli II të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 100 datë 25.10.2016, të Ministrit të Financave.

**Kodi i Etikës** për Audituesit e Brendshëm në Bashkinë Vorë është hartuar dhe miratuar nga Kryetari i bashkisë, bazuar në shkresën nr. 2774 prot., datë 26.05.2022 dhe ka vazhduar të jetë në fuqi edhe për vitin 2023.

**Plani Strategjik dhe vjetor për vitin 2023** është përgatitur dhe dërguar në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, për vitet 2023 – 2025, me shkresën nr. 5940 prot., datë 17.10.2022. Plani strategjik përgjithësisht është hartuar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe pika 3.3. Bazuar në pasqyrën nr. 3, për vitin 2023 ishin planifikuar 4 (katër) angazhime auditimi, ku 4 (katër) janë përputhshmërie. Plani vjetor për vitin 2023 i bashkangjitur me planin strategjik, është hartuar bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2 dhe 3.3., ku në përmbajtje të tij janë të përshkruara të gjitha pikat e strukturës së këtij plani.

**Regjistri i Riskut për vitin 2023**, është hartuar nga NjAB e Bashkisë Vorë me Vendim nr. 95, datë 04.09.2023, nr. 4631 prot., bazuar në legjislacionin përkatës dhe në funksion të objektivave institucionale. Ky regjistër përfshin disa nga risqet e identifikuara si, hartimi i programit të auditimit pa vlerësuar fushat me risk të lartë; mosrealizimi i programit të auditimit; përditësimi në kohë me ndryshimet e shumta ligjore; nevoja për specialistë të fushës në struktura me risk të lartë; ndryshimet në legjislacion, transferimi i kompetencave të reja; hartimi i një raporti jo të saktë ose mosidentifikimi i gabimeve; rekomandime të paqarta ose të pakuptueshme për subjektin që auditohet dhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve.

#### **A. Hartimi i planeve të auditimit, përgatitja dhe hartimi i programeve dhe llojet e auditimeve të ushtruara.**

Sipas Planit Strategjik të periudhës 2023 – 2025, miratuar me shkresën nr. 5946 prot., datë 17.10.2022, urdhri nr. 183, i Kryetari të Bashkisë Vorë, janë planifikuar 12 angazhime auditimi.

Për vitin 2023, kanë qenë të planifikuara për t’u kryer 4 auditime të llojit përputhshmëri në 4 drejtori, përkatësisht: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar.

Nga këto drejtori, janë zhvilluar auditime për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore (miratuar nga Kryetari me shkresën nr. 5437/2 prot. datë 20.10.2023) dhe Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore (miratuar nga Kryetari me shkresën nr. 4617/2 prot. datë 18.09.2023), të paraqitura në rubrikën Aneksi AB3, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve për vitin 2023, u konstatua se përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, bazuar edhe te Manuali i Auditimit të Brendshëm.

Nga auditimi i projekt - raporteve dhe raporteve përfundimtare, rezulton se nga audituesit e brendshëm në procesin e auditimit, janë zbatuar standardet e përcaktuara në MAB, në përmbajtje dhe formë. Në dosjet e auditimit të vitit 2023, dokumentacioni në dosje ka qenë specifikisht si vijon dhe në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm.

**Tabela: Dosjet e auditimit të NjAB**

| <b>Subjektet e audituara</b>                | <b>Përmbajtja e dosjeve</b>                                         |
|---------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------|
| 1- Drejtoria e Burimeve Njerëzore           | - autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim; |
| 2- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore | - deklaratat e konfliktit të interesit;                             |

|  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|--|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|  | <ul style="list-style-type: none"> <li>- programi i angazhimit të auditimit;</li> <li>- njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit;</li> <li>- procesverbal takimi fillestar, projekt-axhenda;</li> <li>- shkresë përcjellëse e projekt – raportit, projekt – raporti,</li> <li>- memo;</li> <li>- shkresë përcjellëse e raportit përfundimtar, raporti përfundimtar.</li> </ul> |
|--|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

*Burimi: Bashkia Vorë*

Gjatë fazës së auditimit në terren, u konstatuan se mungonin në dosjet e auditimit: Inventari i dosjes, procesverbali i takimit përmblyllës, informacioni mbi zbatimin e rekomandimeve, vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit. Këto dokumente janë plotësuar në dosjet e auditimit, nga personat përgjegjës së NjAB, të vërtetuara në observacionin e dërguar në KLSH me shkresën nr. 5547 prot., datë 15.10.2024.

Në dosjet e auditimit mungon Vlerësimi i monitorimit të cilësisë për auditimet e vitit 2023. Gjithashtu, në dosjen e auditimit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore mungojnë edhe reagimet (feedback i auditimit).

Përsa i takon mos krijimit manualisht ose elektronikisht të Dosjes së përhershme të auditimit, veprim ky në mospërputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli nr. VI, pika 6.3., me observacionet e dërguara me shkresën nr. 5547 prot., datë 15.10.2024, subjekti ka paraqitur Indeksën për dosjen e përhershme.

## **B. Zbatimi i planeve të auditimit të brendshëm. Hartimi dhe mbajtja e dokumentacionit të auditimit.**

Për veprimtarinë e Sektorit të AB për vitin 2023, është raportuar në mënyrë sistematike te Kryetari i Bashkisë Vorë. Për çdo mision auditimi, nga audituesit janë hartuar programet e auditimit, të cilat janë miratuar nga NjAB, në bazë të Planit Vjetor. Rezulton se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, të miratuar me Urdhër nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” (seksioni VI, kreu III, pika 1), programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikën e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës.

Për vitin 2023 i janë nënshtruar procesit të auditimit Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, si dhe është kryer Auditim për Zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga KLSH, për të cilat janë dhënë rekomandimet të paraqitura në tabelën vijuese:

**Tabela:** Planifikimit dhe realizimit të auditimeve të brendshme për vitin 2023

| Viti 2023 |      |       |       |          |          |            |          |           |           |            |
|-----------|------|-------|-------|----------|----------|------------|----------|-----------|-----------|------------|
| Plan      | Fakt | Rekom | Zbat. | Pa zbat. | Në proc. | Përputhsh. | Perform. | Financiar | Kombinuar | Konsulencë |
| 4         | 2    | 36    | 8     | -        | 28       | -          | -        | -         | 2         | -          |

*Burimi: Bashkia Vorë*

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më lart, nga 4 (katër) angazhime auditimi të planifikuara për vitin 2023, vihet re se kanë arritur të realizohen 2 (dy) angazhime auditimi, e cila ka ardhur si pasojë e mosfunksionimit të saktë të Njesisë së Auditit të Brendshëm, për vitin 2023. Konstatohet se rekomandime të vendosura, bazuar në auditimet që janë realizuar gjatë vitit 2023, janë 36 (tridhjetë e gjashtë), nga të cilat 8 (tetë) janë zbatuar dhe 28 (njëzet e tetë) janë në proces zbatimi.

**Raporti i Veprimtarisë të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023** është përgatitur dhe dërguar në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2023, me shkresën nr. 751/1 prot., datë 14.02.2024, në përputhje me Kapitullin IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm, të miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. Referuar pasqyrave bashkëlidhur këtij raporti, është vënë re pasaktësi në paraqitjen reale të numrit të rekomandimeve të lëna, nga NjAB e Bashkisë Vorë, gjatë auditimeve që janë realizuar gjatë vitit 2023.

Raporti përmban të dhëna për Burimet Njerëzore të Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 (pasqyra nr.1); Realizimi i planit të angazhimeve 2023 (pasqyra nr.2); Përmbledhje e gjetjeve me dëm ekonomik nga angazhimet e auditimit 2023 (pasqyra nr.3); Përmbledhje e parregullsive të identifikuar sipas sistemeve për vitin 2023 (pasqyra nr.4); Rekomandimet e dhëna sipas kategorive për vitin 2023 (pasqyra nr. 5); Çështje të dërguara për investigim për vitin 2023 (pasqyra nr. 6); Pyetësi i vetëvlerësimit për auditimin e brendshëm.

Referuar pasqyrës për vitin 2023, janë realizuar 2 (dy) angazhime auditimi të kombinuara, dhe (Audit për detyrat e lëna nga AB dhe KLSH) ka qenë në proces.

Referuar pasqyrës nr. 3, nuk ka gjetje me dëm ekonomik.

Referuar pasqyrës nr. 4, nuk ka gjetje në lidhje me parregullsitë e identifikuar.

Referuar pasqyrës nr. 5, janë 32 (tridhjetë e dy) rekomandime gjithsej, 32 (tridhjetë e dy) të zbatuara dhe 0 (zero) në proces zbatimi. I njëjti fenomen vlen edhe për pasqyrën nr. 5, ku nuk është paraqitur në vlerë të saktë numri total i rekomandimeve të lëna, që realisht është 36 (tridhjetë e gjashtë) rekomandime, nga të cilat 8 (tetë) janë zbatuar dhe 28 (njëzet e tetë) janë në proces zbatimi.

Referuar pasqyrës nr. 6, çështje të dërguara për investigim për vitin 2023 nuk ka.

**Raporti Vjetor i ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve për vitin 2023, është hartuar dhe figuron si dokument në Bashkinë Vorë.** Ky raport është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 1635/3 prot. e datës 29.03.2024, në përputhje me Kapitullin IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm pika 4.1.12 “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”, të miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 i ndryshuar.

### ***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

1. z. B. Sh, me detyrë Kryetar i Bashkisë Vorë dhe në cilësinë e Nëpunësit Autorizues;
2. znj. A. D, me detyrë Përgjegjës i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për periudhën 31.05.2023-22.08.2023;

*Në lidhje me këtë drejtim të auditimit, nuk janë paraqitur pretendime/observacione nga subjekti i audituar Bashkia Vorë, për Projektraportin e auditimit të dërguar me shkresën nr. 1089/6 prot., datë 16.12.2024.*

## **2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

### **1. Programimi i PBA 2023-2025 dhe programimi i buxhetit vjetor 2023.**

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025, rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes. Me shkresën nr. 4316, prot., datë 10.08.2022 dhe Urdhër nr. 83, datë 10.08.2022, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), si dhe ekipet e menaxhimit të programeve të përbërë nga 17 anëtarë sipas njësive shpenzuese buxhetore për përgatitjen e programit buxhetor vjetor për vitin 2023. Këto grupe kanë përcaktuar tavanet e shpenzimeve sipas programeve të miratuara me VKB nr. 78, datë 27.12.2022.

Projekt buxheti afatmesëm për vitin 2023-2025, është hartuar në përputhje me kriteret dhe kërkesat e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor

në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” dhe Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë objektivat e politikave të programeve buxhetore afatmesme dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me shkresat nr. 2735 prot., datë 17.05.2023 dhe nr. 6683 prot., datë 04.12.2023, me relacionin shpjegues si për fazën e parë dhe për fazën e dytë të PBA 2023-2025. Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2023-2025 si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, projektet me financim të brendshëm e të huaj, si dhe raportet e projekteve të investimeve.

Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 18 programe buxhetore. Gjatë hartimit të PBA për vitet 2023-2025 janë përcaktuar “Përshkrimi” i çdo programi, “Politika e programit”, “Qëllimi i politikës së programit” dhe “Objektivat e politikës së programit”. Gjithashtu çdo program ka të përcaktuar produktet e programeve buxhetore në të dy fazat e përgatitjes së tij.

Programimi i shpenzimeve për vitet 2023-2025 sipas PBA, i detajuar sipas programeve. Në mijë lekë

| Nr.           | Emërtimi i Programit                                | Viti 2023      |            | Viti 2024      |            | Viti 2025      |            |
|---------------|-----------------------------------------------------|----------------|------------|----------------|------------|----------------|------------|
|               |                                                     | 000/lekë       | %          | 000/lekë       | %          | 000/lekë       | %          |
| 1             | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi             | 212,741        | 26         | 189,668        | 23         | 195,029        | 23         |
| 2             | Shërbimet e Policisë Vendore                        | 5,405          | 1          | 5,310          | 1          | 5,479          | 1          |
| 3             | Mbrojtja nga Zjarri                                 | 25,817         | 3          | 12,790         | 2          | 34,568         | 4          |
| 4             | Shërbimet Bujqësore, Inspektimi dhe Ushqimi         | 4,720          | 1          | 4,838          | 1          | 4,983          | 1          |
| 5             | Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit | 13,224         | 2          | 26,260         | 3          | 26,448         | 3          |
| 6             | Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave                 | 7,217          | 1          | 49,675         | 6          | 50,985         | 6          |
| 7             | Rrjeti Rrugor Rural                                 | 166,701        | 20         | 34,605         | 4          | 36,677         | 4          |
| 8             | Transport i mbetjeve deri në Landfill               | 24,100         | 3          | 24,702         | 3          | 25,443         | 3          |
| 9             | Planifikimi Urban Vendor                            | 12,064         | 1          | 27,122         | 3          | 5,087          | 1          |
| 10            | Shërbimet Publike Vendore                           | 188,956        | 23         | 272,014        | 32         | 268,684        | 31         |
| 11            | Furnizimi me Ujë                                    | 23,390         | 3          | 23,624         | 3          | 24,096         | 3          |
| 12            | Përkujdesja Sociale                                 | 6,107          | 1          | 6,260          | 1          | 6,448          | 1          |
| 13            | Sport dhe Argëtim                                   | 26,000         | 3          | 26,650         | 3          | 27,449         | 3          |
| 14            | Arsimi Bazë dhe Parashkollor                        | 66,826         | 8          | 68,497         | 8          | 70,552         | 8          |
| 15            | Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm                       | 4,172          | 1          | 33,049         | 4          | 28,317         | 3          |
| 16            | Fondi Rezervë dhe i Kontigjencës                    | 16,410         | 2          | 19,088         | 2          | 37,593         | 4          |
| 18            | Mbrojtja Civile                                     | 16,669         | 2          | 16,085         | 2          | 16,598         | 2          |
| <b>Totali</b> |                                                     | <b>820,519</b> | <b>100</b> | <b>840,237</b> | <b>100</b> | <b>864,436</b> | <b>100</b> |

Burimi: Bashkia Vorë

Ndarja e shpenzimeve sipas natyrës, vitet 2023-2025 sipas PBA, i detajuar sipas programeve. Në mijë lekë

| Nr.           | Emërtimi i shpenzimit                   | Viti 2023      |            | Viti 2024      |            | Viti 2025      |            |
|---------------|-----------------------------------------|----------------|------------|----------------|------------|----------------|------------|
|               |                                         | 000/lekë       | %          | 000/lekë       | %          | 000/lekë       | %          |
| 1             | Fondi i pagave                          | 257,907        | 31         | 264,680        | 32         | 272,619        | 32         |
| 2             | Fondi sigurime shoqërore e shendetësore | 45,387         | 6          | 46,434         | 6          | 47,824         | 6          |
| 2             | Fondi rezerve i pagave (5%)             | 12,895         | 2          | 13,191         | 2          | 13,587         | 2          |
| 3             | Shpenzime operative                     | 283,567        | 35         | 290,089        | 35         | 298,792        | 35         |
| 4             | Investime e projekte                    | 170,151        | 21         | 174,065        | 21         | 178,283        | 21         |
| 5             | Fondi rezerve dhe kontigjence           | 16,410         | 2          | 16,787         | 2          | 17,291         | 2          |
| 6             | Mbrojtje civile nga të ardhurat         | 8,205          | 1          | 8,393          | 1          | 8,645          | 1          |
| 8             | Transferta të brendshme sporti          | 26,000         | 3          | 26,598         | 3          | 27,395         | 3          |
| <b>TOTALI</b> |                                         | <b>820,522</b> | <b>100</b> | <b>840,237</b> | <b>100</b> | <b>864,436</b> | <b>100</b> |

Burimi: Bashkia Vorë

Planifikimi i të ardhurave, vitet 2023-2025 sipas PBA, i detajuar sipas programeve.

Në mijë lekë

| Nr.      | Emërtimi                        | 2023           | 2024           | 2025           |
|----------|---------------------------------|----------------|----------------|----------------|
| <b>I</b> | <b>Të ardhurat e veta</b>       | <b>565,299</b> | <b>579,547</b> | <b>597,329</b> |
| 1        | Taksa Lokale                    | 319,356        | 327,340        | 337,160        |
| 2        | Taksa Lokale nga Taksat e ndara | 10,650         | 11,033         | 11,759         |
| 3        | Te Ardhura nga Tarifa lokale    | 208,583        | 213,797        | 220,211        |

|                                    |                                                                                                     |                |                |                |
|------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|----------------|----------------|
| 3                                  | Te Ardhura të tjera                                                                                 | 26,710         | 27,377         | 28,199         |
| <b>II</b>                          | <b>Të ardhura nga burimet qëndrore</b>                                                              | <b>255,222</b> | <b>260,687</b> | <b>267,105</b> |
| 1                                  | Transferta e pakushtëzuar për vitin 2023                                                            | 150,689        | 153,500        | 157,350        |
| 2                                  | Transferta e Pakushtëzuar (Për Shpenzimet e transportit të mbetjeve deri në Lanfill për vitin 2023) | 24,100         | 24,700         | 25,300         |
| 3                                  | Transferta e pakushtëzuar Sektoriale për Arsimin Parashkollor për vitin 2022                        | 48,710         | 49,930         | 51,200         |
| 4                                  | Transferta e pakushtëzuar Sektoriale për Arsimin Parauniversitar për vitin 2023                     | 5,453          | 5,600          | 5,740          |
| 5                                  | Transferta e pakushtëzuar Sektoriale për Shërbimin mbrojtja nga zjarri(PMNZSH) për vitin 2023       | 13,972         | 14,320         | 14,500         |
| 6                                  | Transferta e pakushtëzuar Sektoriale për Administrimin e pyjeve për vitin 2023                      | 962            | 987            | 1,100          |
| 7                                  | Transferta e pakushtëzuar Sektoriale për Rrugët Rurale për vitin 2023                               | 540            | 550            | 565            |
| 8                                  | Transferta e pakushtëzuar Sektoriale për Ujitjen dhe Kullimin për vitin 2023                        | 10,796         | 11,100         | 11,350         |
| 1                                  | Trasferte e Kushtëzuar ( Pagat e Gjendjes )                                                         |                |                |                |
| <b>Totali (Shuma I + Shuma II)</b> |                                                                                                     | <b>820,521</b> | <b>840,234</b> | <b>864,434</b> |

Burimi: Bashkia Vorë

Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2023, sipas PBA.

Në mijë lekë

| Nr.           | Emërtimi                                             | PBA 2023-2025  |                |
|---------------|------------------------------------------------------|----------------|----------------|
|               |                                                      | Të ardhurat    | Shpenzimet     |
| 1             | Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës        |                |                |
| 2             | Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës |                |                |
| 3             | Trashëguar nga Transferta specifike                  |                |                |
| 4             | Plani i të ardhurave viti ushtrimor                  | 565,300        |                |
| 5             | Granti                                               | 174,789        |                |
| 6             | Transferta specifike                                 | 80,433         |                |
| 7             | Paga (600)                                           |                | 300,588        |
| 8             | Sigurime shoqërore (601)                             |                | 41,219         |
| 9             | Shpenzime operative (602)                            |                | 199,642        |
| 10            | Transferta (604+606+609) Fondi Rezervë               |                | 160,018        |
| 11            | Inv (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushtezuara      |                | 119,055        |
| 12            | Investime nga FZHR e M. Linjës                       |                |                |
| 13            | Të tjera (166, 651, 603, 604, 606)                   |                |                |
| <b>Totali</b> |                                                      | <b>820,522</b> | <b>820,522</b> |

Burimi: Bashkia Vorë

**Për vitin 2023**, buxheti vjetor është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë VKB nr. 78, datë 27.12.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr. 2400/2 prot., datë 05.01.2023. Konsultimet me grupet e interesit për PBA 2023-2025 dhe Projekt Buxhetin 2023, janë zhvilluar si më poshtë:

| Nr. | Përshkrimi                                | Data       |
|-----|-------------------------------------------|------------|
| 1   | Konsultime me komunitetin në NjA Prezë    | 20.11.2022 |
| 2   | Konsultime me Komunitetin në NjA Bërxullë | 22.11.2022 |
| 3   | Konsultime me Komunitetin në NjA Vorë     | 24.11.2022 |

Burimi: Bashkia Vorë

## 2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta, si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor nuk kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, përveç faktit ku janë transferuar fondet për rikonstruksionet e objekteve Arsimore me vlerë 224,846,554 lekë, si dhe Akti Normativ për likuidimin e detyrimeve, në vlerën 18,264,611 lekë.

Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të regjistruara e të rakorduara me Degën e Thesarit Tiranë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE.

Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Në fund të vitit 2023, sipas aktrakordimit me thesarin, buxheti është ndryshuar për vlerën 275,006,552 lekë.

Shtesat nga grandit për vlerën 275,006,552 lekë, miratuar me VKB nr. 11, datë 23.02.2023, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr. 323/1, datë 28.02.2023, janë të detajuara si më poshtë:

| Shtesa nga grandit, miratuar me VKB nr. 11, datë 23.02.2023 |         |                       |                    | Në lekë                                |                    |               |       |
|-------------------------------------------------------------|---------|-----------------------|--------------------|----------------------------------------|--------------------|---------------|-------|
| Buxheti fillestar                                           |         | Ndryshime gjatë vitit |                    | Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve |                    |               |       |
| Nr. datë                                                    | Vlera   | Nr. Datë              | Vlera              | Pakësuar artikulli / shtuar artikulli  |                    |               |       |
|                                                             |         |                       |                    | Shtesa. Art.                           | Shuma              | Pakësim. Art. | Shuma |
| VKB nr. 78 datë 27.12.2022                                  | 820,521 | 678/06.12.2023,       | 129,974,554        | 231                                    | 129,974,554        |               |       |
|                                                             |         | 684/06.12.2023        | 126,767,387        | Progr. 9230                            |                    |               |       |
|                                                             |         | 660/06.12.2023        |                    | 231                                    | 126,767,387        |               |       |
| AN nr. 6, 14.12.2023                                        |         |                       | 18,264,611         | Progr. 9120                            |                    |               |       |
| <b>Totali Viti 2023</b>                                     |         |                       | <b>275,006,552</b> |                                        | <b>275,006,552</b> |               |       |

Burimi: Bashkia Vorë

Miratimi i PBA 2023-2025, buxheti për vitin 2023 dhe ndryshimet gjatë vitit janë miratuar sipas VKB-ve, të paraqitura të detajuara më poshtë:

| PBA 2023-2025             | Buxheti 2023              |
|---------------------------|---------------------------|
| VKB nr. 78, datë 27.12.22 | VKB nr. 78, datë 27.12.22 |
|                           | VKB nr. 82, datë 23.12.22 |
|                           | VKB nr. 11, datë 23.02.23 |
|                           | VKB nr. 12, datë 23.02.23 |
|                           | VKB nr. 29, datë 28.04.23 |
|                           | VKB nr. 48, datë 26.07.23 |
|                           | VKB nr. 49, datë 26.07.23 |

Burimi: Bashkia Vorë

Të dhënat mbi buxhetin e rishikuar për vitin 2023, sipas PBA dhe ndryshimet gjatë vitit, paraqiten të detajuara si më poshtë:

| Buxheti i rishikuar dhe ndryshimet gjatë vitit 2023 |                                                      |                            |            | Në mijë lekë |                    |
|-----------------------------------------------------|------------------------------------------------------|----------------------------|------------|--------------|--------------------|
| Nr.                                                 | Emërtimi                                             | Planifikimi sipas PBA 2023 |            | Buxheti 2023 |                    |
|                                                     |                                                      | Të ardhurat                | Shpenzimet | Të ardhurat  | Shpenzimet faktike |
| 1                                                   | Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës        |                            |            | 67,246       |                    |
| 2                                                   | Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës |                            |            | 196,578      |                    |
| 3                                                   | Trashëguar nga Transferta specifike                  |                            |            | 108,905      |                    |
| 4                                                   | Plani i të ardhurave viti ushtrimor                  | 565,300                    |            | 565,300      |                    |
| 5                                                   | Granti                                               | 174,789                    |            | 174,789      |                    |

|               |                                                 |                |                |                  |                  |
|---------------|-------------------------------------------------|----------------|----------------|------------------|------------------|
| 6             | Transferta specifike                            | 80,433         |                | 148,993          |                  |
| 7             | Paga (600)                                      |                | 300,588        |                  | 250,037          |
| 8             | Sigurime shoqërore (601)                        |                | 41,219         |                  | 41,219           |
| 9             | Shpenzime operative (602)                       |                | 199,642        |                  | 218,473          |
| 10            | Transferta (604+606+609) Fondi Rezervë          |                | 160,018        |                  | 160,018          |
| 11            | Inv (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushtezuara |                | 119,055        |                  | 119,055          |
| 12            | Investime nga FZHR e M. Linjës                  |                |                | 351,345          | 351,345          |
| 13            | Të tjera (166, 651, 603, 604, 606)              |                |                | 135,552          | 135,552          |
| <b>Totali</b> |                                                 | <b>820,522</b> | <b>820,522</b> | <b>1,748,708</b> | <b>1,275,699</b> |

Burimi: Bashkia Vorë

Ndryshimet (shtesat) në planifikimin e të ardhurave gjatë vitit 2023, (buxheti i rishikuar) janë paraqitur të detajuara më poshtë:

Shtesat në planifikimin e të ardhurave gjatë vitit 2023 Në mijë lekë

| Nr.           | Emërtimi                                                               | Shuma          |
|---------------|------------------------------------------------------------------------|----------------|
| 1             | Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës (sektori i Shpenzimeve)  | 36,376         |
| 2             | Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës (sektori i të ardhurave) | 30,870         |
| 3             | Transferta e pakushtëzuar, Sektor trashëguar viti paraardhës           | 56,238         |
| 4             | Fonde te rindërtimit, shpronësim publik,                               | 249,245        |
| 5             | Bonus Qiraje                                                           | 56,780         |
| 6             | Shtesë paga trasf, specifike                                           | 2,987          |
| 7             | Shtesë paga trasf, pakusht.                                            | 13,163         |
| 8             | Shpenzime për nxënës Arsimit 9-vjeçarë                                 | 5,072          |
| 9             | TVSH mobilim shkollash                                                 | 3,960          |
| 10            | Mbrojtja Civile                                                        | 9,370          |
| 11            | Funksionet e deleguara                                                 | 189,122        |
| 12            | Fonde për rindërtim objekte arsimore, dhe transferim likujd. Shpenz    | 275,006        |
| <b>Totali</b> |                                                                        | <b>928,189</b> |

Burimi: Bashkia Vorë

Të ardhurat sipas natyrës Në mijë lekë

| A                                            | Të ardhurat                                                | Shuma            |
|----------------------------------------------|------------------------------------------------------------|------------------|
| 1                                            | Nga taksat                                                 | 468,359          |
| 2                                            | Jo tatimore                                                | 96,941           |
| <b>I</b>                                     | <b>Totali</b>                                              | <b>565,300</b>   |
| 1                                            | Transferta e pakushtëzuar                                  | 174,789          |
| 2                                            | Transfertë specifike                                       | 148,993          |
| 3                                            | Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës              | 372,729          |
| 4                                            | Të tjera (166, 651, 603, 604, 606)                         | 135,552          |
| <b>II</b>                                    | <b>Shuma e transfertave</b>                                | <b>832,063</b>   |
| <b>III</b>                                   | <b>Transferta të pritshme (FZHR e tjera e M. e Linjës)</b> | <b>351,345</b>   |
| <b>Totali i burimeve të veta (I +II+III)</b> |                                                            | <b>1,748,708</b> |

Burimi: Bashkia Vorë

Ndryshimet (shtesat) në planifikimin e shpenzimeve gjatë vitit 2023, (buxheti i rishikuar) janë paraqitur të detajuara më poshtë:

Shtesat në planifikimin e shpenzimeve gjatë vitit 2023 Në mijë lekë

| Nr.           | Emërtimi                                                      | Kodi i Projektit | Shuma          |
|---------------|---------------------------------------------------------------|------------------|----------------|
| 1             | Paga (600)                                                    |                  | 55,018         |
| 2             | Sigurime shoqërore (601)                                      |                  | -              |
| 3             | Shpenzime operative (602)                                     |                  | 70,521         |
| 4             | Shpenzime operative (231)                                     |                  | 83,000         |
| 5             | Fondi për Grantet e Rindërtimit nga e para                    | 94902AB          | 40             |
| 6             | Fond për Shpronësim                                           | 94902AG          | 4,771          |
| 7             | Fond për Shpronësim                                           | 94902AG          | 86             |
| 8             | Fond për Rindërtimin e Godinës së bashkisë Vorë               | 94902AE          | 62,217         |
| 9             | Fond per Rindërtimin Hartim Projektesh Pallatet Bashkia Vore  | 94902AI          | 187            |
| 10            | Fondi për Grantet e Rindërtimit nga e para Ds5                | 94902AC          | 6,891          |
| 11            | Fondi për Grantet e Rindërtimit DS1,DS2,DS3                   | 94902AC          | 16,150         |
| 12            | Fondi për Rindërtimin e Shkollës 9-VjeçarëPicar, Bashkia Vorë | 94902AD          | 74,128         |
| <b>Totali</b> |                                                               |                  | <b>373,009</b> |

Burimi: Bashkia Vorë

Nga të dhënat e tabelave më sipër, rezulton se për vitin 2023, në PBA nuk përputhen të ardhurat me shpenzimet, pasi shuma e të ardhurave të planifikuara është në vlerën 1,748,708 mijë lekë, ndërsa shuma e shpenzimeve të planifikuara sipas natyrës është në vlerën 1,275,699 mijë lekë. Pra, rezulton me një mospërputhje në nivelin e parashikimit të PBA në vlerën 473,009 mijë lekë ose plani i shpenzimeve zë 72% të planit të të ardhurave.

Burimet e financimit të buxhetit të bashkisë për vitin 2023, (Të ardhurat e veta + transfertat e pakushtëzuar + trasfertë sektoriale + funksionet e deleguara) janë në vlerën **1,748,708 mijë lekë**.

Mosrakovitimi ndërmjet PBA dhe buxhetit vjetor 2023, vjen si rezultat i parashikimit jo të saktë të të ardhurave të përdorura dhe të tjera në PBA 2023-2025.

Për vitin 2023, buxheti shtesë gjithsej ka qenë në vlerën 928,189 mijë lekë, i analizuar si më poshtë:

Fonde të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës (shpenzimet) në vlerën 36,376 mijë lekë;

Fonde të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës (të ardhurat) në vlerën 30,870 mijë lekë;

Fonde të trashëguara nga transfertat e kushtëzuar në vlerën 56,238 mijë lekë;

Fonde të trashëguara nga rindërtimi dhe shpronësimet publike në vlerën 249,245 mijë lekë;

Fonde të kushtëzuara për subvencionimin e qirave të banesave në vlerën 56,780 mijë lekë;

Fonde për shtesat e pagave nga transfertat specifike në vlerën 2,987 mijë lekë;

Fonde për shtesat e pagave nga transfertat e pakushtëzuar për shtesat e pagave nga transfertat 13,163 mijë lekë;

Fonde të kushtëzuara për trajtimin e bursave, për nxënësit e arsimit 9- vjeçar në vlerën 5,072 mijë lekë;

Fonde të kushtëzuara nga TVSH për mobilimin e shkollave të rindërtuara nga e para në vlerën 3,960 mijë lekë;

Fonde të kushtëzuara për emergjencat civile në vlerën 9,370 mijë lekë;

Fonde për funksionet e deleguara ku përfshihet paafësia, invaliditeti dhe ndihma ekonomike, në vlerën 182,535 mijë lekë;

Fonde të kushtëzuara për gjendjen civile, në vlerën 5,044 mijë lekë;

Fonde të kushtëzuara nga KQZ, në vlerën 1,543 mijë lekë.

### **3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.**

Për zbatimet e buxheteve është raktuar çdo muaj me Degën e Thesarit Tiranë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur aktakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull, sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Tiranë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin në fakt është respektuar disiplina buxhetore.

Realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2023, sipas burimeve të financimit, referuar situacioneve dhe aktakordimeve me thesarin, planifikuar për vlerën 1,748,708 mijë lekë dhe realizuar për vlerën 1,275,699 mijë lekë, është paraqitur më poshtë:

Planifikimet dhe realizimi i buxhetit sipas njësive administrative dhe njësive vartëse.

| Nr. | Emërtimi                    | Plani       | Fakti       |
|-----|-----------------------------|-------------|-------------|
| 1   | Aparati i bashkisë          | 259,751,343 | 151,573,341 |
| 2   | Njësia Administrative Prezë |             | 17,535,696  |

|               |                                |                    |                    |
|---------------|--------------------------------|--------------------|--------------------|
| 3             | Njësia Administrative Bërxullë |                    | 22,056,758         |
| 4             | Njësi vartëse                  | 87,086,059         | 55,183,423         |
| 5             | Gjendja Civile                 | 4,920,000          | 3,819,080          |
| <b>Totali</b> |                                | <b>351,757,402</b> | <b>250,168,298</b> |

*Burimi: Bashkia Vorë*

Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit

*Në mijë lekë*

| Nr.           | Burimet e Financimit      | Plan vjetor 2023 | Fakt vjetor 2023 | Realizimi në % |
|---------------|---------------------------|------------------|------------------|----------------|
| 1             | Transferta e pakushtëzuar | 406,321          | 306,307          | 75             |
| 2             | Transferta sektoriale     | 436,388          | 355,036          | 81             |
| 3             | Te ardhurat vendore       | 664,745          | 386,606          | 58             |
| 4             | Transferta e deleguara    | 241,252          | 227,748          | 94             |
| <b>Totali</b> |                           | <b>1,748,708</b> | <b>1,275,699</b> | <b>73</b>      |

*Burimi: Bashkia Vorë*

Tabela e realizimit të buxhetit sipas programeve buxhetore për planin vjetor 2023, si dhe realizimi i tij në vlerë dhe përqindje, është paraqitur në rubrikën Aneksi B1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Tabela e realizimit të buxhetit për zërat e shpenzimeve, sipas programeve buxhetore është paraqitur në rubrikën Aneksi B2, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2023, referuar akt-rakordimeve me thesarin.

| Nr.           | Emërtimi                                                       | Plan             | Fakt             | %         |
|---------------|----------------------------------------------------------------|------------------|------------------|-----------|
| 1             | Llogaria 600 "Paga"                                            | 305,053          | 250,035          | 82        |
| 2             | Llogaria 601 "Sigurime shoqërore"                              | 49,422           | 41,219           | 83        |
| 3             | Llogaria 602 "Shpenzime operative"                             | 283,153          | 218,473          | 77        |
| 4             | Llogaria 604 "Transferime korrente të brendshme"               | 30,105           | 30,105           | 100       |
| 5             | Llogaria 606 "Transferime për Buxhetet familjare dhe Individë" | 322,753          | 265,464          | 82        |
| 6             | Llogaria 609 "Rezervat"                                        | 0                | 0                | 0         |
| 7             | Llogaritë 230-231 "Investime"                                  | 758,219          | 470,400          | 62        |
| <b>Totali</b> |                                                                | <b>1,748,705</b> | <b>1,275,696</b> | <b>73</b> |

*Burimi: Bashkia Vorë*

Realizimi i shpenzimeve dhe diferenat e mosrealizimit.

*Në mijë lekë*

| Emërtimi i shpenzimit                                          | Plani i vitit 2023 | Fakti i vitit 2023 | Diferenca |
|----------------------------------------------------------------|--------------------|--------------------|-----------|
| Llogaria 600 "Paga"                                            | 305,053            | 250,035            | 55,018    |
| Llogaria 601 "Sigurime shoqërore"                              | 49,422             | 41,219             | 8,203     |
| Llogaria 602 "Shpenzime operative"                             | 283,153            | 218,473            | 64,680    |
| Llogaritë 230-231 "Investime"                                  | 758,219            | 470,400            | 287,819   |
| Llogaria 606 "Transferime për Buxhetet familjare dhe Individë" | 352,858            | 295,569            | 57,289    |
| Llogaria 466 "Mjete në ruajtje"                                | 22,715             | 10,929             | 11,786    |

*Burimi: Bashkia Vorë*

Realizimi i shpenzimeve me burim financimi nga transferata e pakushtëzuar është paraqitur më poshtë:

Realizimi i shpenzimeve me burim financimi nga transferata e pakushtëzuar.

*Në mijë lekë*

| Artikulli                                              | 2022           |                |               | 2023           |                |               |
|--------------------------------------------------------|----------------|----------------|---------------|----------------|----------------|---------------|
|                                                        | Plan           | Fakt           | Dif.          | Plan           | Fakt           | Dif.          |
| Llog. 600 "Paga"                                       | 73,361         | 68,508         | 4,853         | 110,764        | 106,400        | 4,364         |
| Llog. 601 "Sig. shoqërore"                             | 12,274         | 9,819          | 2,455         | 22,761         | 21,729         | 1,032         |
| Llog. 602 "Shpenzime operative"                        | 67,421         | 37,462         | 29,959        | 63,959         | 53,594         | 10,365        |
| Llog. 604 "Transferime korrente të brendshme"          | 0              | 0              | 0             | 0              | 0              | 0             |
| Llog. 606 "Transferime për Buxh. familjare & Individë" | 50             | 50             | 0             | 65,270         | 48,897         | 16,373        |
| Llog. 609 "Rezervat"                                   | 0              | 0              | 0             | 0              | 0              | 0             |
| Llog. 230-231 "Investime"                              | 167,508        | 105,290        | 62,218        | 143,565        | 75,687         | 67,878        |
| <b>Totali</b>                                          | <b>320,614</b> | <b>221,130</b> | <b>99,484</b> | <b>406,319</b> | <b>306,307</b> | <b>99,484</b> |

*Burimi: Bashkia Vorë*

Realizimi i shpenzimeve me burim financimi nga transferata sektoriale është paraqitur më poshtë:

## Realizimi i shpenzimeve me burim financimi nga transfertat sektoriale

Në mijë lekë

| Artikulli                                              | 2022           |                |               | 2023           |                |               |
|--------------------------------------------------------|----------------|----------------|---------------|----------------|----------------|---------------|
|                                                        | Plan           | Fakt           | Dif.          | Plan           | Fakt           | Dif.          |
| Llog. 600 "Paga"                                       | 52,788         | 48,947         | 3,841         | 60,232         | 56,669         | 3,563         |
| Llog. 601 "Sig. shoqërore"                             | 9,174          | 8,189          | 985           | 11,156         | 9,362          | 1,794         |
| Llog. 602 "Shpenzime operative"                        | 11,050         | 11,050         | 0             | 13,204         | 12,286         | 918           |
| Llog. 604 "Transferime korrente të brendshme"          | 0              | 0              | 0             | 0              | 0              | 0             |
| Llog. 606 "Transferime për Buxh. familjare & Individë" | 1,426          | 1,140          |               | 451            | 100            | 351           |
| Llog. 609 "Rezervat"                                   | 0              | 0              | 286           | 0              | 0              | 0             |
| Llog. 230-231 "Investime"                              | 45,609         | 38,177         | 7,432         | 351,345        | 276,620        | 74,725        |
| <b>Totali</b>                                          | <b>120,047</b> | <b>107,503</b> | <b>12,544</b> | <b>436,388</b> | <b>355,037</b> | <b>12,544</b> |

Burimi: Bashkia Vorë

Realizimi i shpenzimeve me burim financimi të ardhurat e veta është paraqitur më poshtë:

Plan – Fakt për vitet 2022-2023

Në mijë lekë

| Artikulli                                             | 2022           |                |                  | 2023           |                |                |
|-------------------------------------------------------|----------------|----------------|------------------|----------------|----------------|----------------|
|                                                       | Plan           | Fakt           | Dif.             | Plan           | Fakt           | Dif.           |
| Llog. 600 "Paga"                                      | 182,082        | 87,387         | 94,695.3         | 127,172        | 80,527         | 46,645         |
| Llog. 601 "Sig.shoqërore"                             | 28,204         | 15,912         | 12,292           | 14,751         | 9,561          | 5,190          |
| Llog. 602 "Shpenzime operative"                       | 207,949        | 56,916         | 151.134          | 205,776        | 152,394        | 53,382         |
| Llog. 604 "Transferime korrente të brendshme"         | 17,000         | 17,000         | 0                | 22,000         | 22,000         | -              |
| Llog. 606 "Transferime për Buxh. Familiar & Individë" | 8,410          | 8,410          | -                | 35,970         | 8,263          | 27,707         |
| Llog. 609 "Rezervat"                                  | -              | -              | -                | -              | -              | -              |
| Llog. 230-231 "Investime"                             | 279,395        | 132,641        | 146,755          | 259,076        | 113,862        | 145,214        |
| <b>Totali</b>                                         | <b>723,040</b> | <b>318,266</b> | <b>404.774.1</b> | <b>664,745</b> | <b>386,607</b> | <b>404,774</b> |

Burimi: Bashkia Vorë

Realizimi i shpenzimeve me burim financimi të ardhurat e veta është paraqitur më poshtë:

Plan – Fakt për vitet 2021-2022

Në mijë lekë

| Artikulli                                              | 2021             |                |               | 2022           |                |               |
|--------------------------------------------------------|------------------|----------------|---------------|----------------|----------------|---------------|
|                                                        | Plan             | Fakt           | Dif.          | Plan           | Fakt           | Dif.          |
| Llog. 600 "Paga"                                       | 4,258            | 3,759          | 499           | 6,885          | 6,438          | 447           |
| Llog. 601 "Sig.shoqërore"                              | 493              | 490            | 3             | 754            | 567            | 187           |
| Llog. 602 "Shpenzime operative"                        | 66               | 60             | 6             | 214            | 200            | 14            |
| Llog. 604 "Transferime korrente të brendshme"          | -                | -              | -             | 8,106          | 8,106          | -             |
| Llog. 606 "Transferime për Buxh. familjare & Individë" | 1,017,918        | 958,013        | 59,905        | 221,062        | 208,205        | 12,857        |
| Llog. 609 "Rezervat"                                   | -                | -              | -             | -              | -              | -             |
| Llog. 230-231 "Investime"                              | 3,000            | 3,000          | -             | 4,232          | 4,232          | -             |
| <b>Totali</b>                                          | <b>1,025,735</b> | <b>965,322</b> | <b>60,414</b> | <b>241,253</b> | <b>227,748</b> | <b>13,505</b> |

Burimi: Bashkia Vorë

Për vitin 2023, shpenzimet janë realizuar në masën 73%, ku nga vlera e planifikuar prej 1,748,708 mijë lekë, është realizuar vlera 1,275,699 mijë lekë.

Zëri investime paraqitet në masën 62%, ku nga vlera e planifikuar prej 758,219 mijë lekë është realizuar vlera 470,000 mijë lekë.

Shpenzimet operative paraqiten në masën 80%, ku nga vlera e planifikuar prej 636,013 mijë lekë është realizuar vlera 514,044 mijë lekë.

Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore paraqiten në masën 82%, ku nga vlera e planifikuar prej 354,476 mijë lekë është realizuar vlera 291,254 mijë lekë, sipas burimeve të financimit të paraqitura më poshtë:

Në lekë

| Paga dhe sigurime shoqërore |             |   | Burimi i financimit   |                      |             |                      |
|-----------------------------|-------------|---|-----------------------|----------------------|-------------|----------------------|
| Plan                        | Fakt        | % | Trans. e Pakushtëzuar | Fonde të trashëguara | Të ardhura  | Trans. e Kushtëzuar  |
| 354,475,702                 | 291,254,233 |   | 133,526,384           | 1,078,856            | 140,844,026 | 7,638,500            |
|                             |             |   |                       |                      |             | Transferte specifike |
|                             |             |   |                       |                      |             | 71,387,936           |

| Nr.           | Emërtimi               | Plani              | Fakti              | %  |
|---------------|------------------------|--------------------|--------------------|----|
| 1             | Fondi i Pagave         | 292,392,072        | 250,035,110        | 86 |
| 2             | Fondi i Sig. Shoqërore | 49,422,196         | 41,219,123         | 83 |
| 3             | Fondi i Veçantë        | 12,661,434         |                    |    |
| <b>Totali</b> |                        | <b>354,475,702</b> | <b>291,254,233</b> |    |

*Burimi: Bashkia Vorë*

Sipas Raportit të monitorimit, të ardhurat e veta për vitin 2023, nga 565,300,000 lekë janë realizuar në vlerën 408,963,901 lekë ose 73%, nga të cilat të ardhurat tatimore janë realizuar në vlerën 390,140,954 lekë dhe të ardhurat jotatimore janë realizuar në vlerën 18,822,947 lekë.

Administrata e Bashkisë Vorë, argumenton se këto mosrealizime vijnë për shkak se struktura organike nuk është plotësuar për numrin e punonjësve të miratuar me VKB dhe se një pjesë e procedurave të parashikuara nuk janë zhvilluar për mungesë personeli, ndërsa pjesa tjetër nuk është financuar pasi nga OE të shpallura fitues nuk janë paraqitur dokumentet e plota për të bërë likuidimet përkatëse.

*Përdorimi i të ardhurave*

*Në mijë lekë*

| Nr.           | Emërtimi                              | Plani fillim viti sipas VKB | Fakti sipas akt rakordimit | Të ardh. e veta | Grand          | Trans. pakusht. Specifike | Trans. kusht per funk te deleg | Tra. Kusht per investime |
|---------------|---------------------------------------|-----------------------------|----------------------------|-----------------|----------------|---------------------------|--------------------------------|--------------------------|
| 1             | Paga (600)                            | 305,053                     | 250,035                    | 80,527          | 106,400        | 56,669                    | 6,438                          |                          |
| 2             | Sigurime (601)                        | 49,422                      | 41,219                     | 9,561           | 21,729         | 9,362                     | 567                            |                          |
| 3             | Mallra dhe Shërbime (602)             | 283,153                     | 218,473                    | 152,394         | 53,593         | 12,286                    | 200                            |                          |
| 4             | Trasferta Konrente të Brendshme (604) | 30,105                      | 30,105                     | 22,000          | -              | -                         | 8,106                          |                          |
| 5             | Trasferta 606                         | 322,754                     | 265,464                    | 8,263           | 48,896         | 100,000                   | 208,205                        |                          |
| 7             | Investime(230 +231)                   | 758,219                     | 470,400                    | 113,861         | 75,687         | 276,619                   | 4,232                          | 470,401                  |
| <b>Totali</b> |                                       | <b>1,748,706</b>            | <b>1,275,696</b>           | <b>386,606</b>  | <b>306,305</b> | <b>454,936</b>            | <b>227,748</b>                 | <b>470,401</b>           |

*Burimi: Bashkia Vorë*

Realizimi i shpenzimeve me burim të ardhurat e veta dhe transfertë e pakushtëzuar për vitin 2023, është paraqitur më poshtë:

*Realizimi i shpenzimeve me burim të ardhurat e veta dhe transfertën e pakushtëzuar*

*Në mijë lekë*

| Art.                                | Emërtimi                         | Fakti 2022     | Plan 2023      | Plan i rishikuar | Çelja në thesar | Fakti 2023     | Diferenca      | %         |
|-------------------------------------|----------------------------------|----------------|----------------|------------------|-----------------|----------------|----------------|-----------|
|                                     |                                  | -1             | -2             | -4               | -5              | -6             | (7) = (6)-(-5) |           |
| 600                                 | Paga                             | 155,893        | 294,176        | 237,937          |                 | 186,927        | 51,010         | 79        |
| 601                                 | Sigurime Shoqërore               | 25,731         | 35,695         | 37,513           |                 | 31,290         | 6,223          | 83        |
| <b>600+60</b>                       | <b>Paga + Sigurime</b>           | <b>181,624</b> | <b>329,871</b> | <b>275,450</b>   | <b>93,379</b>   | <b>218,217</b> | <b>57,233</b>  | <b>79</b> |
| 602                                 | Mallra dhe Shërbime të Tjera     | 94,277         | 246,234        | 269,735          |                 | 205,988        | 63,747         | 76        |
| 603                                 | Subvencione                      | -              | -              | -                |                 | -              | -              | 0         |
| 604                                 | Trasferta Korente të Brendshme   | 17,000         | 20,000         | 22,000           |                 | 22,000         | -              | 100       |
| 605                                 | Trasferta Korente të Huaja       | -              | -              | -                |                 | -              | -              | 0         |
| 606                                 | Transf. per Buxh. Fam. & Individ | 8,460          | 2,500          | 101,240          |                 | 57,160         | 44,080         | 56        |
| <b>602-606</b>                      | <b>Shpenzime operative</b>       | <b>119,737</b> | <b>268,734</b> | <b>392,975</b>   | <b>200,444</b>  | <b>285,148</b> | <b>107,827</b> | <b>73</b> |
| <b>Shpenzime Korrente</b>           |                                  |                |                |                  |                 |                | -              | <b>0%</b> |
| 230                                 | Kapitale të Patrupëzuara         |                |                |                  |                 |                | -              | 0         |
| 231                                 | Kapitale të Trupëzuara           | 237,930        | 241,493        | 402,641          |                 | 189,549        | 213,092        | 47        |
| <b>Totali</b>                       | <b>Shpenzime Kapitale</b>        | <b>237,930</b> | <b>241,493</b> | <b>402,641</b>   | <b>170,559</b>  | <b>189,549</b> | <b>213,092</b> | <b>47</b> |
| <b>Totali (korrente + kapitale)</b> |                                  | <b>539,291</b> | <b>840,098</b> | <b>1,071,066</b> | <b>464,382</b>  | <b>692,914</b> | <b>378,152</b> | <b>65</b> |

*Burimi: Bashkia Vorë*

Nga të dhënat e pasqyrës së Investimeve të kryera në Bashkinë Vorë, vlerat dhe realizimi progresiv, konstatohet se një pjesë e procedurave janë në proces dhe nuk janë mbyllur ose nga subjektet sipërmarrës nuk është paraqitur dokumentacioni i plotë përfundimtar për likuidimin dhe marrjen në dorëzim të tyre. Kjo pasqyrë është paraqitur në rubrikën Aneksi B3, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Fondi rezervë dhe i kontigjencës.**

Me miratimin e buxhetit për vitin 2023, është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë dhe i kontigjencës nga të ardhurat e Bashkisë Vorë, ku për vitin 2023 është në vlerën 16,410 mijë lekë dhe nuk është përdorur, kurse fondet e transferuara nga AKMC janë sipas tabelës:

| Emërtimi         | Plan 2023     | Fakt 2023    |
|------------------|---------------|--------------|
| Fond Rezervë     | 16,410        | -            |
| Fond Emergjence  | -             | -            |
| Fond Kontigjence | -             | -            |
| Mbrojtja Civile  | 8,106         | 8,106        |
| <b>Totali</b>    | <b>24,516</b> | <b>8,106</b> |

Burimi: Bashkia Vorë

#### Raportet e Monitorimit.

Për vitet 2023, janë përgatitur raporte 4- mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, konkretisht:

Janë dërguar raportet 4- mujore si më poshtë:

Me shkresën nr. 4197 prot, datë 07.06.2023, është dërguar raporti i parë,

Me shkresën nr. 2142 prot, datë 04.09.2023, është dërguar raporti i dytë,

Me shkresën nr. 758 prot, datë 13.02.2024, është dërguar raporti i tretë.

#### 4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “Detyrimet e prapambetura”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë:

Llojet e detyrimeve të prapambetura

Në mijë lekë

| Detyrime e NJQV                      | Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2022 | Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2023 | Total detyrime | Shlyerja gjatë 3 mujorit të tretë 2023 | Mbetja në fund të vitit 2023 |
|--------------------------------------|--------------------------------------------------|-------------------------------------|----------------|----------------------------------------|------------------------------|
| a                                    | 1                                                | 2                                   | 3=1+2          | 4                                      | 5=3-4                        |
| a. Investime nga Ministritë e linjës |                                                  |                                     |                |                                        |                              |
| b. Investime nga Bashkia             | 325,018                                          | -                                   | 325,018        | 45,924                                 | 279,094                      |
| <b>Investime</b>                     | <b>325,018</b>                                   | <b>-</b>                            | <b>325,018</b> | <b>45,924</b>                          | <b>279,094</b>               |
| Mallra dhe shërbime                  | 81,886                                           | -                                   | 81,886         | (1)                                    | 81,887                       |
| Vendime gjyqësore                    | 5,962                                            | -                                   | 5,962          | 3,653                                  | 2,309                        |
| Të tjera ...                         |                                                  |                                     |                |                                        |                              |
| <b>Totali</b>                        | <b>412,866</b>                                   | <b>0.0</b>                          | <b>412,866</b> | <b>49,576</b>                          | <b>363,290</b>               |

Burimi: Bashkia Vorë

**Konstatimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare, konkretisht llogarive të detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata të Bashkisë Vorë ndaj palëve të treta, u konstatua se stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022 është paraqitur në pasqyrat financiare për vlerën 412,867,557 lekë (nga e cila llog. 401-408 në vlerën 409,905,607 lekë dhe llog. 467 në vlerën 5,961,950 lekë), ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura raportuar në MFE në dhjetor të vitit 2023 është për vlerën 363,290,371 lekë, e cila rakordon me vlerën e paraqitur në pasqyrat financiare.

#### Situata financiare e Bashkisë Vorë.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur mbi situatën financiare që paraqet Bashkia Vorë, rezulton se stoku i detyrimeve të prapambetura është në nivelin 34.67% të shpenzimeve totale të miratuara. Në këtë situatë nuk janë paraqitur faturat e palikuiduara me fonde të deleguara (specifike), si më poshtë:

Stoku i detyrimeve të prapambetura.

Në lekë

| Nr.        | Emërtimi                  | Stoku në vlerë     | Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në | Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së |
|------------|---------------------------|--------------------|------------------------------------------------|--------------------------------------------------|
| <b>I</b>   | <b>Borxhe (a+b)</b>       | <b>0</b>           |                                                |                                                  |
| <b>a</b>   | <b>Hua sfatgjatë</b>      | <b>0</b>           |                                                |                                                  |
| a,1        | Principali                |                    |                                                |                                                  |
| a,2        | Interesi                  |                    |                                                |                                                  |
| <b>b</b>   | <b>Hua afatshkurtër</b>   | <b>0</b>           |                                                |                                                  |
| b,1        | Hua                       |                    |                                                |                                                  |
| b,2        | Overdrafte                |                    |                                                |                                                  |
| b,3        | Kredi të furnitorëve      |                    |                                                |                                                  |
| <b>II</b>  | <b>Detyrime (a+b+c)</b>   | <b>363,290,371</b> |                                                | <b>34.67%</b>                                    |
| <b>a</b>   | <b>Shpenzime korrente</b> | <b>81,886,827</b>  |                                                |                                                  |
| a,1        | Mallra dhe shërbime       | 81,886,827         |                                                |                                                  |
| a,2        | Paga dhe sigurime         |                    |                                                |                                                  |
| a,3        | Të tjera                  |                    |                                                |                                                  |
|            |                           |                    |                                                |                                                  |
| <b>b</b>   | <b>Shenzime kapitale</b>  | <b>279,094,155</b> |                                                |                                                  |
| b,1        | Insitucione buxhetore     |                    |                                                |                                                  |
| b,2        | Subjekte private          |                    |                                                |                                                  |
| <b>c</b>   | <b>Vendime gjyqësore</b>  | <b>2,309,389</b>   |                                                |                                                  |
| c,1        | Marrëdhënie pune          |                    |                                                |                                                  |
| c,2        | Mallra dhe shërbime       | 2,309,389          |                                                |                                                  |
| ,3         | Investime                 |                    |                                                |                                                  |
| c,4        | Të tjera                  |                    |                                                |                                                  |
| <b>III</b> | <b>Totali (I+II)</b>      | <b>363,290,371</b> | <b>1,047,951,031</b>                           | <b>34.67%</b>                                    |

Burimi: Bashkia Vorë

**Konkluzion:** Situata financiare e Bashkisë Vorë, sipas të dhënave të shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 dhe gjendjes së faturave të palikuidura në fund të periudhës ushtrimore paraqitet në nivelin 34.67% të shpenzimeve vjetore të miratuara, të dhënat të cilat tregojnë se kjo bashki është në gjendjen e vështirësisë financiare.

Lista analitike e kreditorëve të Bashkisë Vorë (Operatorë Ekonomikë), me detyrimet përkatëse është paraqitur në rubrikën Aneksi B4, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në korrik të vitit 2023, Bashkia Vorë ka dërguar një plan për shlyerjen e detyrimeve në Këshillin Bashkiak, i miratuar me VKB` nr. 50, datë 26.07.2023. Ky plan parashikon shlyerjen e detyrimeve deri në fund të vitit 2025, të shpërndarë në tre vite buxhetore si më poshtë:

Për vitin 2023, detyrimi për t'u shlyer është 134,362,554 lekë;

Për vitin 2024, detyrimi për t'u shlyer është 138,339,543 lekë;

Për vitin 2025, detyrimi për t'u shlyer është 140,165,409 lekë.

Gjatë vitit 2024, janë likuiduar të gjitha detyrimet e mbetura për vitin 2023 dhe stafi i Bashkisë Vorë është angazhuar për mbylljen e të gjitha detyrimeve për vitin 2024 dhe më tej. Gjithashtu, gjatë vitit 2023 nuk janë prokuruar investime të reja për të mos krijuar stok borxhi të ri.

Pavarësisht angazhimit të administratës për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, gjatë vitit 2023, nuk është likuiduar vlera e parashikuar prej 134,362,554 lekë, por vetëm 49,577,186 lekë ose rreth 27% e parashikimit. Ky mosrealizim ka ardhur për shkak të mosrealizimit të të ardhurave.

Likuidimi i detajuar i detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2023

Në lekë

| Nr. | Përshkrimi                                                                               | Operatori Ekonomik | Shuma     |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|-----------|
| 1   | Likuidim Situacion Nr.1 me objekt Ndërtimi I Kanalit B/A ndricim ne rrugën Miqesia Domje | S                  | 4,123,708 |
| 2   | Likuidim Situacion nr 1 Sistemim Asfaltim Rruga Mojre Fjore Gjec-Koder Njesia Preze      | G                  | 6,000,000 |
| 3   | Likuidim Situacion Sistemin Asfaltim Rruga Mojre dhe Fjore Gjec-Koder                    | G                  | 6,648,907 |

|               |                                                                                        |          |                   |
|---------------|----------------------------------------------------------------------------------------|----------|-------------------|
| 4             | Likuidim për stc nr 2 rikonstrukcion I rrugeve mucaj sheraj dhe veseleve fshati mucaj  | B Shpk   | 2,916,368         |
| 5             | Likuidim stc prf pjesor rikonstrukcion I rrugëve mucaj sheraj dhe veseleve             | B Shpk   | 12,083,632        |
| 6             | Likuidim per stc nr 1 përfundimtare shtese e rruges 1-qershori njs ad berxulle         | L K shpk | 11,896,956        |
| 7             | Likuidim per stc nr 1 përfundimtar për objektin ndertim I rrjetit kuz lagjja Sul Haxhi | L K shpk | 2,255,054         |
| 8             | Likuidim vendim gjyqësor I. K                                                          | I. K     | 3,085,280         |
| 9             | Likuidim vendim gjyqësor F. Z                                                          | F. Z     | 567,281           |
| <b>Totali</b> |                                                                                        |          | <b>49,577,186</b> |

*Burimi: Bashkia Vorë*

### Mbi vendimet gjyqësore.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2022, shuma e detyrimeve për vendimet gjyqësore është 5,961,950 mijë lekë, nga të cilat janë likuiduar në shumën 3,652,561 lekë. Në fund të vitit 2023, ka mbetur pa likuiduar vlera 2,309,389 lekë.

### 5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Në Bashkinë Vorë nuk ka pasur fonde nga Fondi i Zhvillimit Rural (FZHR).

#### *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:*

1. Z. B. Sh, me detyrë Kryetar i Bashkisë Vorë dhe në cilësinë e Nëpunësit Autorizues.
2. Znj. A. D, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, nga data 23.08.2023 e në vazhdim.

*Në lidhje me këtë drejtim të auditimit, nuk janë paraqitur pretendime/observacione nga subjekti i audituar Bashkia Vorë, për Projektraportin e auditimit të dërguar me shkresën nr. 1089/6 prot., datë 16.12.2024.*


**6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.**

#### **a) Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

Struktura e Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative për vitin 2023, ka funksionuar sipas numrit dhe strukturës së punonjësve, miratuar Urdhër të Kryetarit Bashkisë Vorë nr. 67, datë 18.05.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative Prezë dhe Bërxullë për vitin 2022”, miratuar me VKB nr. 7, datë 07.01.2021, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative Prezë dhe Bërxullë për vitin 2021”

Struktura organike e miratuar e Drejtorisë së Ardhurave dhe Tarifave përbëhet nga 3 sektorë, përkatësisht Drejtori (1); Sektori i Statistikave dhe Menaxhimit të Borxhit me 1 përgjegjës dhe 2 specialistë; Sektori Familjar 1 përgjegjës, 3 specialistë dhe 2 punonjës për mbledhjen e tarifës; Sektori i Biznesit 1 përgjegjës, 3 specialistë dhe 3 punonjës për mbledhjen e taksave, gjithsej 17 punonjës.

#### **Struktura dhe numri i punonjësve Drejtoria e Taksave dhe Tarifave**



Administrata e Bashkisë Vorë organizohet dhe funksion sipas “Rregullores mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Vorë”, nenet 66-76, në të cilën në Kreun IV është përcaktuar edhe organizimi dhe funksionimi i drejtorive dhe sektorëve të saj.

Misioni DTT është ndjekja e politikave, programeve dhe strategjive implementuese për administrimin e taksave vendore. Drejtoria e Taksave dhe tarifave planifikon, vlerëson dhe administron mbledhjen e burimeve financiare të të ardhurave të veta të bashkisë, administron shlyerjen e detyrimeve nga taksapaguesit, si dhe propozon politika dhe strategji sensibilizuese mbështetëse të biznesit, të uljes së informalitetit, të rritjes së konkurrencës së ndershme dhe ndërtimit të marrëdhënieve me taksapaguesit.

**Konstatim:** Numri total maksimal i punonjësve të Bashkisë Vorë për vitin 2023, nuk është miratuar nga Këshilli Bashkiak në miratimin e PBA 2023-2025, miratuar më VKB nr. 78, datë 27.12.2022 “Miratimi Projekt Buxhetit Afatmesëm 2023-2025 dhe detajimi buxhetit të vitit 2023”, i ndryshuar, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut 2400/2 Prot, datë 01.05.2023, në mospërputhje me nenin 54, të Ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Nga verifikimi dhe rakordimi me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorinë e Menaxhimit Financiar numri i punonjësve të Drejtorisë së të Ardhurave dhe Tarifave për vitin 2023, **nga 17 punonjës të miratuar rezultuan 22 punonjës ose 5 punonjës më shumë** se struktura e miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 67, datë 18.05.2022 “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative Prezë dhe Bërthmë për vitin 2022”.

### **Burimi i krijimit të të ardhurave.**

Financimi i buxhetit në Bashkinë Vorë realizohet nga:

- Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera dhe të ardhura që trashëgohen.
- Nga burimet qendrore, ku përfshihen transfertë e pakushtëzuar, transfertë specifike (e pakushtëzuar sektoriale) për funksionet e reja, që i janë transferuar bashkisë dhe transfertë e kushtëzuar.

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhura nga taksat e ndara, nga tarifat vendore, dhe të ardhurat e tjera, mbështetur në Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar; Ligjin nr. 9920 datë 26.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Bashkia i përdor këto burime të ardhurash për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Burimi i të ardhurave nga taksat/tarifat mbështetet në paketën fiskale 2023, miratuar me VKB nr. 77, datë 27.12.2022 “Për Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për Bashkinë e Vorës për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresë nr. 2400/2 prot, datë 05.01.2023, duke synuar hartimin e një pakete fiskale të integruar, rishikimin e kornizës ligjore me qëllim përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe pagesave të tjera, etj. Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, paketa fiskale ka detajuar çdo lloj takse të

administruar nga organet vendore të administrimit, mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksave dhe mbledhjes së tyre.

**Sipas paketës fiskale për vitin 2023**, buxheti i Bashkinë Vorë do të financohet nga burimet e veta nga taksa lokale në vlerën 268,825,479 lekë, nga tarifat lokale në vlerën 199,533,271 lekë, nga “Të ardhura të tjera” në vlerën 93,641,250 lekë, duke synuar arkëtimin e taksave vendore dhe **në total në vlerën 562,000,000 lekë**.

#### **Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave.**

Përgjatë vitit 2023, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar, zbatuar dhe realizuar 1 paketë fiskale, miratuar VKB nr. 77, datë 27.12.2022 “Miratimi i Taksave dhe Tarifave Vendore për Vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Tiranë me shkresë nr. 2400/2 Prot, datë 05.01.2023.

Hartimi i PBA 2023-2025 u bazua në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 35, 36, 37; Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu III “Të ardhurat e veta të vetëqeverisjes vendore”; neni 10 deri neni 20; Këshilli Bashkiak ka miratuar buxhetin afatmesëm 2023-2025 me Vendim nr. 78, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit 2023”, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Tiranë me shkresë nr. 2400/2 Prot, datë 05.01.2023.

Për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave”, i ndryshuar, Ligji 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar; Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me drejtoritë e bashkisë, dhe agjentët fiskalë, mbështetur në Paketën fiskale 2023, planifikuan të sigurojnë të ardhura nga tarifa dhe taksa vendore në total **565,300 mijë ose 68.90%** e kërkesës buxhetore të vitin 2023, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon.

| Parashikimi i të ardhurave për vitin buxhetor 2023 dhe PBA 2024-2025 |                                                          |                    | Në mijë lekë       |                    |
|----------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| Nr.                                                                  | Emërtimi                                                 | Plani i vitit 2023 | Plani i vitit 2024 | Plani i vitit 2025 |
| 1                                                                    | Taksa lokale vendore                                     | 319,357            | 327,341            | 337,161            |
| 2                                                                    | Taksa lokale nga taksa e ndara                           | 10,650             | 11,034             | 11,760             |
| 3                                                                    | Të ardhura nga tarifa lokale                             | 208,583            | 213,798            | 220,212            |
| 4                                                                    | Të ardhura të tjera                                      | 26,710             | 27,378             | 28,199             |
| 5                                                                    | Të ardhura të trashëguara nga buxheti vitit 2022         | -                  | -                  | -                  |
|                                                                      | <b>Të ardhura të veta</b>                                | <b>565,300</b>     | <b>579,550</b>     | <b>597,332</b>     |
|                                                                      | Të ardhura nga burime qëndrore                           | 255,222            | 260,687            | 267,105            |
|                                                                      | Transferte nga burime qëndrore për investime rindërtimit | 0                  | 0                  | 0                  |
|                                                                      | Transferte nga burime qëndrore për gjendjen civile       | 0                  | 0                  | 0                  |
|                                                                      | <b>Totali</b>                                            | <b>820,522</b>     | <b>840,237</b>     | <b>864,437</b>     |

Burimi: PBA 2023-2025, Bashkia Vorë

Bazuar në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, dhe aktet e tjera nënligjore sektoriale, Bashkia Vorë dhe NJA të saj parashikuan të gjenerojnë të ardhura për rreth **1,703 subjekte** mbi të cilat aplikohen taksat dhe tarifat vendore.

Kategoria e taksapaguesve për vitin 2022 dhe 2023 taksat dhe tarifat vendore, si dhe numri i tyre, paraqiten më poshtë:

| Nr.   | Lloji Biznesit  | Gjendja 31.12.2022 | Regjistrime të reja | Mbyllur aktiviteti | Gjendja në fund 31.12.2023 |
|-------|-----------------|--------------------|---------------------|--------------------|----------------------------|
| 1     | Biznesi vogël   | 986                | 155                 | 82                 | 1,059                      |
| 2     | Biznesi i madh  | 717                | 89                  | 24                 | 782                        |
| (1+2) | <b>Gjithsej</b> | <b>1,703</b>       | <b>244</b>          | <b>106</b>         | <b>1,841</b>               |

Burimi: Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve, Bashkia Vorë

Kategoritë e mësipërme me përjashtim të institucioneve, ndahen në nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht: -Kategoria e Biznes ndahet në Biznes i Madh dhe Biznes i Vogël. Kategoria “*Familjarë*” për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionistë, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalidë etj.

Në PBA 2023-2025, programi i të ardhurave për vitin 2023 në total u programua **565,300 mijë** lekë, të ardhura që do të gjenerohen nga **1,703** subjekte taksapagues, të grupuar sipas llojit të taksave dhe tarifave dhe llojit të biznesit si më poshtë vijon, numër i cili në 31.12.2023 rezultoi **1,841 subjekte**, ose me rritje subjektësh taksapagues subjekte biznes i vogël për 73 subjekte dhe biznes i madh për 65 subjekte, në total 138 subjekte të reja, më shumë se në vitin 2022.

| Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave për PBA 2023-2025 |                    |                |                |               | Në mijë lekë   |                |               |
|------------------------------------------------------------|--------------------|----------------|----------------|---------------|----------------|----------------|---------------|
| Nr.                                                        | Lloji i taksës     | Viti 2022      |                |               | Viti 2023      |                |               |
|                                                            |                    | Plan           | Fakt           | %             | Plan           | Fakt           | %             |
|                                                            | I. TAKSA LOKALE    | 189,861        | 167,747        | 45.24%        | 268,825        | 325,467        | 121.07%       |
|                                                            | II. TARIFAT LOKALE | 411,598        | 141,587        | 34.40%        | 199,533        | 64,674         | 32.41%        |
|                                                            | III. TË TJERAT     | 32,244         | 14,587         | 45.24%        | 96,941         | 18,823         | 19.42%        |
|                                                            | <b>GJITHESEJ</b>   | <b>633,703</b> | <b>323,921</b> | <b>51.12%</b> | <b>565,300</b> | <b>408,964</b> | <b>72.34%</b> |

Burimi: Bashkia Vorë

**Konstatim:** Referuar planifikimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, për vitin 2023 në total të ardhurat janë planifikuar në vlerën **565,300 mijë** lekë me parashikim në ulje për rreth 68,403 mijë lekë ose -10.79% më pak nga plani 2022.

Realizimi i të ardhurave për vitin 2023 është në shumën **408,964 mijë lekë** duke rezultuar me mosrealizim **për 156,336 mijë lekë** ose në masën 72.34%, krahasuar me planifikim në PBA 2023-2025, në të cilin janë planifikuar 565,300 mijë lekë.

Taksat vendore u realizuan 325,467 mijë lekë ose 121.07%. Megjithatë në total taksat vendore rezultuan me tejkalim 56,641 mijë lekë ose +21.07% më shumë se parashikimi.

**Me mosrealizim rezultuan:** taksa mbi pasurinë (ndërtesë) realizuar 113,924 mijë lekë ose 81.81%, taksa e tokës bujqësore u realizua 6,358 mijë lekë ose 80.73%; taksa e truallit u realizuar 16,840 mijë lekë ose 87.30%; taksa mbi kalimin e të drejtës së pasurisë të paluajtshme u realizua 16,840 mijë lekë ose 60.79%; taksa e tabelës dhe reklamës u realizua 10,805 mijë lekë ose 68.82%.

Rezultuan **të realizuara** taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve në shumën 18,932 mijë lekë ose tejkaluar 158%; taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja u realizua 148,941 mijë lekë ose tejkalim 111%; taksa e fjetjes në hotel realizuar 3,505 mijë lekë ose tejkaluar 1001.42%.

**Tarifatat lokale** u realizuan në nivel të ulët krahasuar me parashikimin ose në shumën 64,674 mijë lekë ose 32.41%.

Të gjitha grupet e taksave rezultuan me mosrealizim ose zero realizim. **Pa arkëtuar** rezultuan: “*Tarifa e lejeve të përdorimit*” miratuar në paketën fiskale 2023 (pika II.7), parashikuar për arkëtim 63,269 mijë lekë rezultoi zero arkëtim; tarifa e akt kontrollit përfundimtar miratuar në paketën fiskale 2023 (pika II.9), parashikuar për arkëtim 58,924 mijë lekë rezultoi zero arkëtim; tarifa vendore për kërkesa “*Për leje punimesh*” jo publike për studime të reja, miratuar në paketën fiskale 2023 (pika II.9), parashikuar për arkëtim 4,316 mijë lekë rezultoi zero arkëtim; tarifë për tregun e lirë, hapësirë publike dhe parkim, miratuar në paketën fiskale 2023 (pika II.10), parashikuar për arkëtim 300 mijë lekë rezultoi zero arkëtim.

**Me mosrealizim rezultuan:** Tarifë për shërbime publike (Pastrimi + Ndotje ambienti) realizuar 57,346 mijë lekë ose 97.20%; tarifë ndriçimi publik realizuar 4,960 mijë lekë ose 95.38%; Tarifë për leje transporti realizuar 1,802 mijë lekë ose 50.42%; tarifa administrative realizuar 565 mijë lekë ose 43.48%.

Taksa “**Të tjera**” u realizuan 18,823 mijë lekë ose me mosrealizim për 78,118 mijë lekë ose në masën 19.42% krahasuar me planifikim në PBA 2023-2025, në të cilin janë planifikuar 96,941 mijë lekë.

**Me mosrealizim rezultuan:** Të ardhura nga qiraja realizuar 1,637 mijë lekë ose 72.57%; arkëtime nga detyrimet e prapambetura realizuar 1,163 mijë lekë ose 11.63%; arkëtime nga gjoba të inspektoratit të ndërtimit 1,163 mijë lekë ose 11.63%; arkëtime nga gjoba të inspektoratit ndërtimor dhe policisë bashkiake realizuar 758 mijë lekë ose 3.7%.

Me realizim rezultuan të ardhura nga TAP në shumën 4,211 mijë lekë ose tejkaluar +27.59%.

**Konstatim: Në total të ardhurat nga administrimi i taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023, realizuan në shumën 408,964 mijë lekë ose në masën 72.34% duke shkaktuar pamjaftueshmëri burimesh financiare për likuidimin e shpenzimeve të parashikuara, me ndikim në shtimin e stokut të detyrimeve të prapambetura.**

Për vitin buxhetor 2023, të ardhurat e porealizuara janë në masën **156,336 mijë lekë** kundrejt me parashikimin vjetor prej 565,300 mijë lekë.

Në analizën e realizimit të taksave dhe tatimeve sipas llojit rezultuan me mosrealizim:

- **Taksa dhe tarifa vendore** përkatësisht: taksa mbi pasurinë (ndërtesë) realizuar 113,924 mijë lekë ose 81.81%, taksa e tokës bujqësore u realizua 6,358 mijë lekë ose 80.73%; taksa e truallit u realizua 16,840 mijë lekë ose 87.30%; taksa mbi kalimin e të drejtës së pasurisë të paluajtshme u realizua 16,840 mijë lekë ose 60.79%; taksa e tabelës dhe reklamë u realizua 10,805 mijë lekë ose 68.82%.

-**Tarifat lokale** përkatësisht: Tarifë për shërbime publike (pastrimi + ndotje ambienti) realizuar 57,346 mijë lekë ose 97.20%; tarifë ndriçimi publik realizuar 4,960 mijë lekë ose 95.38%; tarifë për leje transporti realizuar 1,802 mijë lekë ose 50.42%; tarifa administrative realizuar 565 mijë lekë ose 43.48%.

- Taksa “**Të tjera**” përkatësisht: Të ardhura nga qiraja realizuar 1,637 mijë lekë ose 72.57%; arkëtime nga detyrimet e prapambetura realizuar 1,163 mijë lekë ose 11.63%; arkëtime nga gjoba të inspektoratit të ndërtimit 1,163 mijë lekë ose 11.63%; arkëtime nga gjoba të inspektoratit ndërtimor dhe policisë bashkiake realizuar 758 mijë lekë ose 3.70%.

-Të ardhura të pa planifikuara në këtë kategori është përfshirë “*Të tjera Grante nga Qeverisja Qendrore*” në shumën 10,371 mijë lekë, paraqesin të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale, bazuar në Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “*Për Taksat Kombëtare në R.Sh.*”, i ndryshuar, Ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*”, neni 25, pika 1 dhe pika 2/ç, sipas të cilit njësitë e qeverisjes vendore, përfitojnë 2 % të të ardhurave nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka transferuar të tjera Grante nga Qeverisja Qendrore, të ardhura të tatuara në burim si më poshtë:

|               |                           |                                    |
|---------------|---------------------------|------------------------------------|
| 2             | datë 31.12.2023 në shumën | 2,717,915 lekë;                    |
| 3             | datë 18.10.2023 në shumën | 3,817,653 lekë;                    |
| 4             | datë 10.07.2023 në shumën | 3,257,962 lekë;                    |
| 5             | datë 29.03.2023 në shumën | 577,772 lekë;                      |
| <b>TOTALI</b> |                           | <b>10,371,302<sup>5</sup> lekë</b> |

<sup>5</sup> Përfshihet dhe renta minerare 1 subjekt në shumën 274 lekë.

**Realizmi i të Ardhurave** për taksat dhe tarifat vendore, në mënyrë analitike paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Realizmi i të ardhurat për taksat dhe tarifat vendore 2023 (në mijë lekë)

| Lloji i taksës                                                                 | Viti 2023      |                |                |
|--------------------------------------------------------------------------------|----------------|----------------|----------------|
|                                                                                | Plan           | Fakt           | %              |
| Tatim i thjeshtuar mbi biznesin e vogël                                        | 0              | 1,056          |                |
| Taksa e ndërtesës                                                              | 139,250        | 113,924        | 81.81%         |
| Taksa e tokës bujqësore                                                        | 7,875          | 6,358          | 80.73%         |
| Taksa e truallit                                                               | 19,290         | 16,840         | 87.30%         |
| Taksa e fjetjes ne hotel                                                       | 350            | 3,505          | 1001.42%       |
| Taksa mbi kalimin e te drejtës se pasurisë te paluajtshme, tarife shitje toke  | 8,400          | 5,107          | 60.79%         |
| Taksa e regjistrimit te përvitshëm te automjeteve                              | 7,350          | 18,932         | 257.58%        |
| Taksa vendore e ndikimit ne infrastrukturë nga ndërtimet e reja                | 70,610         | 148,941        | 210.93%        |
| Taksa e tabelës, taksa reklame                                                 | 15,700         | 10,805         | 68.82%         |
| <b>I. TAKSA LOKALE</b>                                                         | <b>268,825</b> | <b>325,467</b> | <b>121.07%</b> |
| Tarifë për shërbime publike (pastrimi+ ndotje ambienti)                        | 59,000         | 57,346         | 97.20%         |
| Tarifë ndriçimi publik                                                         | 5,200          | 4,960          | 95.38%         |
| Tarifë për tregun e lire, hapësira publike dhe parkim                          | -              | -              |                |
| Taksa e shitjes se tokës                                                       | 3,650          | -              | 0.00%          |
| Tarifë për leje transporti                                                     | 3,575          | 1,802          | 50.42%         |
| Tarifë administrative.                                                         | 1,300          | 565            | 43.48%         |
| Tarifë e lejeve te përdorimit                                                  | 63,269         | -              | 0.00%          |
| Tarifë akt kontroll përfundimtar                                               | 4,316          | -              | 0.00%          |
| Tarifë vendore për kërkesa "Për leje punimesh" jo publike për studime te reja. | 58,924         | -              | 0.00%          |
| Tarifë për tregun e lire, hapësirë publike dhe parkim.                         | 300            | -              | 0.00%          |
| <b>II. TARIFAT LOKALE</b>                                                      | <b>199,533</b> | <b>64,674</b>  | <b>32.41%</b>  |
| Qira trualli                                                                   | 2,255          | 1,637          | 72.57%         |
| Detyrime te prapambetura + kamatëvonesa                                        | 10,000         | 1,163          | 11.63%         |
| Tarife administrative                                                          | -              | -              |                |
| Gjoha te inspektoratit te ndërtimit                                            | 20,505         | 758            | 3.70%          |
| Gjoha te policisë bashkiake                                                    | -              | -              |                |
| Te ardhura miratim Projekti MNZ                                                | 1,500          | 683            | 45.53%         |
| Autorizime                                                                     | 1,500          | -              |                |
| Te tjera (grant, sekuestrime, zhdëmtime)                                       | -              | -              |                |
| Takse pulle                                                                    | -              | -              |                |
| Te ardhura nga ALUIZNI                                                         | 57,881         | -              |                |
| Tap                                                                            | 3,300          | 4,211          | 127.59%        |
| Te tjera Grante nga Qeverisja Qendrore                                         | -              | 10,372         |                |
| <b>III. TË TJERAT</b>                                                          | <b>96,941</b>  | <b>18,823</b>  | <b>19.42%</b>  |
| <b>GJITHSEJ I+II+III</b>                                                       | <b>565,300</b> | <b>408,964</b> | <b>72.34%</b>  |

Raporti mbi “Raporti Monitorimit për vitin 2023” është Miratuar në Këshillin Bashkiak me Vendim nr. 6, datë 28.02.2024, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresë nr. 323/1 prot., datë 18.03.2024, në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

#### **b ) Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:**

Nga auditimi rezulton se në Rregulloren e Brendshme të institucionit të miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 214 dhe me nr. 6910 prot., datë 01.12.2022, nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimit nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt rakordimeve me agjentët tatimorë, si dhe krijimin e një data baze me të dhëna respektivisht nga agjentët tatimorë.

**Taksa vjetore e mjeteve të përdorura**, mblidhet nga Agjenti Tatimor “Vorë e Shërbimit të Transportit Rrugor/DRSHTRR Tiranë”, për llogari të Bashkisë Vorë. Në zbatim të Ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në Ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar dhe në mbështetje të gërmës “b”, të pikës 2, në nenin 25 “Të

ardhurat nga taksat e ndara” të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njësive përkatëse i kalojnë 25% e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura.

**Konstatim:** Në zbatim të Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar dhe në mbështetje të gërmës “b”, të pikës 2, në nenin 25 “Të ardhurat nga taksat e ndara” të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njësive përkatëse i kalojnë 25% e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura. Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore për taksën vjetore të mjeteve të përdorura nuk kryen rakordimet me DRSHTRR-në, në mospërputhje me nenin 4, të Ligjit nr. 9975/2002, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave kombëtare”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008 “Për sistemin e taksave kombëtare”, i ndryshuar, neni 23.

**Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël**, mblidhet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria Rajonale e Tatimeve (DRT) Tiranë”. Në zbatim të Ligjit nr. 181, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël”, nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore ku biznesi i tatueshëm është i vendosur, administrata tatimore qëndrore bën transferimin e të ardhurave nga ky tatim, brenda datës 10 të muajit pasardhës.

**Konstatim:** Për efekt të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, nuk bëhen rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, por nga ana e DRT Tiranë çdo muaj nëpërmjet shkresave zyrtare, njofton Bashkia Vorë për arkëtimin e taksës. Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, nuk janë kryer rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, duke marrë të mirëqena arkëtimet nga Dega e Thesarit Tiranë.

**Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme**, mblidhet nga Agjenti Tatimor “Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) tani ASHK, por rakordimet nuk bëhen drejtpërdrejtë, por nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë. Në zbatim të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë si komision 3% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria.

**Konstatim:** Taksa e së drejtës së kalimit të pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mblidhet dhe kalohet në buxhetin e bashkisë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tiranë. Për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, nuk janë kryer rakordimet me ASHK Vendore Tiranë dhe janë marrë të mirëqena arkëtimet nga Dega e Thesarit Tiranë.

## **Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve.**

Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Drejtoritë e tjera të Bashkisë Vorë, Agjentët Fiskalë të kontraktuar për arkëtimin e të ardhurave vendore, në funksion të realizmit të programit të të ardhurave për periudhën Janar - Dhjetor 2023, sipas tarifave të miratuara me VKB nr. 77, datë 27.12.2022 “*Mbi miratimin e tarifave dhe Taksave Vendore për vitin 2023*” ka gjeneruar të ardhura në shumën **408,964 mijë lekë**.

### **Sistemet IT mbi të cilat Bashkia Vorë regjistron detyrimet tatimore.**

1. Tatimpaguesit, që janë subjekt i ligjit “*Për sistemin e taksave vendore*”, për përlogaritjen e detyrimit tatimor, **mbajnë regjistra**, libra dhe dokumente të tjera, si **dhe lëshojnë një faturë**, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, si dhe dispozitat e ligjit “*Për tatimin mbi të ardhurat*” dhe legjislacionit në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.
2. Bashkia Vorë **nuk ka krijuar** sistem specifik të posaçëm për të dhënat për secilin tatimpagues. Regjistrat e të dhënave tatimore për taksa dhe tarifa vendore, nga punonjësit e DTTV mbahen në Microsoft Office 2013 në program “*Excel*”. Të dhënat e regjistrimeve të pagesave të tatimpaguesve në regjistrat përkatës, nuk përputhen me të ardhurat e kontabilizuara nga Sektori Financës dhe të rakorduara me Drejtorinë e Thesarit.
3. Arkëtimet e detyrimeve të prapambetura nga shumë subjekte debitorë për taksa dhe tarifave vendore **nuk janë hedhur në kodin e duhur** 7115600 “*Detyrimet e mëparshme*”, por në kodet e llogarive të taksave dhe tarifave përkatëse 7020200 “*taksë ndërtesë*”; 7020100 “*taksë e tokës bujqësore*”, etj.
4. Drejtoria e Tarifave dhe Taksave Vendore nuk kanë përfunduar procesin e verifikimit, përditësimit dhe plotësimit të dokumentacionit të dosjeve të subjekteve të biznesit të madh dhe biznesit të vogël, hedhjen kronologjike dhe sistematike në regjistrat e tatimpaguesve, sipas nenit 29/1 të Ligjit nr. 9920/2009 “*Për procedurat tatimore*”, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit.
5. Drejtoria e Tarifave dhe Taksave Vendore për kategorinë “*familjarë*” nuk ka filluar përditësimin e të dhënave të regjistrit taksapagues për pasurinë e paluajtshme për ndërtesa, tokë bujqësore, taksë trualli, për tarifën e shërbimit publik si tarifa e pastrimit, ndriçimit. Sipas kërkesave të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “*Për arkivat*” neni 24, neni 9; Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave “*Për normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*” kapitulli II, neni 21, 27 (konstatuar kjo edhe nga auditimi i mëparshëm).

**Konstatim:** Mbajtja e regjistrimeve në “*Exel*” është një menyrë manuale e mbajtjes së të dhënave, e cila mbart rrezikun e gabimit njerëzor në futjen e të dhënave, llogaritjes gabim të tarifave dhe taksave vendore. Mbajtja manuale e të dhënave pa një kopje rezerve për të gjitha subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe familjarë, si dhe klasifikimit sipas kategorisë detyrim, interes, gjobat dhe pagesat që i takojnë tatimpaguesit, mund të jetë më i prekshëm ndaj rrezikut të humbjes së të dhënave ose llogaritjes gabim të tyre, për shkak të mungesës së mekanizmave të avacuara të ruajtjes dhe mbrojtjes që mund të ofrojë një program i dedikuar për taksat dhe tarifatat vendore, në mospërputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, neni 29, pika 1.

## Vlerësimi i të ardhurave si më poshtë vijon:

### TAKSA LOKALE

#### - Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël (TTHF)

Në zbatim të Ligjit nr. 181, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël”, nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore ku biznesi i tatueshëm është i vendosur, administrata tatimore qëndrore bën transferimin e të ardhurave nga ky tatim, brenda datës 10 të muajit pasardhës.

Bazuar në regjistrin e subjekteve tatimpagues në fillim të vitit 2023, rezultojnë 986 subjekte tatimpagues të **biznesit të vogël** të cilët mbartin detyrimin e pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Gjatë vitit janë regjistruar 155 subjekte të reja, kanë mbyllur aktivitetin 82 subjekte duke regjistruar në fund të vitit 2023, **në total 1,059 subjekte** të regjistruar si biznes i vogël.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vorë, të dhënat tatimore të subjekteve tatimpagues i regjistron në program “Excel”, në mungesë të një programi të posaçëm për këtë qëllim.

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, mbledhet nga “Drejtoria Rajonale e Tatimeve (DRT) Tiranë” në rolin e **Agjentit Tatimor**, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve duhet të transferojë në buxhetin e Bashkisë Vorë të ardhurat nga TTHF.

Numri i subjekteve të biznesit të madh dhe të vogël për vitin 2023

| Nr.   | Lloji i Biznesit | Viti        | Gjendja në fillim | Regjistrime të reja | Mbyllur aktiviteti | Gjendja në fund |
|-------|------------------|-------------|-------------------|---------------------|--------------------|-----------------|
| 1     | Biznesi vogël    | 2023        | 986               | 155                 | 82                 | 1,059           |
| 2     | Biznes i madh    | 2023        | 717               | 89                  | 24                 | 782             |
| (1+2) | <b>Gjithsej</b>  | <b>2023</b> | <b>1,703</b>      | <b>244</b>          | <b>106</b>         | <b>1,841</b>    |

Për vitin 2023, në PBA 2023-2025 nuk janë planifikuar të ardhura nga Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin, por arkëtimet nga ky lloj tatimi janë realizuar në shumën **1,056 mijë lekë**.

**Konstatim:** Bashkia Vorë nuk ka planifikuar të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, në buxhetin e të ardhurave të vitit 2023, i miratuar me VKB nr. 78/2022.

Drejtoria e Tarifave dhe Taksave Vendore nuk mban akt rakordime me DRT Tiranë për subjektet tatimpagues të biznesit të vogël, për të ardhurat e gjeneruara prej tyre dhe transferimin në buxhetin e bashkisë, brenda datës 10 të muajit pasardhës.

Drejtoria e Tarifave dhe Taksave Vendore të dhënat e subjekteve tatimpagues i mban në program “Excel”, në mungesë të një programi të posaçëm tatimor.

#### - Taksë ndërtese.

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së

taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme derdhen për llogari të buxhetit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, dhe përdoren në përputhje me Ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.”

Në zbatim të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë me Vendimin nr. 77, datë 27.12.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave për vitin 2023”, ka miratuar çmimin mesatar referues për përllogaritjen e taksës për shit-blerjen e ndërtesave sipas VKM nr. 132, datë 07.03.2018 “Për Metodologjinë e përcaktimit të vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesa”, nivelin dhe shkallën e çmimit të referencës për çdo njësi administrative dhe për kategoritë e pasurisë së paluajtshme “Ndërtesa”. Këshilli Bashkiak ka vendosur të mbajë të pandryshuar nivelin e taksës në krahasim me vitin paraardhës.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, Bashkia Vorë.

Faturimi bëhet me “Njoftim Detyrimi për taksat dhe tarifatat vendore”, nga Sektori i Biznesit dhe Sektori Familjar, dhe llogaritet si detyrim vjetor.

Mbështetur dhe në arkëtimet e viteve si dhe në bazë të regjistrave të krijuar për taksën e ndërtesës në bashki dhe njësitë administrative të ardhurat u planifikuan **139,250 mijë lekë** dhe **u realizuan 113,924 mijë lekë ose 81.81%.**

Listat e debitorëve biznes i madh dhe biznes i vogël të krijuar gjatë vitit 2023, janë dërguar në Drejtorinë e Financës me qëllim kontabilizimin e detyrimeve vjetore me shkresën nr. 608 prot., datë 13.05.2024, me lista analitike për biznes i madh, biznes i vogël, dhe totalin detyrimit të papaguar. Tabela e debitorëve “Taksë Ndërtese”, për subjekte biznesi i madh, biznes i vogël, si dhe familjarë, ndodhen në rubrikën Anekse nr. 2.6.1, nr. 2.6.5 dhe 2.6.9, bashkëngjitur Raportit Përfundmtar të Auditimit.

**Konstatim:** Nga të dhënat e regjistrimeve për taksën e ndërtesës rezultoi se duhet t'i nënshtrohen taksës pavarësisht nivelit të shfrytëzimit të tyre, **783** subjekte të biznesit të madh, **1059** subjekte të biznesit të vogël dhe **4798** familjarë.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka vlerësuar taksën e ndërtesës për **402 subjekte biznes i madh, 461 subjekteve biznes i vogël, 488 familjarë**, duke mos llogaritur vlerën e taksës mbi ndërtesën ose përjashtim prej tyre sipas kriterëve të Ligjit nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 22 pika 6.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për taksapagues “Biznes” dhe “Familjarë” nuk ka përditësuar të dhënat e regjistratit të saj me të dhënat e regjistratit qëndror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra) për mbledhjen dhe menaxhimin e informacionit të përditësuar mbi ndërtesat objekt taksimi, sipas kriterëve të Ligjit nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 22/5 pika 1, gërma “b”.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore deri në fund të vitit 2023, nuk ka mundësuar bashkëpunim me Ujësjellës Kanalizime Vorë për të marrë mbi vetë rolin e agentit tatimor, veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 22, pika 1.

**Konstatim:** Listat e subjekteve debitorë nga “Taksa e Ndërtesës” përgjatë vitit 2023, për subjekte të Biznesit të Madh, rezultuan **22,983,583 lekë**, subjekte Biznes i Vogël **6,623,381 lekë** dhe debitorë Familjarë **11,923,215 lekë**, në total **41,530,179 lekë**. Kjo ka ardhur si rezultat i veprimtarisë së pamjaftueshme të informimit dhe të sensibilizimit publik mbi pagesën e “Taksës së Ndërtesës” nga strukturat përgjegjëse të bashkisë, si dhe nga

moszbatimi me rigozitet i kërkesave të Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006, i ndryshuar, neni 5. Aktiviteti i saj mjaftohet vetëm me njoftime të debitorëve, pa analizuar konfirmimin ose jo nga ana e tyre, duke çuar në mos marrjen e masave shtrënguese për të siguruar vjeljen e detyrimeve të prapambetura nga njëra anë dhe detyrimit vjetor në kohë nga ana tjetër, për të ulur si numrin e debitorëve edhe vlerën e detyrimit të akumuluar.

Listat e debitorëve nga taksa e ndërtesës, të krijuar gjatë vitit 2023, **në vlerë 11,923.215 lekë**, nuk janë dërguar në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar me qëllim kontabilizimin e detyrimeve vjetore dhe progresive dhe **konsiderohen e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vorë**, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, gërma “dh”; VKB 70/2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023” pika 3.2; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, nenin 4 pika 7, nenin 23 dhe 24; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenit 12 pika 1.

| TAKSË NDËRTESE   |                                         |                    |
|------------------|-----------------------------------------|--------------------|
| EMËRTIMI         | Nr. BIZNESEVE/ FAMILJARË QË KANË PAGUAR | VLERA              |
| Biznesi Madh     | 386                                     | 88,456,413         |
| Biznesi Vogël    | 598                                     | 14,468,840         |
| Tarifa Familjare |                                         | 10,998,622         |
| <b>TOTALI</b>    |                                         | <b>113,923,875</b> |

#### - Taksë e Tokës Bujqësore

Të ardhurat nga kjo taksë mbi pasurinë për vitin 2023, do të arkëtohet nga njësitë vendore në të cilat shtrihet sipërfaqja e tokës bujqësore e ndarë me Ligjin nr. 7501, dt.19.07.1991 në bazë të regjistrave të krijuar duke u bazuar në sipërfaqen e tokës bujqësore për çdo tatimpagues, si dhe në vlerën për çdo kategori të shprehur në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar.

Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore llogaritet si prodhim i sipërfaqes me çmimin sipas kategorisë. Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore është bërë nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ky detyrim është vjetor dhe paguhet me një kësht të vetëm. Strukturat e ngarkuara për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

**Drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Tokës**, mbështetur në regjistrat e tokës bujqësore disponon regjistrat e tokës me të dhënat e sipërfaqeve dhe kategorinë e tokave, si dhe marrëdhëniet juridike të pronësisë për familjet fermerë.

Sipërfaqja e **tokës së ndarë** me Ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 në të tre Njësitë Administrative mbi të cilën llogariten të ardhurat **është 2,814 Ha**, sipas të dhënave nga Drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Tokës, mbështetur në regjistrat e tokës bujqësore me të dhëna mbi sipërfaqen e ndarë, kategorizimin e saj dhe numrin e familjeve të trajtuara me tokë sipas Ligjit 7501/1991, i ndryshuar, e detajuar sipas Njësitë Administrative si më poshtë vijon:

Vlera e Taksës së Tokës Bujqësore (lekë/ha/vit)

| Kategorizimi        | Kategoria e tokës | Totali | Sip./HA NjA Vore | Sip./HA NjA Prezë | Sip./HA NjA Bërxullë | Niveli ligjor (Lekë/ha/vit) | Pritshmëria vjetore Lekë |
|---------------------|-------------------|--------|------------------|-------------------|----------------------|-----------------------------|--------------------------|
| Biznes              | I                 |        |                  |                   |                      |                             |                          |
| Kategoria familjare | II                | 90     | 16               | 38                | 36                   | 4900                        | 441,000                  |
|                     | III               | 399    | 82               | 150               | 167                  | 4200                        | 1,675,800                |
|                     | IV                | 255    | 68               | 91                | 96                   | 3600                        | 918,000                  |
|                     | V                 | 235    | 69               | 85                | 81                   | 3000                        | 705,000                  |
|                     | VI                | 267    | 75               | 89                | 103                  | 2400                        | 640,800                  |

|               |        |              |            |             |             |      |                  |
|---------------|--------|--------------|------------|-------------|-------------|------|------------------|
|               | VII- X | 1,568        | 438        | 567         | 563         | 1800 | 2,822,400        |
| <b>TOTALI</b> |        | <b>2,814</b> | <b>748</b> | <b>1020</b> | <b>1046</b> |      | <b>7,203,000</b> |

Burimi: DTT dhe DMAT, Bashkia Vorë

VKB 70/2022 në pikën 3.2 përcakton se “Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka. Pas vetëdeklarimit Sektori i Financave dhe Tatimeve (Tatim-Taksa) mund të bëjë verifikimin në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në rast të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do të llogaritet për të gjithë periudhën”. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur lidhur me realizimin e taksës së tokës rezultoi se:

**Konstatim:** Sipas të dhënave nga Drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Tokës, sipërfaqja e tokës së ndarë rezulton **2,814 Ha**, ndërsa sipas të dhënave të DTTV/Sektorit Familjar, numri i familjeve të trajtuara me tokë bujqësore rezulton **1,364 familje**, me sipërfaqe toke të ndarë **4,851 Ha**, të cilët duhet të arkëtojnë taksën mbi tokën bujqësore sipas klasifikimi të kategorive të tokës bujqësore, bërë nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Sipas të dhënave mbi sipërfaqen e tokës bujqësore u konstatua se të dhënat e regjistruara nga Drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Tokës dhe DTTV/Sektorit Familjar, **rezultuan mospërputhje** në sipërfaqen e tokës bujqësore, pasi ato nuk kanë rakorduar dhe nuk kanë përditësuar regjistrat e tokës për një periudhë të gjatë kohore me ndryshimet në të dhënat e sipërfaqeve dhe kategorinë e tokave, duke ndikuar në saktësinë e bazës së taksueshme dhe numrin e familjeve objekt taksën së tokës bujqësore, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23.

Ne regjistrat e llogaritjes së detyrimeve për taksën e tokës bujqësore, u konstatuan mosregjistrim të sipërfaqes së tokës mbi të cilën është regjistruar dhe paguar taksa, mos llogaritje detyrimi për emigrant, dëmtuar nga tërmeti, etj, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23, pika 2, dispozitë ligjore që përcakton përjashtimin nga taksa e tokës bujqësore, në rast se mbillet me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Bashkia nuk paraqiti korrespondencë me Këshillin e Qarkut Tiranë, për përditësimin e sipërfaqes së tokës së shpërndarë fermerëve.

Sipas të dhënave të regjistratit të DTTV/ Sektorit të Biznesit, rezultoi se kanë paguar taksën e tokës bujqësore, **36 subjekte** biznesi i madh në shumën 246,507 lekë dhe **12 subjekte** biznesi i vogël në shumën 26,930 lekë. Për kategorinë familjar rezultoi se numri i familjeve të trajtuara me tokë është **1,364 familje**, me një sipërfaqe të përgjithshme prej **4,851 Ha**, për të cilat në regjistrat janë hedhur pagesat për vitin 2023, duke llogaritur detyrim për t’u paguar në shumën **2,824,182 lekë**, nga e cila po sipas të dhënave të regjistratit në vitin 2023, janë paguar **1,746,583 lekë**, duke rezultuar debitorë për vitin 2023, në shumën **1,077,599 lekë**.

**Konstatim:** Nga auditimi evidencës së grumbulluar nga DTTV/ Sektori Familjar lidhur me të ardhurat nga “**Taksa e Tokës Bujqësore**”, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, sipas regjistratit të subjekteve familjarë të vënë në dispozicion për llogaritjen dhe pagesën e taksës së tokës bujqësore dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e saj, rezultoi se të ardhurat e munguara nga pagesa e taksës së tokës janë **1,077,599 lekë**.

Kjo ka ardhur si rezultat i veprimtarisë së pamjaftueshme të informimit dhe të sensibilizimit publik mbi pagesën e kësaj takse nga strukturat përgjegjëse të bashkisë si dhe nga moszbatimi me rigorozitet i kërkesave të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 5; në mosmarrjen e masave shtrënguese efektive për të siguruar

vjeljen e detyrimeve të prapambetura nga njëra anë dhe detyrimit vjetor në kohë nga ana tjetër, për të ulur si numrin e debitorëve edhe vlerën e detyrimit të akumuluar.

Listat e debitorëve nga taksa e tokës bujqësore, të krijuara gjatë vitit 2023, në vlerën **1,077,599 lekë**, nuk janë dërguar në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar me qëllim kontabilizimin e detyrimeve vjetore dhe progresive, dhe **konsiderohen e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vorë**, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, gërma “dh”; VKB 70/2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023” pika 3.2; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, nenin 4 pika 7, nenin 23 dhe 24; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenit 12 pika 1.

Kryetari i Bashkisë **nuk ka ngritur komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme** për tokën bujqësore, për verifikimin e vërtetësisë së vetëdeklarimit të sipërfaqes së tokës bujqësore, të dorëzuar nga subjekti tatimpagues, në mospërputhje me Paketën Fiskale 2023, paragrafi I.2 “Taksa mbi tokën bujqësore”

| TAKSË TOKË BUJQËSORE |                                           |                  |
|----------------------|-------------------------------------------|------------------|
| EMËRTIMI             | NR. BIZNESEVE/ FAMILJARËVE QË KANË PAGUAR | VLERA            |
| Biznesi Madh         | 36                                        | 246,507          |
| Biznesi Vogël        | 12                                        | 26,930           |
| Tarifa Familjare     | 1317                                      | 6,084,304        |
| <b>TOTALI</b>        |                                           | <b>6,357,741</b> |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë

Sipas Paketës Fiskale 2023, për efekt të detyrimit të pagimit të taksave të tatimpaguesit, njihen dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në rast mungese të dokumentacionit ligjor verifikimi bëhet nga Komisioni i Verifikimit të pasurive të paluajtshme për tokën bujqësore, i ngritur për këtë qëllim.

#### - Taksë truall<sup>6</sup>

Taksa e truallit aplikohet sipas kërkesave të Ligjit nr. 9632 date 30.10.2006, “Për Taksat Vendore”, i ndryshuar me Ligjin nr. 142/2015 datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Taksat Vendore”. Taksës mbi pasurinë e paluajtshme “Truall” i nënshtrohen **të gjithë personat fizikë/juridikë, vendas ose të huaj**, pronarë apo përdorues të pasurive të paluajtshme, si një sipërfaqe toke jo bujqësore, pavarësisht shfrytëzimit të tyre. Struktura përgjegjëse për mbledhjen e kësaj takse është **Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vorë**, sipas vetëdeklarimit të subjektit. Vlera e taksës për qëllime banimi nga individët është **0.14 lekë/m<sup>2</sup>** dhe për qëllime biznesi është **15.6 lekë /m<sup>2</sup>**.

Në zbatim të Ligjit nr. 9632, dt 30.10.2006 të ndryshuar, taksa mbi truallin (*jo hapësirë publike*), për vitin 2023, është planifikuar e ardhur në vlerën **19,290 mijë lekë**, e strukturuar sipas kategorive: ndërmarrjet, bizneset, dhe familjarët si më poshtë vijon:

Sipas VKB nr. 77/2023 taksa e truallit (*Jo Hapësirë Publike*), paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona. Vlera e taksës është 0.14 lekë/m<sup>2</sup>/vit për qëllime banimi nga individët dhe 12 lekë/m<sup>2</sup>/vit për qëllime biznesi.

Në zbatim të Ligjit nr. 9632, dt 30.10.2006 të ndryshuar, taksa mbi truallin (*jo hapësirë publike*), për vitin 2023 e strukturuar sipas kategorive ndërmarrjet, bizneset, dhe familjarët.

Të ardhurat për vitin 2023, nga taksa e truallit u parashikuan **19,290 mijë lekë** dhe arkëtimi u realizua në shumën **16,840 mijë lekë, ose 87.30%**, me mosrealizim për **2,450 mijë lekë**.

<sup>6</sup> Në këtë grup përfshihet dhe taksa e tokës bujqësore, taksa e tokës bujqësore për subjekte biznesi i madh dhe biznesi i vogël.

Listat e debitorëve biznes i madh dhe biznes i vogël të krijuar gjatë vitit 2023, janë dërguar në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar me qëllim kontabilizimin e detyrimeve vjetore me shkresën nr. 608 prot., datë 13.05.2024, me lista analitike për biznes i madh, biznes i vogël dhe totalin e detyrimit të papaguar. Tabelat e debitorëve “Tarifë truallit”, subjekte biznesi i madh, biznesi i vogël dhe familjarë ndodhen në rubrikën Aneks nr. 2.6.2, nr. 2.6.6, dhe nr. 2.6.10, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Konstatim:** Sipas kategorisë “**Taksë së truallit**” për vitin 2023, detyrimet për t’u paguar për subjekte të Biznesit të Madh u vlerësuan 19,039,348 lekë, nga të cilat sipas regjistrat u arkëtuar 14,931,373 lekë nga 271 subjekte, duke rezultuar me mosarkëtim për **4,107,976 lekë**. Nga Biznesi i Vogël detyrimet për t’u paguar janë vlerësuar **2,338,485 lekë** për 223 subjekte, arkëtuar 1,425,093 lekë nga 152 subjekte, duke rezultuar me mosarkëtim për **913,392 lekë**.

Listat e debitorëve nga “Taksa e Truallit” gjatë vitit 2023, të subjekteve debitorë Biznes i Madh rezultuan në vlerë 4,107,976 lekë, të biznesit të vogël rezultuan 913,392 lekë në total. Ka rritje të numrit të debitorëve për “*Taksën e Tokës së Truallit*” e cila deri në 31.12.2023 është në vlerën vjetore **5,021,368 lekë**, e cila i shtohet vlera progresive e debitorëve të akumuluar në vite.

Mosmbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara dhe moszbatimi i masave shtrënguese, në tejkalim të afatit të caktuar në legjislacionin në fuqi për pagesën e taksave dhe tarifave vendore konsiderohen, veprime në kundërshtim me pikën 3.2, VKB 70/2022 “*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023*”; Pika 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” i ndryshuar; Pika 1 të nenit 12 në Ligjin nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”.

Sektori i Financës sipas rakordimeve me thesarin nga biznesi i vogël ka arkëtuar 15,115,935 lekë për 336 subjekte dhe nga biznesi i vogël ka arkëtuar 1,589,837 lekë për 224 subjekte, për të cilat nuk ka informacion mbi kontabilizimin e tyre në regjistrat e biznesit.

| TAKSË TRUALLI    | Nr BIZNESEVE/ FAMILJARËVE QË KANË PAGUAR | VLERA             |
|------------------|------------------------------------------|-------------------|
| Biznesi Madh     | 336                                      | 15,115,935        |
| Biznesi Vogël    | 224                                      | 1,589,837         |
| Tarifa Familjare | 1803                                     | 134,096           |
| <b>TOTALI</b>    |                                          | <b>16,839,868</b> |

Burimi: DTTV dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë

#### - Taksa e fjetjes në hotel.

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel. Subjekt i taksës janë të gjithë hotelet, motelet, stabiliment turistik, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar, etj.

Për subjekte “Hotel me 4 dhe 5 yje”, me aktivitet në territorin e Bashkisë Vorë, niveli i taksës është 105 lekë, për çdo natë fjetje, për çdo person.

Për subjekte “Hotel nën 4 yje” dhe çdo njësi akomoduese të ngjashme me të, me aktivitet në territorin e Bashkisë Vorë, niveli i taksës është 35 lekë, për çdo natë fjetje, për çdo person.

Struktura përgjegjëse për mbledhjen e kësaj takse është **Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vorë** dhe të ardhurat kalojnë 100% në buxhetin e bashkisë. Të ardhurat për vitin 2023, nga taksa e truallit u parashikuan për **350 mijë lekë** dhe arkëtimi u realizua në shumën **3,505 mijë lekë**, me tejkalim për **3,155 mijë lekë**.

Gjatë vitit 2023 në kodin 7035005, taksa e hotelit është arkëtuar në vlerën 3,504,970 lekë nga 350,000 lekë që është plani. Pesha më e madhe e tejkalimit të planit, vjen si rezultat i arkëtimit nga 1 subjekt në vlerën 3,163,360 lekë ose 90% të totalit.

- **Taksa e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme (ASHK DV Kamëz - Vorë)**

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre.

Në zbatim të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë si komision 3% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria.

Agjent tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është ASHK Vendore Tiranë, e cila përfiton 3% të shumës së arkëtuar.

Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mbledhet nga Agjenti Tatimor Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tiranë, por rakordimet nuk bëhen drejtpërdrejtë, por nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë.

Të ardhurat për vitin 2023, nga taksa e truallit u parashikuan **8,400 mijë lekë** dhe arkëtimi u realizua në shumën **5,107 mijë lekë ose 60.79%**, me mosrealizim për **3,293 mijë lekë**.

**Konstatim:** Taksa e së drejtës së kalimit të pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mbledhet dhe kalohet në buxhetin e bashkisë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tiranë.

Për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, nuk janë kryer rakordimet me ASHK Vendore Tiranë, duke marrë të mirëqena arkëtimet nga Dega e Thesarit Tiranë.

- **Taksa e Regjistrimit të Përvitshëm të Automjeteve**

Në zbatim të Ligjit nr. 9975, dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, kjo taksë arkëtohet nga strukturat e DPSHTRR Tiranë dhe të ardhurat derdhen në favor të bashkisë nga të cilat përfiton 25 % të shumës së arkëtuar.

Të ardhurat e programuara nga kjo taksë për vitin 2023, bazuar në ecurinë e arkëtimit u parashikuan në vlerën **7,350 mijë lekë** dhe u realizuan **për 18,932 mijë lekë**, me tejkalim për 11,582 mijë lekë ose 257.58%.

DPSHTRR Tiranë ka rakorduar me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore me akt rakordim duke mbajtur rakordime për periudha 6- mujore me nr. 847 prot., datë 30.07.2023; nr. 123 prot., datë 29.03.2024.

- **Taksa e ndikimit në infrastrukturë (TNI)**

Në zbatim të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, “Për Taksat Vendore” neni 27, pika 2, si dhe Ligjit nr. 142/2015 datë 17.12.2015, “Për disa ndryshime në ligjin “Për Taksat Vendore” neni 14, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë, përcaktohet sipas natyrës së investimit dhe për vitin 2023, sipas VKB nr. 77/2023, bashkia ka ruajtur të njëjtat nivele si në vitin 2022. Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë përbëhet nga lejet për ndërtimet e reja dhe legalizimet.

Në paketën fiskale 2023, përcaktohet se baza e taksës është vlera e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për m<sup>2</sup> të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për kategoritë:

a- Për projekte në Infrastrukturë; b- Ndërtime të tjera (biznes); c- Shtëpi banimi; e- Ndërtime për qëllime bujqësi e blegtori; d- Për ndërtime në proces legal; f- Ndërtime për funksion prodhim industrial me materiale porositi është **Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit në Bashkinë Vorë**. Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë përbëhen nga lejet për ndërtimet e reja dhe legalizimet.

| Të ardhurat nga taksa e ndikimit në Infrastrukturë për vitin 2023 |                    |                                                            |                                                      |                       | Në lekë                                                                                                    |                   |
|-------------------------------------------------------------------|--------------------|------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|-----------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|
| Te ardhurat DPKZHT 2023                                           |                    | Takse ndikimi ne infrastrukturë nga objektet e legalizuara | Takse ndikimi ne infrastrukturë nga ndërtimet e reja | Certifikate përdorimi | Tarifa te tjera: tarife aplikimi per leje, zhvillimi, ndërtimi, certifikate përdorimi, deklarate paraprake | Te tjera          |
| Janar                                                             | 9,251,236          | 702,324                                                    | 4,402,047                                            | 3,744,228             | 150,000                                                                                                    | 252,637           |
| Shkurt                                                            | 17,455,410         | 317,670                                                    | 13,279,152                                           | 3,597,490             | 12,000                                                                                                     | 249,099           |
| Mars                                                              | 4,951,932          | 806,006                                                    | 3,252,652                                            | 763,270               | 130,005                                                                                                    |                   |
| Prill                                                             | 19,056,180         | 289,889                                                    | 18,375,275                                           | 276,016               | 115,000                                                                                                    |                   |
| Maj                                                               | 20,278,820         |                                                            | 20,238,820                                           |                       | 40,000                                                                                                     |                   |
| Qershor                                                           | 4,388,595          | 85,084                                                     | 4,233,511                                            |                       | 70,000                                                                                                     |                   |
| Korrik                                                            | 3,234,680          |                                                            | 2,922,641                                            | 227,039               | 85,000                                                                                                     |                   |
| Gusht                                                             | 1,071,860          | 419,879                                                    |                                                      | 591,982               | 60,000                                                                                                     |                   |
| Shtator                                                           | 36,435,071         | 133,993                                                    | 7,828,813                                            | 3,776,172             | 45,000                                                                                                     | 24,651,093        |
| Tetor                                                             | 8,988,852          | 429,447                                                    | 296,839                                              | 8,227,566             | 35,000                                                                                                     |                   |
| Nëntor                                                            | 20,056,682         | 727,463                                                    | 16,369,670                                           | 2,884,550             | 75,000                                                                                                     |                   |
| Dhjetor                                                           | 3,771,698          | 733,814                                                    | 2,453,018                                            | 539,866               | 45,000                                                                                                     |                   |
| <b>TOTAL</b>                                                      | <b>148,941,016</b> | <b>4,645,568</b>                                           | <b>93,652,436</b>                                    | <b>24,628,180</b>     | <b>862,005</b>                                                                                             | <b>24,651,093</b> |
|                                                                   |                    |                                                            |                                                      |                       |                                                                                                            | <b>501,735</b>    |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar

Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në total janë realizuar në vlerën 148,941,016 lekë, kundrejt planifikimit për 70,610 lekë (pa përfshirë të ardhura nga certifikatë përdorimi, tarifa të tjera: tarifë aplikimi për leje, zhvillimi, ndërtimi, certifikatë përdorimi, deklarata paraprake)

Të ardhurat për vitin 2023, përbëhen nga taksa për objektet e legalizuara arkëtuar për 4,645,568 lekë, taksa nga ndërtimet e reja arkëtuar 93,652,436 lekë, tarifë për certifikatë përdorimi arkëtuar 24,628,180 lekë, tarifa të tjera: tarifë aplikimi për leje, zhvillimi, ndërtimi, certifikate përdorimi, deklarata paraprake arkëtuar 862,005 lekë, pagesë TNI (3%) për 24,651,093 lekë, të tjera të paidentifikuara 501,735 lekë, në total **148,941,016 lekë**.

Për sa më sipër, të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë u planifikuan **70,610 mijë lekë** dhe u realizuan rreth **148,941 mijë lekë ose 210.93%, me vlerë 78,331 mijë lekë më shumë se parashikimi buxhetor**.

### 8.1 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Në zbatim të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, “Për Taksat Vendore” neni 27 pika 2, si dhe Ligjit nr. 142/2015 date 17.12.2015, “Për disa ndryshime në ligjin “Për Taksat Vendore” neni 14, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë, përcaktohet sipas natyrës së investimit dhe në vitin 2023.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Në zbatim VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Nga auditimi i të dhënave të **Regjistrimit të Lejeve të Legalizimit**, të hartuara nga Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit/Bashkia Vorë, në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje, sipas listave të dërguara nga ASHK DV Kamëz-Vorë, Bashkia Vorë ka llogaritur pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

(Regjistri elektronik për taksën e legalizimit të ndërtimeve pa leje DPKZHT/Bashkia Vorë, i detajuar për çdo njësi administrative, paraqitur në tabelë, plotësohet sipas informacionit të ardhur nga ASHK, në momentin e paraqitjes së kërkesës së debitorit për pajisjen e tij me faturën e detyrimit.

Nga auditimi për likuidimin e detyrimeve për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja.

Duke iu referuar sistemit e-Leje dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Vorë, gjatë periudhës 01.01.2023 deri 31.12.2023, janë zhvilluar 496 aplikime, ndër të cilat janë miratuar **36 leje** ndërtimi, **28 leje** rindërtimi, **35 leje** zhvillimi, **14** certifikata përdorimi dhe **29** deklarata paraprake për kryerje punimesh, leje për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **2 leje** ndërtimi, leje ndërtimi për ndërtim të ri deri në 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **12 leje** ndërtimi, të paraqitura në tabelën nr.1, si vijon:

Tabela : Të dhëna për aplikimet e zhvilluara gjatë vitit 2023 në Bashkinë Vorë.

| Nr.          | Përshkrimi i lejes                                                                                                                         | Numri i aplikimeve | Numri i miratimeve |
|--------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|--------------------|
| 1            | Certifikatë përdorimi/ procedurë e përshpejtuar                                                                                            | 124                | 74                 |
| 2            | Deklaratë paraprake për kryerje punimesh                                                                                                   | 64                 | 29                 |
| 3            | Leje infrastrukturë                                                                                                                        | 3                  | 1                  |
| 4            | Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>                                                                    | 22                 | 14                 |
| 5            | Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni                                                                                     | 4                  | 2                  |
| 6            | Leje për ndryshim funksioni                                                                                                                | 1                  | 1                  |
| 7            | Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit                                                                                            | 9                  | 6                  |
| 8            | Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues                                                                                                  | 1                  | 1                  |
| 9            | Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit                                                                                           | 7                  | 1                  |
| 10           | Leje rindër, rikonstruks dhe rip të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim vëllimi                                                     | 55                 | 27                 |
| 11           | Leje zhvillimi                                                                                                                             | 56                 | 35                 |
| 12           | Njoftim për fillim punimesh                                                                                                                | 79                 | 61                 |
| 13           | Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues                                                                                                 | 1                  | 1                  |
| 14           | Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>                                                      | 8                  | 2                  |
| 15           | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>                                                            | 20                 | 12                 |
| 16           | Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>                                               | 2                  | 2                  |
| 17           | Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni                                                                                     | 1                  | 0                  |
| 18           | Certifikatë Përdorimi                                                                                                                      | 30                 | 14                 |
| 19           | Leje rindër rikonstruks dhe rip të ndërtesës së dëmtuar me shtim apo ndryshim vëllimi                                                      | 3                  | 1                  |
| 20           | Leje ndër apo rikonstr te infrastrukturës publike apo kritike ne zonat e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore dhe ne zona te reja për zhvillim | 2                  | 1                  |
| 21           | Leje zhvillimi ne rastet e fatkeqësisë natyrore                                                                                            | 4                  | 4                  |
| <b>Total</b> |                                                                                                                                            | <b>496</b>         | <b>289</b>         |

Burimi: DPZHT, Bashkia Vorë

Nga auditimi për likuidimin e detyrimeve për lejet legalizimit të ngarkuar për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Ne zbatim të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27, pika 2/1; ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 23, taksa e ndikimit në infrastrukturë llogaritet dhe arkëtohet nga qeverisja vendore.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit strukturë administrative që planifikon dhe llogarit taksën e ndikimit në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje, konstatohet se nga ASHK DV Vorë-Kamëz, për vitin 2023 janë dërguar zyrtarisht me shkresën nr. 7946 prot., datë 30.12.2022; shkresë nr. 770 prot., datë 06.02.2023, shkresë nr. 1630 prot, datë 07.03.2023;

shkresë nr. 4264 prot, datë 13.07.2023; shkresë nr. 4984 prot., datë 18.09.2023 dhe shkresë nr. 6193 prot., datë 17.11.2023, të protokolluara në bashki lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ASHK Vorë - Kamëz.

#### **Ndjekja e detyrimeve të papaguara nga TNI**

Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, me shkresën nr. 24 prot, datë 07.02.2024, lidhur me mungesën e arkëtimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë **për objektet e legalizuara**, ka kërkuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore arkëtimin e detyrimeve të papaguara deri në 31.12.2023, të pashoqëruara me listën e subjekteve debitoare. Me shkresën nr. 717 prot., datë 06.02.2024, DPZHT ka njoftuar Agjencinë Shtetërore të Kadastrës DV Kamëz - Vorë, për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë me qëllim arkëtimin e detyrimeve të papaguara deri në 31.12.2023, në të cilën nuk është përcaktuar shuma e debisë. Tabelat e debitorëve të “Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë”, ndodhen në rubrikën Aneke nr. 2.6.11, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Konkluzion:** Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, lidhur me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për taksën e ndikimit në infrastrukturë, u konstatua se nga ASHK Drejtoria Vendore Kamëz-Vorë, janë dërguar listat e qytetarëve të shoqëruar me leje legalizimi.

Konkretisht për Bashkinë Vorë për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023, sipas regjistrit të listave të vënë në dispozicion me pajisje leje legalizimi detyrimet e parapaguara nga TNI për Bashkinë Vorë rezultuan 1,226,188 lekë, për Njësinë Bërxullë rezultuan 1,141,617 lekë dhe për Njësinë Prezë rezultuan 524,469 lekë, **në total 2,892,273 lekë** dhe progresive 41,978,172 lekë. Listat e debitorëve për TNI për periudhën 01 janar 2023 - 31 dhjetor 2023, nuk janë dërguar për kontabilizim në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, për rrjedhojë konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vorë, dhe mos arkëtim nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, pasi nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 3/c, veprime në papajtueshmëri me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, gërma “dh”.

Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit në Bashkinë Vorë, nuk ka plotësuar paraprakisht regjistrin e vet elektronik, me të dhënat që përmban vendimi për lejen e legalizimit si numrin e Zonës Kadastrale, duke sjellë mungesë informacioni mbi detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për subjektet taksapagues persona juridik/fizik.

Debitorët e TNI për leje legalizimi

Në lekë

|   | PERMBLEDHESE           | TAKSA PËR OBJEKTIN E PARË (0.5%) | TAKSA PËR OBJEKTIN E DYTË (3%) | TOTAL             | PAGUAR            | PER T'U PAGUAR    |
|---|------------------------|----------------------------------|--------------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
|   | <b>Trashëguar 2022</b> | <b>28,922,355</b>                | <b>13,652,367</b>              | <b>42,574,722</b> | <b>28,043,229</b> | <b>20,696,890</b> |
| 1 | Janar 2023             | 369,910                          | -                              | 369,910           | 288,648           | 81,262            |
| 2 | Shkurt 2023            | 222,880                          | -                              | 222,880           | 136,336           | 86,545            |
| 3 | Mars 2023              | 345,409                          | -                              | 345,409           | 229,578           | 115,832           |
| 4 | Prill 2023             | -                                | -                              | -                 | -                 | -                 |
| 5 | Maj 2023               | -                                | -                              | -                 | -                 | -                 |
| 6 | Qershor 2023           | -                                | -                              | -                 | -                 | -                 |
| 7 | Korrik 2023            | 475,401                          | -                              | 475,401           | 185,854           | 289,547           |
| 8 | Gusht 2023             | -                                | -                              | -                 | -                 | -                 |
| 9 | Shtator 2023           | 968,721                          | -                              | 968,721           | 358,397           | 610,324           |

|    |                         |                   |                      |                   |                   |                   |
|----|-------------------------|-------------------|----------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| 10 | Tetor 2023              |                   | -                    | -                 | -                 | -                 |
| 11 | Nentor 2023             | 163,889           | -                    | 163,889           | 121,211           | 42,678            |
| 12 | Dhjetor 2023            | -                 | -                    | -                 | -                 | -                 |
|    | <b>Total 2023</b>       | <b>2,546,210</b>  | <b>-</b>             | <b>2,546,210</b>  | <b>1,320,024</b>  | <b>1,226,188</b>  |
|    | <b>Totali Progresiv</b> | <b>31,468,564</b> | <b>13,652,367.00</b> | <b>45,120,932</b> | <b>29,363,252</b> | <b>21,923,076</b> |

Burimi : DPKZHT , Bashkia Vorë

Debitorët progresiv nga TNI për periudhën deri 31.12.2023

|                       | Debitorë në vitë    |                     |                    |                     |
|-----------------------|---------------------|---------------------|--------------------|---------------------|
|                       | VORË                | BËRXULLË            | PREZË              | TOTAL               |
| Gjendje më 01.01.2019 | 13,443,839.3        | 7,449,478.5         | 3,037,143.2        | <b>23,930,461.0</b> |
| Janar - Dhjetor 2019  | 1,727,082.3         | 2,731,331.1         | 849,902.6          | <b>5,308,316.0</b>  |
| Janar - Dhjetor 2020  | 284,906.5           | 246,033.7           | 109,344.8          | <b>640,285.0</b>    |
| Janar - Dhjetor 2021  | 2,534,807.5         | 991,087.5           | 1,462,827.4        | <b>4,988,722.4</b>  |
| Janar - Dhjetor 2022  | 2,680,062.70        | 1,028,531.2         | 509,520.9          | <b>4,218,114.8</b>  |
| Janar - Dhjetor 2023  | 1,226,186.70        | 1,141,617.2         | 524,469.5          | <b>2,892,273.4</b>  |
| <b>TOTAL</b>          | <b>21,896,885.0</b> | <b>13,588,079.2</b> | <b>6,493,208.4</b> | <b>41,978,172.6</b> |

Burimi : DPKZHT , Bashkia Vorë

#### - Taksë Tabele dhe Taksë Reklame.

Objekt i taksës janë subjekte tregëtare të cilët vendosin tabela identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoren për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve. Nivelet e taksës janë miratuar në paketën fiskale 2023. Taksa është vjetore. Struktura përgjegjëse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vorë. Të ardhurat për vitin 2023, nga taksa e trualit u parashikuan **15,700 mijë lekë** dhe arkëtimi u realizua në shumën **10,805 mijë lekë**, nga e cila 236 mijë nga subjekte biznes i vogël dhe 10,569 mijë lekë nga subjekte biznes i madh. Taksa e tabelës dhe reklamës rezultoi me mosrealizim për **4,895 mijë lekë** ose realizuar **68.82%**.

### TARIFAT LOKALE

#### - Tarifat e Pastrimit dhe ndotje ambienti<sup>7</sup>:

Tarifa e shërbimit për shërbimin e pastrimit nga Bashkia Vorë, përfshin shërbime të tilla si pastrimi i qytetit, tërheqja e mbeturinave urbane dhe rurale, mirëmbajtja e rrugëve, lulishte, shkolla, etj.

Kësaj tarife i nënshtrohen gjithë familjet, persona fizike dhe juridik, vendas ose të huaj, që ushtrojnë aktivitetet në territorin e Bashkisë Vorë.

Tarifa ndahet në tre kategori: 1- Familjarë; 2- Subjekte të biznesit të madh; 3- Subjekte të biznesit të vogël.

Faturimi për arkëtimin e tarifës realizohet nga struktura përgjegjëse Drejtoria e të Ardhurave dhe Tarifave Vendore.

Për Kategorinë “Familjarë” është “Sektori Familjar”, për kategoritë “Subjekte të biznesit të madh” dhe “Subjekte të biznesit të vogël” është “Sektori Biznesit”.

Tarifa e pastrimit për subjektet biznes i madh dhe biznes i vogël paguhet në bankë, ndërsa arkëtimet për “abonentë familjarë” realizohen nga vetë njësia administratave.

Për të ardhurat mujore Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore rakordon si për çdo të ardhur tjetër me specialisten e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar, për të ardhurat nga tarifa e pastrimit të rakordurara me Degën e Thesarit.

Të ardhurat nga tarifa e pastrimit u planifikuan **59,000 mijë lekë** dhe u realizuan **57,346 mijë lekë ose 97.20%**, duke rezultuar me mosrealizim për **1,654 mijë lekë**.

Listat e debitorëve biznes i madh dhe biznes i vogël të krijuar gjatë vitit 2023, janë dërguar në Drejtorinë e Financës me qëllim kontabilizimin e detyrimeve vjetore me shkresën nr. 608

<sup>7</sup> Tarifë per ndotje ambienti nuk aplikohet.

prot, datë 13.05.2024, me lista analitike për biznes i madh, biznes i vogël dhe totalin e detyrimit të papaguar. Tabelat e debitorëve “Tarifë pastrimi”, subjekte biznesi i madh, biznesi i vogël, si dhe familjarë ndodhen në rubrikën Aneke nr. 2.6.3, nr. 2.6.7 dhe nr. 2.6.12, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Konstatim:** Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Tarifave dhe Taksave vendore për vlerësimin dhe mbledhjen e të ardhurave nga “Tarifa e Pastrimit”, u konstatua se listat e debitorëve të subjekteve debitorë biznes i madh rezultuan **8,205,152 lekë**, debitorë biznes i vogël rezultuan **2,703,296 lekë** dhe debitorë të subjekteve familjarë rezultuan **7,397,258 lekë** duke shtuar debitorët për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023 në total **18,305,705 lekë**.

Listat e debitorëve nga tarifës së pastrimit, të krijuar gjatë vitit 2023 nga subjekte familjarë në shumën **7,397,258 lekë** nuk janë dërguar në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar me qëllim kontabilizimin e detyrimeve vjetore dhe progresive dhe konsiderohen e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vorë dhe mos arkëtim nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, nenin 4 pika 7, nenin 23 dhe 24; në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenit 12, pika 1; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, gërma “dh”; VKB nr. 70/2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”.

#### TARIFA E PASTRIMIT

| KATEGORIA     | Subjekte 2023 | PLAN 2023     | FAKTI 2023    |
|---------------|---------------|---------------|---------------|
| Biznesi Madh  | 628           | 41,550        | 33,345        |
| Biznesi Vogël | 841           | 10,416        | 7,712         |
| Familjar      | 1950          | 14,114        | 12,932        |
| <b>TOTALI</b> | <b>3,419</b>  | <b>66,080</b> | <b>57,346</b> |

Burimi: DTT vendore, Bashkia Vorë

#### - Tarifë ndriçimi publik

Paketa Fiskale 2023, ka përcaktuar tarifa për ndriçimin e ambienteve publike. Sipas kësaj pakete, tarifës së ndriçimit publik i nënshtrohen të gjithë personat fizik dhe juridik, vendas dhe të huaj, që ushtrojnë aktivitet tregëtar brenda Bashkisë Vorë, si dhe kategoria “familjarë<sup>8</sup>” që përfshijnë këtë shërbim. Baza e tarifës është vlere në lekë sipas kategorive, për kategoritë “Subjekte të biznesit të madh” tarifa 5.000 lekë/vit dhe “Subjekte të biznesit të vogël” tarifa 3.000 lekë /vit. Struktura përgjegjëse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore. Për “Abonentët Biznes” në Bashkinë Vorë, tarifa e ndriçimit përfshihet në “Njoftim detyrimi për taksat dhe tarifatat vendore”

Të ardhura nga tarifa vendore **ndriçimi publik nuk u parashikuan në Paketën Fiskale 2023, në PBA 2023-2025** u planifikuan **5,200 mijë lekë** dhe u realizuan **4,960 mijë lekë ose 95.38%**, duke rezultuar me mosrealizim për **240 mijë lekë**. Tabelat e debitorëve “Tarifë ndriçimi publik”, subjekte biznesi i madh dhe për subjekte biznesi i vogël, ndodhen në rubrikën Aneke nr. 2.6.4 dhe nr. 2.6.8, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Konstatim:** Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Tarifave dhe Taksave vendore për vlerësimin dhe mbledhjen e të ardhurave nga “Tarifa e Ndriçimit”, u konstatua se listat e subjekteve debitorë biznes i madh sipas regjistrimit të biznesit, detyrimet e llogaritura

<sup>8</sup> Tarifa e Ndriçimit, pas Tërmetit të 26 Nëntorit 2019, në hartimin e Paketës Fiskale 2020 është hequr për qytetin e Vorës. Në Paketën Fiskale 2020 të miratuar me VKB nr. 34, datë 24.12.2019 nuk kemi një planifikim për këtë tarifë.

janë vlerësuar 3,059,677 lekë, pagesat 2,431,683 lekë, debitorë **627,994 lekë**. Subjekte debitorë të biznesit të vogël vlerësuar 2,565,507 lekë, paguar 1,928,314 lekë, debitorë **637,193 lekë, në total 1,265,187 lekë**.

Bashkia Vorë nuk ka ushtruar kompetencat e saj për të mbledhur detyrimet e papaguara, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreu XI, nenet 88-101; Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 35 pika 2-3; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 9 pika 1.3 gërma “a”; neni 12 pika 4; neni 35 pika 2; VKB nr. 70/2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”.

#### - **Tarifë për tregun e lirë, hapësirë publike dhe parkim**

Paketa Fiskale 2023 referuar në VKB nr. 35, datë 27.06.2007, “Në përcaktimin e kategorive dhe nivelin e tarifës së tregut të lirë” ka miratuar tarifë për tregun e lirë në ambiente të mbyllura dhe ambulante, si detyrim ligjor i çdo individit që tregëton mallra për konsumatorë finalë, kundrejt tarifës së miratuar. Arkëtimi duhet bërë me mandat arkëtim, lëshuar nga agjenti i mbledhjes së tarifës së tregut të lirë.

Struktura përgjegjëse e ngarkuar për planifikimin dhe vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore, në këtë bashki.

Nga të dhënat e disponuara nuk rezulton arkëtim për taksën e tregut të lirë edhe pse u planifikua në vlerën 300,000 lekë, por nuk u konkretizua në të ardhura vendore, për shkak të mos hapjes së tregut të lirë, i cili ishte parashikuar të hapej në qytetin e Vorës, si pasojë e procesit të rindërtimit.

#### - **Tarifë për leje transporti**

Bashkia Vorë lëshon certifikata “Për transport udhëtarësh brenda vendit për llogari të vet”, me afat 1- vjeçar, licenca për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit, me afat 5-vjeçar; licenca dhe certifikata për transport udhëtarësh.

Struktura përgjegjëse e ngarkuar për planifikim dhe mbledhjen e tarifave administrative është Drejtoria e Mirëmbajtjes dhe Mbikëqyrjes së Infrastrukturës. Paketa fiskale 2023, parashikoi tarifë për leje transporti për t’u aplikuar gjatë vitit buxhetor.

Të ardhurat nga kjo tarifë sipas PBA 2023-2025, u planifikuan **3,575 mijë lekë** dhe u realizuan **1,802 mijë lekë ose 50.42%**, duke rezultuar me mosrealizim për 1,773 mijë lekë.

#### - **Tarifë administrative**

Në këtë grup të ardhurash bëjnë pjesë arkëtime nga tarifa të vendosura nga paketa fiskale 2023 për shërbime aplikim për leje ndërtimi, për aplikim për genplane, për përcjellje dokumentacioni në ASHK, etj. Struktura përgjegjëse është Sektori i Financës.

Të ardhurat nga tarifa administrative u parashikuan në paketën fiskale 2023, në PBA 2023-2025 u planifikuan 1,300 mijë lekë dhe u realizuan 565 mijë lekë ose 43.48%, duke rezultuar me mosrealizim për 735 mijë lekë.

#### - **Tarifë e lejeve të përdorimit (Certifikate).<sup>9</sup>**

Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023, ka miratuar nivelet e tarifave duke miratuar tarifë përdorimi **150 lekë/m<sup>2</sup>** për të gjithë sipërfaqen e pronës që do të konvertohet nga tokë arë në tokë truall dhe **50 lekë m<sup>3</sup>** për volumnin e objektit të ndërtuar, mbështetur në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për taksat vendore”, i ndryshuar, neni 35 pika 1/a.b dhe në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, VKB nr. 83, datë 18.08.2004 “Mbi përcaktimin e tarifave të shërbimeve publike lokale që kryhen nga zyra e Urbanistikës”, VKB nr. 28, datë 28.10.2005.

<sup>9</sup> Të ardhurat e përfituara nga tarifa për leje të përdorimit janë raportuar në të ardhurat taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe legalizimi.

Tarifa përcaktohet të përdoret për të gjitha ato sipërfaqe të cilat në gjendjen fillestare të tyre, zërin kadastral e kanë tokë arë, për arsye të zhvillimit kur kërkohet që toka arë të kthehet në tokë truall, duke rritur në këtë mënyrë vlerën e tokës për investime shtesë në këtë zonë. Tarifa për volum aplikohet për të gjitha njësitë e zhvilluara. Kjo tarifë paguhet pas njoftimit të kërkesës për pajisje me certifikatë përdorimi dhe përpara pajisjes me certifikatë përdorimi. Struktura përgjegjëse e ngarkuar për planifikimin dhe mbledhjen e kësaj tarife është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, në këtë bashki.

Bazuar në të dhënat e paraqitura nga DPZHT, rezultoi se gjatë vitit 2023, numri i aplikimeve për pajisje me certifikatë përdorimi, ka qenë 30 aplikime nga të cilat janë miratuar 14 kërkesa të paraqitura më poshtë:

| Nr. | Emërtimi i lejes së ndërtimit                                                       | Nr. Prot. i aplikimit | Aplikanti | Zhvilluesi | Vendimi                     | Totali per pagese | Fatura nr. date             | Paguar, Date |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|-----------|------------|-----------------------------|-------------------|-----------------------------|--------------|
|     |                                                                                     |                       |           |            | Certifikate Përdorimi       |                   |                             |              |
| 1   | Banese individuale 1 dhe 2 kate me mure rrethues                                    | 2317                  | S.K       | B C        | Nr. 2317/4, datë 08/08/2023 | 395,309           | Nr.2317/3, date18.07.2023   | 07.08.2023   |
| 2   | Shtëpi banimi 2 kat                                                                 | 7085                  | D.C       | A K        | Nr. 7085/4 datë 17/03/2023  | 61,100            | Nr.7085/3, date 10.02.2023  | 06.03.2023   |
| 3   | Magazine 2 kate dhe zyra 3 kate                                                     | 765                   | I R S     | S          | Nr. 765/4, datë 02/03/2023  | 3,597,490         | Nr. 765/3, date 22.02.2023  | 27.02.2023   |
| 4   | Godine shërbimi 1 kat dhe zyra 2 Kkat                                               | 966                   | I R S     | F GJ       | Nr. 966/4, datë 15/03/2023  | 702,170           | Nr. 966/3 date 06.03.2023   | 10.03.2023   |
| 5   | Godine shërbimi 2 Kat                                                               | 1066                  | E         | E          | Nr. 1066/4, datë 07/04/2023 | 276,016           | Nr. 1066/3, date 04.04.2023 | 06.04.2023   |
| 6   | Magazine + Ekspozitor + Zyra, 2 Kate                                                | 4225                  | D A       | D A        | Nr. 4225/4, datë 04/09/2023 | 1,854,100         | Nr. 4225/3, date 01.09.2023 | 02.09.2023   |
| 7   | “Strukturë Magazinimi Dhe Tregtimi Materiale Ndërtimi (Panele Sanduic, Kontenierë), | 4371                  | E         | E          | Nr. 4371/4, datë 13/09/2023 | 1,922,073         | Nr. 4371/3, date 04.09.2023 | 12.09.2023   |
| 8   | Magazine 1 Kat Dhe Zyra 2 Kat Me Mur Rrethues                                       | 4668                  | I R S     | S C        | Nr. 4668/4, datë 09/10/2023 | 8,227,566         | Nr.4668/3, date05.10.2023   | 09.10.2023   |
| 9   | Sillojë për fabrikën e miellit                                                      | 7016                  | A         | A          | Nr. 7016/4, datë 19/01/2023 | 3,744,228         | Nr. 7016/3, date 10.01.2023 | 11.01.2023   |
| 10  | Godine Me Funksion Industrial, Magazine, Shërbime Dhe Zyra                          | 5436                  | A M       | A M        | Nr. 5436/4, datë 15/12/2023 | 529,866           | Nr. 5436/3, date 13.12.2023 | 15.12.2023   |
| 11  | Godine Banimi Dhe Shërbimi 1-5-6-7- 8 Kate, Dhe 1 Kat Nentoke                       | 6172                  | A         | A          | Nr. 6172/4, datë 15/11/2023 | 2,884,550         | Nr.6172/3, date 15.11.2023  | 15.11.2023   |
| 12  | Objekt Banimi 1 Kat + 1 Kat bodrum                                                  | 2296                  | A         | I L        | Nr. 2296/4, datë 08/08/2023 | 196,673           | Nr.2296/3, date 26.07.2023  | 03.08.2023   |
| 13  | Objekt Sherbimi 1 Kat Dhe Zyra 2 Kat                                                | 3186                  | A S       | D G        | Nr. 3186/4, datë 18/07/2023 | 182,039           | Nr.3186/3, date 03.07.2023  | 11.07.2023   |
| 14  | Prishje e objektit ekzistues dhe ndertim objekt i ri 2 kate                         | 2665                  | R D       | K B        | Nr. 2665/4, datë 02/08/2023 | 45,000            | Nr. 2665/3, date 11.07.2023 | 20.07.2023   |
|     |                                                                                     |                       |           |            |                             | <b>24,618,181</b> |                             |              |

Burimi: Bashkia Vorë

Paketa fiskale 2023, parashikoi tarifë për lejeve të përdorimit për t'u aplikuar gjatë vitit buxhetor. Të ardhurat nga kjo tarifë sipas PBA 2023-2025, u planifikuan 63,269 mijë lekë dhe u realizuan 24,618, mijë lekë ose realizuar 38.91%, duke rezultuar me mosrealizim për 38,651 mijë lekë.

#### **Të ardhura nga tarifa vendore për dhënien me qira të fondit pyjor dhe kullosor.**

Bazuar në VKM nr. 134, datë 03.03.2021, “Për disa ndryshime në VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive” , Bashkisë Vorë i janë transferuar sipërfaqet pyjore dhe kullosore, sipas listës së inventarit, që transferohen në pronësi të bashkisë, bashkëlidhur këtij vendimi, e cila përmban listën e inventarit që fillon me numrin rendor 1 (një) deri 107 (njëqind e shtatë), VKM nr.

1108/2015 ka transferuar 23 prona (njëzet e tre), VKM nr. 577/2009 ka transferuar 177 prona në pronësi dhe 80 në përdorim, VKM nr. 792/2011 ka transferuar 190 prona nga të cilat 185 në pronësi dhe 5 në përdorim; VKM nr. 1495/2008 janë transferuar 92 prona nga të cilat 84 në pronësi dhe 8 në përdorim.

Ministria e Punëve të Brendshme me shkresën nr. 4467/7 prot, datë 11.06.2009, “Për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike sipas inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave/bashkive” ka miratuar listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Vorë. Sipas listës së inventarit përcaktuar në VKM nr. 433/2016 në bashkinë Vorë janë transferuar kullota **gjithsej 1,790.93 ha**, nga e cila kullota verore 329.99 ha, pyje 1,397.31 ha dhe toka jo produktive (shkëmbore) 63.63 Ha.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, pyjore

|                                | Sipërfaqja /ha  | Kontrata me afat 1- vjeçar | Sipërfaqja e kontraktuar (m2) | Sipërfaqja e pashfrytëzuar | Të ardhura |
|--------------------------------|-----------------|----------------------------|-------------------------------|----------------------------|------------|
| Kullota verore                 | 329.99          | -                          | -                             | -                          | -          |
| Kullota dimërore               | -               | -                          | -                             | -                          | -          |
| <b>Kullota gjithsej</b>        | 329.99          | -                          | -                             | -                          | -          |
| Pyje                           | 1,397.31        | -                          | -                             |                            |            |
| Toka jo produktive (shkëmbore) | 63.63           |                            |                               |                            |            |
|                                | <b>1,790.93</b> |                            |                               |                            |            |

Burimi: Sektori Pyjeve dhe Kullotave

Bashkia Vorë për përdorimin e fondit pyjor dhe kullosor për kullotje së bagëtie, nuk ka nënshkruar kontratë për dhënie me qira të sipërfaqeve në përdorim për subjekte me status biznes/fermerë, për të gjeneruar të ardhura nga kjo tarifë.

### III. TË ARDHURA “TË TJERA”

#### - Qira trualli

Taksa e qirasë, llogaritet dhe arkëtohet sipas kontratave të nënshkruara nga Bashkia me subjekte të interesuar për marrje më qira të truallit në pronësi të bashkisë. Struktura përgjegjëse e ngarkuar për planifikimin dhe mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në këtë bashki.

Nga të dhënat pasqyruar në tabelën e kontratave të qirasë, rezulton se janë lidhur kontrata qiraje me **4 subjekte** për afate të ndryshme kohore, nga të cilat 3 subjekte i përkasin biznesit të madh dhe 1 subjekt biznes i vogël. Të ardhurat nga taksa e qirasë për truall në pronësi të bashkisë u planifikua 2,255 mijë lekë dhe u realizua 1,637 lekë, ose në masën 72.57%.

Në të ardhurat nga qiraja e truallit vazhdon të rritet gjendja debitore nga subjekti “A D”, për të cilin DTTV ka llogaritur të ardhura nga qiraja për vitin 2023, në total 908,464 lekë nga të cilat 304,900 lekë janë qira.

Listat e debitorëve biznes i madh dhe biznes i vogël të krijuar gjatë vitit 2023, janë dërguar në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar me qëllim kontabilizimin e detyrimeve vjetore me shkresën nr. 608 Prot, datë 13.05.2024, me lista analitike për biznes i madh, biznes i vogël dhe totalin e detyrimit të papaguar.

**Konstatim:** Subjekti “A D” nuk ka paguar detyrimin sipas kontratës 01.06.1994 me afat 99 vjet, me detyrim vjetor 3,049 \$, debia e të cilit që nga data e lindjes së borxhit deri në 31.12.2023 arrin në vlerën **24,392 \$**, e konvertuar me kursin e BSH në vlerën progresive **7,921,949 lekë**. Për vitin 2023, debia rezulton **908.464 lekë** nga e cila debia për qiranë rezulton **304,900 lekë**.

|   | Subjekti | Kontrata                                                   | Data       | Afati në vite | Sipërfaqja në ha      | Vlera e kontratës në lekë/vit |
|---|----------|------------------------------------------------------------|------------|---------------|-----------------------|-------------------------------|
| 1 | K A A    | Shkrese transferimi nr. 2664/1, dt 10.4.2017 <sup>10</sup> | 19.12.1992 | 99 vjet       | 50000 m <sup>2</sup>  | 13250 \$                      |
| 2 | A D      | -                                                          | 01.06.1994 | 99 vjet       | 9240 m <sup>2</sup>   | 3049 \$                       |
| 3 | V A sha  | Nr. 69, dt 06.01.2023                                      | 11.01.2022 | 1 vit         | 200 m <sup>2</sup>    | 232,800 leke                  |
| 4 | E M      | Nr. Repertori 5482                                         | 02.11.2022 | 10 vjet       | 29,500 m <sup>2</sup> | 195,800 leke                  |

Debia e të cilit që nga data e lindjes së borxhit deri në 31.12.2023

|                | Gjendja 31.12.2022 | Shtesë         | Pakësim | Gjendja 31.12.2023 |
|----------------|--------------------|----------------|---------|--------------------|
| Qira           |                    | 304,900        | -       |                    |
| Takse ndërtese |                    | 498,108        | -       |                    |
| Takse trualli  |                    | 105,456        | -       |                    |
| <b>Total</b>   | <b>7,013,485</b>   | <b>908,464</b> | -       | <b>7,921,949</b>   |

#### - Detyrime të prapambetura & kamatëvonesa.

Të ardhurat nga debitorë, paraqet të ardhura për buxhetin e bashkisë nga arkëtime për “Detyrime të prapambetura”, nga taksat dhe tarifat vendore, brenda afateve të përcaktuara në paktën fiskale për çdo vit ushtrimor, për të cilat organi vendor dhe strukturat përkatëse kanë aplikuar masa shtrënguese sipas dispozitave të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”.

**Konkluzion:** Bashkia Vorë me VKB nr. 77 datë. 30.11.2022 “Për Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për Vitin 2023” ka planifikuar të gjenerojë të ardhura nga arkëtimi i debitorëve në shumën **10,000 mijë lekë**. Në fakt arkëtimi i debitorëve u realizua **2,501 mijë lekë** ose **në masën 11.63%**, të ardhura nga tarifa dhe taksa vendore, duke rezultuar me mungesë të ardhurash për **(8,837 mijë lekë) ose 0.38%** kundrejt borxhit të akumuluar progresiv 302,825,456 lekë datë 31.12.2023.

Aktiviteti i strukturave bashkiake për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura, deri në 31.12.2023, është mjaftuar vetëm me njoftime të debitorëve, pa analizuar konfirmimin ose jo konfirmimin e marrjes dijeni prej tyre, për të vijuar me procesin e marrjes së masave shtrënguese.

Për vitin 2023, mosveprimet e strukturave bashkiake për të siguruar vjeljen e detyrimeve të prapambetura dhe detyrimit vjetor, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreut XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar. Strukturat bashkiake nuk llogaritin kamatëvonesa për detyrimin tatimor të papaguar.

#### - Gjoha të inspektoratit të ndërtimit dhe Gjoha të policisë bashkiake

Policia bashkiake kryen detyrat e saj funksionale sipas përcaktimit në Ligjin nr. 8224, datë 15.05.1998 “Për policinë bashkiakë të komunës”, i ndryshuar. Në drejtimin e kryeinspektorit merr pjesë në zbatimin e akteve të nxjerra nga organet e bashkisë, sipas kompetencave të parashikuara në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Bashkia Vorë me VKB nr. 77 datë. 30.11.2022 “Për Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për Vitin 2023” ka planifikuar të gjenerojë të ardhura nga gjoha të inspektoratit të

<sup>10</sup> “K A” përthithur nga “K A A” me NIPT LC

ndërtimit dhe gjoba të policisë bashkiake në vlerën **20,505 mijë lekë**. Në fakt arkëtimi i debitorëve u realizua **për 758 mijë lekë ose 3.7%**, duke rezultuar me mosrealizim të planit.

**- Të ardhura nga tarifa për tregëtim karburanti (Autorizime).**

Pagesa për pajisje me autorizim për tregëtim karburanti, mbështetur në nenin 77-78 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, dhe paragrafin 77-78 të Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar.

**Drejtoria e Transportit**, jep autorizime për tregëtimin e karburantit me pakicë të njërive të shitjes së lëndëve djegëse. Ajo paraqiti listën e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregëtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë. Sipas të dhënave të strukturës përgjegjëse e ngarkuar për planifikimin dhe mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në këtë bashki. Për vitin 2023, kanë ushtruar aktivitet **15 subjekte** pasqyruar si më poshtë vijon:

| Nr. | SUBJEKTI     | NIPT | Pajisur me autorizim                                    | Mbaron afati i autorizimit | Niveli tarifës sipas VKM nr. 344 | Pagesë te bëra deri 31.12.2022 | Pagesa gjatë vitit 2023 | Detyrim e për pagesë |
|-----|--------------|------|---------------------------------------------------------|----------------------------|----------------------------------|--------------------------------|-------------------------|----------------------|
| 1   | M shpk       | L A  | 06.05.2019                                              | 06.05.2024                 | 1,000,000                        | 1,000,000                      |                         | -                    |
| 2   | S G sh.p.k   | K V  | 14.4.2022                                               | 14.4.2027                  | 1,000,000                        | 1,000,000                      |                         | -                    |
| 3   | S G sh.p.k 1 | K V  | 17.11.2021                                              | 17.11.2026                 | 1,000,000                        | 400,000                        | 600,000                 | -                    |
| 4   | S G sh.p.k 2 | K V  | 17.11.2021                                              | 17.11.2026                 | 1,000,000                        | 400,000                        | 600,000                 | -                    |
| 5   | A F L O shpk | L M  | 23.02.2023                                              | 23.02.2028                 | 1,000,000                        |                                | 700,000                 | 300,000              |
| 6   | I            | K K  | 28.10.2021                                              | 28.10.2026                 | 1,000,000                        | 600,000                        | 400,000                 | -                    |
| 7   | E-C          | K G  | 25.11.2022                                              | 25.11.2027                 | 1,000,000                        | 600,000                        | 400,000                 | -                    |
| 8   | O B- O       | J I  | 9.10.2019                                               | 9.10.2024                  | 1,000,000                        | 1,000,000                      |                         | -                    |
| 9   | G C          | K T  | 31.12.2019                                              | 31.12.2024                 | 1,000,000                        | 1,000,000                      |                         | -                    |
| 10  | V Shpk       | K K  | 28.10.2021                                              | 28.10.2026                 | 1,000,000                        | 600,000                        | 400,000                 | -                    |
| 11  | V P          | K K  | 28.10.2021                                              | 28.10.2026                 | 1,000,000                        | 600,000                        | 400,000                 | -                    |
| 12  | A Z D        | L E  | 12.11.2019                                              | 11.11.2024                 | 1,000,000                        | 1,000,000                      |                         | -                    |
| 13  | K            | J P  | 20.04.2023                                              | 20.04.2028                 | 1,000,000                        |                                | 400,000                 | 600,000              |
| 14  | B T          | M R  | nuk ka autorizim sepse nuk ka plotësuar dokumentacionin |                            | 1,000,000                        | 1,000,000                      |                         | 1,000,000            |
| 15  | K -O         | LB   | 04.07.2023                                              | 04.07.2028                 | 1,000,000                        | 400,000                        | 200,000                 | 400,000              |
|     |              |      |                                                         |                            | <b>15,000,000</b>                | <b>9,600,000</b>               | <b>4,100,000</b>        | <b>2,300,000</b>     |

Burimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vorë

Sipas VKB 73/2022, tarifat për dhënie licenca për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj për: 1- Dhënie dhe përsëritje e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante **1,000,000 lekë/licencë 5-vjeçare**; 2- Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregëtimin për përdorim nga konsumatorët fundorë **100,000 lekë/licencë 5- vjeçare**. Pagesa të kryhet në mënyrë përpjesëtimore: 1/5 e Tarifës para marrjes së licencës dhe çdo fillim viti pasardhës nga 1/5 deri në realizim të tarifës së plotë.

**Konstatim:** Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vorë, u konstatua se në territorin nën juridiksionin e saj territorial ushtrojnë aktivitet të tregëtimin me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre **15 subjekte**, të cilat duhet të jenë të pajisura me autorizim nga bashkia për tregëtim me pakicë të hidrokarbureve dhe duhet të paguajnë 6,400,000 lekë detyrime për vitin 2023.

Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregëtimin dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga 15 subjekte, subjekti “**B T**” nuk ka autorizim 5- vjeçar dhe për mungesë dokumentacioni nuk ka përfituar autorizim. Gjatë vitit 2023, kanë autorizim dhe janë paguar pjesërisht detyrimet në vlerën 4,100,000 lekë total. Ndërsa 4

subjekte nuk kanë paguar detyrimin për ushtrimin e aktivitetin deri në 31.12.2023, **në vlerën 2,300,000 lekë**, në mospërputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 344, datë 19.04.2017, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vorë, pasi nuk rezultojnë debitorë në listat e debitorëve për vitin 2023, dërguar me shkresë nr. 608 prot., datë 13.05.2024.

**- Të ardhura, miratim Projekti MNZ**

Bashkia Vorë në paketën fiskale 2023, ka planifikuar 1,500 mijë lekë të ardhura nga aplikimi i tarifës për mbrojtje nga zjarri dhe ka realizuar 683 mijë lekë ose 45.53%. Struktura përgjegjëse e ngarkuar për planifikimin dhe mbledhjen e kësaj takse është Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri.

**- Të ardhura nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (TAP)**

Të ardhurat nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale është detyrim ligjor që buron nga Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare në R.Sh.”, i ndryshuar, Ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 25 pika 1 dhe pika 2/ç.

Njësitë e qeverisjes vendore, përfitojnë 2% të të ardhurave nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale. Agjenti Fiskal i mbledhjes së kësaj takse kombëtare është Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë. Struktura përgjegjëse për rakordimin me agjentin fiskale dhe ndjekjen e realizimit të detyrimeve deri në prezantimin e tyre në buxhetin e bashkisë është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, Bashkia Vorë. Realizimi i të ardhurave nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale u parashikuan rreth **3,300 mijë lekë dhe u realizuan 4,211 mijë lekë ose 911 mijë lekë** më shumë se parashikimi buxhetor ose realizuar 127.59%.

**- Te tjera Grante nga Qeverisja Qendrore**

Të ardhurat nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale është detyrim ligjor që buron nga Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare në R.Sh.”, i ndryshuar, Ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 25 pika 1 dhe pika 2/ç. Njësitë e qeverisjes vendore, përfitojnë 2% të të ardhurave nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale.

Të tjera Grante nga Qeverisja Qendrore paraqet të ardhura të tatuara në burim të transferuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për të ardhura bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët ( *përfshirë edhe renta minerare, 1 subjekt në shumën 274 lekë* ).

|               |                                  |                        |
|---------------|----------------------------------|------------------------|
| 6             | datë 31.12.2023 në shumën        | 2,717,915 lekë;        |
| 7             | datë 18.10.2023 në shumën        | 3,817,653 lekë;        |
| 8             | datë 10.07.2023 në shumën        | 3,257,962 lekë;        |
| 9             | <u>datë 29.03.2023 në shumën</u> | <u>577,772 lekë;</u>   |
| <b>TOTALI</b> |                                  | <b>10,371,302 lekë</b> |

**Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve.**

Trajtuar me gjerësisht në pikën 4.2, të Program të Auditimit nr. 1089/1 prot, datë 11.09.2024, i ndryshuar.

**Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.**

Në zbatim të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 5 “Rregulla të përbashkëta për taksat vendore”, dhe Paketa Fiskale për vitin 2023 miratuar me VKB nr. 77, datë 27.12.2022 “Për miratimin e taksave dhe Tarifave vendore për Bashkinë e Vorës, për vitin 2023”, konfirmuar nga prefekti i qarkut me shkresë nr. 2400/2 prot, datë 05.01.2023, afatet përfundimtare për pagesën e taksave dhe tarifave vendore janë për subjektet e biznesit të madh dhe biznesit të vogël deri më datë 30 Prill 2023 dhe për kategorinë “familjarë” më datë 20 Qershor 2023.

Në rast të mospagesës së detyrimit brenda afateve të mësipërme nga ana e subjekteve “familjarë” dhe “biznes”, duhet të merren masa shtrënguese sipas dispozitave të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, për aq sa nuk rregullohen me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore me shkresën nr. 691 prot., datë 05.02.2024, në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 608 prot., datë 13.05.2024 ka dërguar për regjistrim në kontabilitet listën e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore për vitin 2023. Detyrimet e papaguara të tatimpaguesve persona fizike, juridike të deklaruar si detyrime të pa arkëtuara në kohë për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023, nga të ardhurat nga Bashkia Vorë në **total janë raportuar 302,825,456 lekë**, duke rritur borxhin progresiv nga mos arkëtimet e të ardhurave vendore **për 31,091,825 lekë**.

*Nga auditimi mbi evidentimin e detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor 2023, sipas programit të auditimit u konstatua se:*

Në regjistrimin e kontabilitetit të debitorëve për vitin 2023, nuk janë përfshirë detyrimet tatimore të pa arkëtuara në kohë nga të ardhurat tatimore për kategorinë biznes (pjesërisht), kategorinë familjare, taksa e ndikimit në infrastrukturë për leje legalizimi, etj, veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 15, Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 52, neni 54 dhe Urdhrit nr. 68 prot., datë 05.02.2024 të Kryetarit të Bashkisë Vorë.

Nga auditimi mbi evidentimin e detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor 2023, sipas evidencës së marrë nga grupi i auditimit deri në 31.12.2023 borxhi tatimor rezultoi **376,288,910 lekë ose +73,463,454 lekë, i pa evidentuar në stokun e borxhit për 31.12.2023 ose 24 %** më shumë se gjendja e stokut në datë 31.12.2023.

Nga analiza e evidencës së grumbulluar për llogaritjen dhe pagesën e të ardhurave vendore, për periudhën e audituar u konstatua se:

-Nuk janë përfshirë në kontabilitet detyrimet tatimore të pa arkëtuara në kohë nga biznesi i madh në vlerën **16,393,665 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara të Bashkisë Vorë për vitin 2023.

-Nuk janë përfshirë në kontabilitet detyrimet tatimore të pa arkëtuara në kohë nga biznesi i vogël në vlerën **6,560,016 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara të Bashkisë Vorë për vitin 2023.

-Nuk janë përfshirë në kontabilitet detyrimet tatimore të pa arkëtuara në kohë nga debitorë familjarë (taksë ndërtese, tokë bujqësore, taksë trualli) për vlerën **23,290,345 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara të Bashkisë Vorë për vitin 2023.

-Nuk janë përfshirë në raportim detyrimet vendore të pa arkëtuara në kohë “Debitorë ndër vite” që i përkasin periudhës 2004-2020, në vlerën **27,219,428 lekë**.

Bashkia ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore” për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara, për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor.

Përmbledhës e regjistrit të borxhit 31.12.2023

| Statusi Biznesit | Numri debitorëve | Detyrim            | Penalitete        | Kamatëvonesë | Total              |
|------------------|------------------|--------------------|-------------------|--------------|--------------------|
| BM               | 210              | 247,577,534        | 55,748,976        | 0            | 304,275,776        |
| BV               | 372              | 1,100,862          | 245,166           | 0            | 1,346,028          |
| <b>Totali</b>    | <b>582</b>       | <b>248,678,396</b> | <b>55,994,142</b> | <b>0</b>     | <b>305,621,804</b> |

Burimi: DTT Vendore/ Sektori i Borxhit

**Konkluzion:** Borxhi tatimor për taksa e tarifa vendore më datë 31.12.2023, sipas regjistrit të borxhit të Sektorit të Borxhit për subjekte të biznesit të madh rezulton 210 subjekte me detyrim debitor 247,577,534 lekë, penalitete 55,748,976 lekë dhe në total 304,275,776 lekë;

Për subjekte të biznesit të vogël rezultojnë 372 subjekte me detyrim debitor 248,678,396 lekë, penalitete 55,994,142 lekë e në total 1,346,028 lekë; Për subjektet familjarë **nuk disponohet regjistër** për detyrime të papaguara për taksën e ndërtesës, taksën e tokës bujqësore, taksën e truallit, etj.

Detyrimet tatimore të pa arkëtuara në kohë nga të ardhurat tatimore në Bashkisë Vorë sipas statusit të biznesit pasqyrohen në tabelën si më poshtë vijon:

*Debitorë sipas statusit viti 2023*

*Në lekë*

| Përshkrimi                        | Vlera<br>progresive<br>31.12.2022<br>(bashkia) | Paguar           | Shtuar            | Vlera<br>progresive<br>31.12.2022<br>(bashkia) | Vlera<br>progresive<br>31.12.2022<br>(KLSH) | Ndryshimi         |
|-----------------------------------|------------------------------------------------|------------------|-------------------|------------------------------------------------|---------------------------------------------|-------------------|
| Debitorët biznes i madh           | 199,899,496                                    | 1,709,703        | 24,449,207        | 222,639,000                                    | 239,032,665                                 | 16,393,665        |
| Debitorët biznes i vogël          | 24,922,649                                     | 2,325,372        | 6,642,618         | 29,239,895                                     | 35,799,911                                  | 6,560,016         |
| Debitorët Familjar                | 50,946,561                                     | 0                | 0                 | 50,946,561                                     | 74,236,906                                  | 23,290,345        |
| Debitorë ndër vite<br>(2004-2020) | 27,219,428                                     | 0                | 0                 | 0                                              | 27,219,428                                  | 27,219,428        |
| <b>Total Borxhi</b>               | <b>302,988,134</b>                             | <b>4,035,075</b> | <b>31,091,825</b> | <b>302,825,456</b>                             | <b>376,288,910</b>                          | <b>73,463,454</b> |

Burimi: DTT Vendore; DMF Punoi:KLSH

Nga analiza e debitorëve rezultoi se:

1. Për **“taksën e ndërtesës”** e cila deri në 31.12.2023, është në vlerën progresive 41,530,179 lekë, nga e cila 11,923,215 lekë është e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë nga Sektori Familjar. Kjo ka ardhur si rezultat i veprimtarisë së pamjaftueshme të informimit dhe të sensibilizimit publik mbi pagesën e **“taksës së ndërtesës”** nga strukturat përgjegjëse të bashkisë, si dhe nga moszbatimi me rigorozitet i kërkesave të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 i ndryshuar, neni 5; Aktiviteti i saj mjaftohet vetëm me njoftime të debitorëve, pa analizuar konfirmimin ose jo nga ana e tyre, duke çuar në mos marrjen e masave shtrënguese për të siguruar vjeljen e detyrimeve të prapambetura nga njëra anë dhe detyrimit vjetor në kohë nga ana tjetër, për të ulur si numrin e debitorëve edhe vlerën e detyrimit të akumuluar.

2. Nga auditimi i dokumentacionit, rezultoi se numri i debitorëve të krijuar nga mospagimi i taksës së **“ndikimit në infrastrukturë”** për periudhën 01.01.2023 deri në 31.12.2023 është i lartë 2,892,273 lekë, **vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vorë.**

3. Ka një rritje të numrit të debitorëve për **“Taksën e Tokës Bujqësore”** e cila deri në 31.12.2023, është në vlerë vjetore 1,077,599 lekë e cila i duhet t’i shtohet vlerën progresive të debitorëve të akumuluar në vite (pa të dhëna). Kjo ka ardhur si rezultat i veprimtarisë së pamjaftueshme të informimit dhe të sensibilizimit publik mbi pagesën e kësaj takse nga strukturat përgjegjëse të bashkisë si dhe nga moszbatimi me rigorozitet i kërkesave të Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 **“Për Sistemin e Taksave Vendore”**, i ndryshuar, neni 5; në mos marrjen e masave shtrënguese efektive për të siguruar vjeljen e detyrimeve të prapambetura nga njëra anë dhe detyrimit vjetor në kohë nga ana tjetër, për të ulur si numrin e debitorëve edhe vlerën e detyrimit të akumuluar.

4. Ka një rritje të numrit të debitorëve për **“Taksën e Tokës Truallit”** e cila deri në 31.12.2023 është në vlerën vjetore 5,021,368 lekë e cila i shtohet vlerës progresive të debitorëve të akumuluar në vite. Kjo ka ardhur si rezultat i veprimtarisë së pamjaftueshme mbi pagesën e kësaj takse nga strukturat përgjegjëse të bashkisë, si dhe nga moszbatimi me rigorozitet i kërkesave të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 **“Për Sistemin e Taksave Vendore”**, i ndryshuar, neni 5; në mos marrjen e masave shtrënguese efektive për të siguruar vjeljen e

detyrimeve të prapambetura nga njëra anë dhe detyrimit vjetor në kohë nga ana tjetër, për të ulur si numrin e debitorëve edhe vlerën e detyrimit të akumuluar. Listat e debitorëve nga taksa e tokës truallit, të krijuar gjatë vitit 2023, nuk janë dërguar në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar me qëllim kontabilizimin e detyrimeve vjetore dhe progresive sipas llojit të taksës, veprime në papajtueshmëri me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, gërma “dh”.

5. Ka një rritje të numrit të debitorëve për “**Tarifën e Ndriçimit**”, ku u konstatua se listat e debitorëve të subjekteve debitorë biznes i madh, e cila deri në 31.12.2023 është në vlerë vjetore **1,265,187 lekë**, e cila i shtohet vlerës progresive të debitorëve të akumuluar në vite. Bashkisë Vorë nuk ka ushtruar kompetencat e saj për të mbledhur detyrimet e papaguara, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreu XI, nenet 88-101; Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 35 pika 2-3; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 9 pika 1.3 gërma “a”; neni 12 pika 4; neni 35 pika 2; VKB nr. 70/2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”.

6. Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vorë, u konstatua se në territorin nën juridiksionin e saj territorial ushtrojnë aktivitet të tregtimit me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre **15 subjekte** të cilat duhet të jenë të pajisura me autorizim nga bashkia për tregëtim me pakicë të hidrokarbureve dhe duhet të paguajnë 6,400,000 lekë detyrime për vitin 2023. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua 4 subjekte nuk kanë paguar detyrimin për ushtrimin e aktivitetin deri në 31.12.2023 **në vlera 2,300,000 lekë**, në mospërputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 344, datë 19.04.2017, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vorë, pasi nuk rezultojnë debitorë në listat e debitorëve për vitin 2023, dërguar me shkresë nr. 608 prot., datë 13.05.2024.

7. Subjekti “A D” nuk ka paguar detyrimin sipas kontratës 01.06.1994 me afat 99 vjet, me detyrim vjetor 3,049 \$, debia e të cilit që nga data e lindjes së borxhit deri në 31.12.2023 arrin në vlerën **24,392 \$**, e konvertuar me kursin e BSH në vlerën progresive **7,921,949 lekë**. Për vitin 2023, debia rezulton **908,464 lekë** nga e cila debia për qiranë rezulton **304,900 lekë**. Në zbatim të procedurave të arkëtimit të debitorëve, sipas regjistrit të borxhit tatimor, nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të vendosjes së masave shtrëngese për mbledhjen e borxhit tatimor, në kundërshtim me kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

**Konkluzion:** Nga auditimi i të dhënave lidhur me detyrimet e pa arkëtuara në kohë nga të ardhurat tatimore vendore nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore; Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit u konstatua se për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023 debitorët e biznesit të madh u shtuan 39,133,169 lekë dhe progresiv rezultuan 239,032,665 lekë, debitorët biznes i vogël u shtuan 10,877,262 lekë dhe progresiv 35,799,911 lekë, debitorët familjarë u shtuan 23,290,345 lekë dhe progresiv 74,236,906 lekë dhe debitorë ndër vite që i përkasin periudhës 2004-2020, nuk kanë pësuar ndryshim duke rezultuar në vlerë progresive 27,219,428 lekë.

Detyrimet e pa paguara në Bashkinë Vorë në vlerë progresive deri 31.12.2023, nga auditimi rezultoi në vlerë **376,288,910 lekë**, kundrejt 302,825,456 lekë të raportuara nga Bashkia Vorë.

Mos kontabilizimi i plotë i gjithë debitorëve nga taksat dhe tarifave vendore të biznesit ose familjarë në shumën **46,244,026 lekë**, si dhe mos raportimi për detyrimet e prapambetura që i përkasin periudhës 2004-2020, në shumën **27,219,428 lekë**, në total **73,463,454 lekë**, nuk paraqet situatën reale të debitorëve. Mos regjistrimi i plotë i debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit mbi dokumentimin e proceseve dhe transaksioneve për vijueshmërinë nga lindja deri në arkëtimin e detyrimit.

Për debitorët e mësipërm për kategorinë biznes dhe familjarë, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore; Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nuk ka aplikuar masa shtrënguese në mënyrë shteruese të tilla si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokim i shitjes së aktiveve në QKB, sipas kërkesave të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, Kreun XI.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, i ndryshuar, nenet 88-107; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për Sistemin e Taksave Vendore”*, i ndryshuar, neni 4 pika 2; Ligjin nr. 139/2015 *“Për Vetëqeverisjen Vendore”*, i ndryshuar, neni 9 pika 1.3; ligjin nr. 68/2017 *“Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”*, i ndryshuar, neni 12 pika 3.

**Konstatimi:** Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore; Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë në vlerën **376,288,910 lekë** duke krijuar një detyrim të ri prej **73,463,454 lekë**. Mos kontabilizimi i plotë i gjithë debitorëve për taksat dhe tarifave vendore të biznesit ose familjarë në shumën **46,244,026 lekë**, si dhe mos raportimi për detyrimet e prapambetura që i përkasin periudhës 2004-2020 në shumën **27,219,428 lekë**, në total **73,463,454 lekë**, nuk paraqet situatën reale të debitorëve date 31.12.2023. Mos regjistrimi i plotë i debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit mbi dokumentimin proceseve dhe transaksioneve për vijueshmërinë nga lindja deri në arkëtimin e detyrimit, në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, neni 4 pika 9; neni 6 gërma “c”; neni 11 pika 3 gërma “dh”; neni 16.

Në zbatim të procedurave të arkëtimin të debitorëve, sipas regjistrimit të borxhit tatimor, nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të vendosjes së masave shtrënguese për mbledhjen e borxhit tatimor, në kundërshtim me kreun XI *“Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”*, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar.

Tabelë përmbledhëse e debitorëve deri 31.12.2023

Në lekë

| Përshkrimi                           | Vlera<br>progresive<br>31.12.2022<br>Bashkia | Familjar   | Biznes I<br>vogël | B. Madh    | Vlera<br>progresive<br>31.12.2023<br>KLSH | Vlera<br>progresive<br>31.12.2023<br>Bashki |
|--------------------------------------|----------------------------------------------|------------|-------------------|------------|-------------------------------------------|---------------------------------------------|
| Debitorët biznes i madh              | 199,899,496                                  | 0          | 0                 | 0          | 199,899,496                               | 222,639,000                                 |
| Debitorët biznes i vogël             | 24,922,649                                   | 0          | 0                 | 0          | 24,922,649                                | 29,239,895                                  |
| Debitorët taksa e tokës<br>bujqësore |                                              | 1,077,599  | 0                 | 0          | 1,077,599                                 | 0                                           |
| Debitorë taksa e<br>ndërtesës        |                                              | 11,923,215 | 6,623,381         | 22,983,583 | 41,530,179                                | 0                                           |
| TNI-jeje legalizimi                  |                                              | 2,892,273  | 0                 | 0          | 2,892,273                                 | 0                                           |
| Debitore tarife trualli              |                                              | 0          | 913,392           | 4,107,976  | 5,021,368                                 | 0                                           |
| Tarife pastrimi                      |                                              | 7,397,258  | 2,703,296         | 8,205,152  | 18,305,706                                | 0                                           |
| Tarife ndriçim publik                |                                              | 0          | 637,193           | 627,994    | 1,265,187                                 | 0                                           |
| Autorizim karburanti                 |                                              | 0          | 0                 | 2,300,000  | 2,300,000                                 | 0                                           |
| Debitore nga qiratë                  |                                              |            |                   | 908,464    | 908,464                                   |                                             |

|                                                                  |                    |                   |                   |                   |                    |                    |
|------------------------------------------------------------------|--------------------|-------------------|-------------------|-------------------|--------------------|--------------------|
| Debitorët taksat familje (të ruall, pastrim, ndriçim, gjelbërim) | 50,946,561         | 0                 | 0                 | 0                 | 50,946,561         | 50,946,561         |
| Debitore ndër vite (2004-2020)                                   | 27,219,428         |                   |                   |                   | 27,219,428         | 0                  |
| <b>Total Borxhi</b>                                              | <b>302,988,134</b> | <b>23,290,345</b> | <b>10,877,262</b> | <b>39,133,169</b> | <b>376,288,910</b> | <b>302,825,456</b> |
|                                                                  |                    |                   |                   |                   | <b>Ndryshimi</b>   | <b>73,463,454</b>  |

Burimi: Sektori Biznesit dhe Sektori i Financës; Punoi: KLSH

### ***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

1. z. G. D, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;
2. z. R. M, ish Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore;
3. z. A. L, me detyrë përgjegjëse i Sektorit të Biznesit;
4. znj. K. O, me detyrë përgjegjëse i Sektorit Familjar;
5. znj. M. D, me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Statistikave dhe Menaxhimit të Borxhit;
6. znj. M. M, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, për periudhën 01.01.2023 deri 08.02.2023.

Në lidhje me këtë drejtim të auditimit, nuk janë paraqitur pretendime/observacione nga subjekti i audituar Bashkia Vorë, për Projektraportin e auditimit të dërguar me shkresën nr. 1089/6 prot., datë 16.12.2024.

### **2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

Në zbatim të pikës nr. 3, të Programit të Auditimit nr. 1809/1 prot., datë 11.09.2024, i ndryshuar, për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat Financiare për periudhën ushtrimore raportuese janar - dhjetor 2023;
- Ditarët e kontabilitetit për periudhën raportuese ushtrimore viti 2023;
- Listëpagesat me përzgjedhje të periudhës raportuese ushtrimore e vitit 2023;
- Dokumentet e bankës dhe të arkës për periudhën raportuese ushtrimore të vitit 2023;
- Dokumentet e inventarizimit fizik të AAGJM, etj, për periudhën raportuese ushtrimore viti 2023.

-Aktrakordimet e kryera me Degën e Thesarit Tiranë për periudhën raportuese të vitit 2023. Për të arritur në opinionin, nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, u bazuam në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht në ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Nga auditimi u konstatua se:

#### **Hartimi i pasqyrave financiare të Bashkisë Vorë.**

Për vitin 2023, në përputhje me kërkesat e udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar;
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare;

- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese;
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit;
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike);
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto);
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

### **1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.**

Në procesin e auditimit mbi plotësinë dhe saktësinë e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike të ndodhura për gjatë periudhës raportuese ushtrimore 01.01.2023 deri 31.12.2023 në Bashkinë Vorë u konstatua se, Pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2023, janë të nënshkruara nga z. B. Sh, Kryetar i Bashkisë Vorë në cilësinë e nëpunësit autorizues, si dhe nga znj. A. D, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar e njëkohësisht në cilësinë e nëpunësit zbatues. Pasqyrat financiare ishin depozituar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresë nr. 1628 prot, datë 28.03.2024, duke respektuar afatin ligjor të përcaktuar me ligj.

Nga auditimi mbi verifikimin e marrjes së dokumentacioneve financiare dhe regjistrimet kontabël të kryera nga Bashkia Vorë, rezultoi se Drejtoria e Menaxhimit Financiar regjistrimet e veprimeve kontabël, i kryhen me program Excel dhe jo me “Bartës Informatik”, të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera nuk paraqesin besueshmëri duke bartur risk në vetvete pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë, gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekte. Kjo gjë çon dhe në moskuadrim të drejtë dhe të saktë, si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrigjimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, besueshmërinë e të dhënave, cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e Pasqyrës së Pozicionit Financiar (Formati nr. 1) të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si në vijim:

**Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet - Pasivet = 5,225,469,962 lekë**

|              |                    |
|--------------|--------------------|
| Aktivet      | 5,304,811,735 lekë |
| Pasivet      | 778,322,584 lekë   |
| Aktivet neto | 4,526,489,151 lekë |

### **I. AKTIVET AFATSHKURTRA**

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2023, paraqiten në vlerën **1,082,257,358 lekë** dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 351,174,252 lekë;

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 20,994,111 lekë;

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 346,798,624 lekë;

Llogaritë e Klasës 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 363,290,371 lekë.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”

Në lekë

| Llog. kontabël | Emërtimi i llogarive      | Viti 2023   | Viti 2022   | Diferenca 2022-2023 |
|----------------|---------------------------|-------------|-------------|---------------------|
| 531            | Mjete monetare në arkë    |             |             |                     |
| 512,56         | Mjete monetare në bankë   |             |             |                     |
| 520            | Disponibilitete në thesar | 351,174,252 | 428,758,417 | 77,584,165          |
| 50             | Letra me vlerë            |             |             |                     |
| 532            | Vlera të tjera            |             |             |                     |
| 54             | Akreditiva dhe paradhënie |             |             |                     |

|               |                        |                    |                    |                   |
|---------------|------------------------|--------------------|--------------------|-------------------|
| 59            | Provizione zhvlerësimi |                    |                    |                   |
| <b>Totali</b> |                        | <b>351,174,252</b> | <b>428,758,417</b> | <b>77,584,165</b> |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë, përpunuar nga audituesi.

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet në shumën 351,174,252 lekë dhe kuadron me pasqyrën e flukseve monetare në rubrikën VI “*Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor*”. Në analizë kjo llogari është paraqitur në rubrikën Aneksi PF3, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”

Në lekë

| Llog. kontabël | Emërtimi i llogarive | Viti 2023         | Viti 2022         | Diferenca 2023-2022 |
|----------------|----------------------|-------------------|-------------------|---------------------|
| 31             | Materiale            | 5,942,686         | 2,794,988         | 3,147,698           |
| 32             | Inventar i imët      | 15,051,425        | 20,270,140        | (5,218,715)         |
|                | <b>Totali</b>        | <b>20,994,111</b> | <b>23,065,128</b> | <b>-2,071,017</b>   |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë

Llogaritë e Klasës 3, më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 20,994,111 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 5,942,686 lekë dhe llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 15,051,425 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën -2,071,017 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” në shumën -2,071,017 lekë.

**Llogaria 31 “Materiale”,** ka vlerën 5,942,686 lekë e cila është pasqyruar në bilanc dhe ka inventar fizik të kuadruar me atë kontabël, si dhe lëvizjet e kësaj llogarie paraqiten më poshtë:

| Lëvizjet e llogarisë         | Vlera në lekë    |
|------------------------------|------------------|
| Gjendja në 01.01.2023        | 2,794,988        |
| Hyrje gjatë vitit 2023       | 30,848,143       |
| Dalje gjatë vitit 2023       | 27,700,444       |
| <b>Gjendja në 31.12.2023</b> | <b>5,942,686</b> |

**Llogaria 327 “Inventar i imët”,** ka vlerën 15,051,425 lekë e cila është pasqyruar në bilanc dhe ka inventar fizik të kuadruar me atë kontabël, si dhe lëvizjet e kësaj llogarie paraqiten më poshtë:

| Lëvizjet e llogarisë         | Vlera në lekë     |
|------------------------------|-------------------|
| Gjendja në 01.01.2023        | 20,270,140        |
| Hyrje gjatë vitit 2023       | 3,263,060         |
| Dalje gjatë vitit 2023       | 8,481,776         |
| <b>Gjendja në 31.12.2023</b> | <b>15,051,425</b> |

#### Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme”

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” dhe “Të tjera aktive afatshkurtra”

Në lekë

| Llog. kontabël | Emërtimi i llogarive                                 | Viti 2023 | Viti 2022 | Diferenca 2023-2022 |
|----------------|------------------------------------------------------|-----------|-----------|---------------------|
|                | <b>Llogari të arkëtueshme</b>                        |           |           |                     |
| 411            | Klientë e llogari te ngjashme                        |           |           |                     |
| 423,429        | Personeli, paradhënie, deficite e gjoba              |           |           |                     |
| 431            | Tatime e taksa                                       |           |           |                     |
| 432            | Tatime mbledhur nga shteti për llog. Pushtetit Lokal |           |           |                     |
| 433            | Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti        |           |           |                     |

|         |                                                        |                    |                    |                    |
|---------|--------------------------------------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| 435     | Sigurime Shoqërore                                     |                    |                    |                    |
| 436     | Sigurime Shëndetësore                                  |                    |                    |                    |
| 437,438 | Organizma te tjerë shoqërore                           |                    |                    |                    |
| 44      | Institucione te tjera publike                          |                    |                    |                    |
| 465     | Efekte per t'u arkëtuar nga shitja e letrave me vlere  |                    |                    |                    |
| 468     | Debitorë te ndryshëm                                   | 302,825,456        | 302,988,134        | -162,678           |
| 4342    | Te tjera operacione me shtetin (te drejta)             | 43,973,168         | 42,523,807         | 1,449,361          |
| 45      | Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike |                    |                    |                    |
| 49      | Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)                |                    |                    |                    |
|         | <b>Totali</b>                                          | <b>346,798,624</b> | <b>345,511,941</b> | <b>1,286,683</b>   |
|         | <b>Të tjera aktive afatshkurtra</b>                    |                    |                    |                    |
| 409     | Parapagime                                             |                    |                    |                    |
| 473     | Llogari e pritjes të marrëdhënieve me thesarin         |                    |                    |                    |
| 477     | Diferenca konvertimi aktive                            |                    |                    |                    |
| 481     | Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime          |                    |                    |                    |
| 486     | Shpenzime të periudhave të ardhshme                    | <b>363,290,371</b> | <b>412,867,557</b> | <b>-49,577,186</b> |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë

**Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”,** paraqitet për vitin 2022 në vlerën 302,988,134 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit 2023, paraqitet në vlerën 302,825,456 lekë. Të ndarë sipas kategorive, vlerat e debitorëve paraqiten në pasqyrën më poshtë:

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 31.12.2023

Në lekë

| Nr. | Bashkia Vorë            | Gjendja më 31.12.2022 | Shtesa gjatë vitit 2023 | Pakësime gjatë vitit 2023 | Gjendja më 31.12.2023 |
|-----|-------------------------|-----------------------|-------------------------|---------------------------|-----------------------|
|     | <b>Debitorë</b>         |                       |                         |                           |                       |
| 1   | Debitorë biznes i vogël | 24,922,649            | 6,642,618               | 2,325,372                 | 29,239,895            |
| 2   | Debitorë biznes i madh  | 199,899,496           | 24,449,207              | 1,709,703                 | 222,639,000           |
| 3   | Kategoria familjare     | 50,946,561            | 0                       | 0                         | 50,946,561            |
| 4   | Debitorë ndër vite      | 27,219,428            | 0                       | 0                         | 0                     |
|     | <b>Totali</b>           | <b>302,988,134</b>    | <b>31,091,825</b>       | <b>4,035,075</b>          | <b>302,825,456</b>    |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë, përpunuar nga audituesi.

Pasqyra analitike e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” me vlerë 302,825,456 lekë, deri më datë 31.12.2023, është paraqitur në rubrikën Aneksë PF4, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Debitorë ndër vite në Bashkinë Vorë

| Viti | Emërtimi                     | Nr. i debitorëve | Vlera në lekë     |
|------|------------------------------|------------------|-------------------|
| 2004 | Debitorë në Vorë             | 10               | 1,514,590         |
| 2006 | Debitorë në Vorë             | 3                | 3,612,077         |
| 2009 | Debitorë në Vorë             | 54               | 190,971           |
| 2010 | Debitorë në Vorë             | 4                | 2,006,247         |
| 2013 | Debitorë në Vorë             | 2                | 155,401           |
| 2015 | Debitorë në Vorë             | 3                | 97,344            |
| 2015 | Debitorë ish Komuna Bërxullë | 37               | 18,731,163        |
| 2017 | Debitorë në Vorë             | 6                | 118,980           |
| 2019 | Debitorë në Vorë             | 1                | 669,085           |
| 2020 | Debitorë në Vorë             | 5                | 123,570           |
|      | <b>Totali</b>                | <b>125</b>       | <b>27,219,428</b> |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë

Nga auditimi u konstatua se, detyrimet e mësipërme janë të trashëguara që nga viti 2004, në vlerën totale 27,219,428 lekë. Vlerën më të madhe të debisë me 18,731,163 lekë ose 68.8%, e zë ish Komuna Bërxullë. Me urdhrin nr. 45, datë 31.03.2023, të kryetarit të Bashkisë Vorë është ngarkuar Drejtoria e Taksave dhe Tarifa Vendore dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar, për regjistrimin në kontabilitet të listës së debitorëve për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2022, në vlerën totale 275,768,706 lekë. Në informacionin e përcjellë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifa Vendore për kontabilizimin e vlerave të debisë, u konstatua se për kategorinë familjare gjendja debitore deri më 31.12.2022, është në vlerën 50,946,561 lekë.

Kjo shumë nuk është detajuar me emrat dhe vlerat përkatëse për çdo debitor. Ndërsa në vitin 2023, Drejtoria e Menaxhimit Financiar nuk ka marrë asnjë informacion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifa Vendore mbi gjendjen debitore të kategorisë familjare.

Nga kategoria biznesi i vogël janë trashëguar detyrime deri më 31.12.2022, në vlerën 24,922,649 lekë, janë paguar 2,325,372 lekë gjatë vitit 2023, janë krijuar debi të reja në vlerën 6,642,618 lekë. Sa më sipër, totali i debisë nga biznesi i vogël paraqitet në vlerën 29,239,895 lekë.

Nga kategoria biznesi i madh janë trashëguar detyrime deri më 31.12.2022, në vlerën 199,899,496 lekë, janë paguar 1,709,703 lekë gjatë vitit 2023, janë krijuar debi të reja në vlerën 24,449,207 lekë. Si dhe totali i debisë nga biznesi i madh më 31.12.2023, paraqitet në vlerën 222,639,000 lekë.

Nga auditimi i llogarisë 468, u konstatua se vlera 27,219,428 lekë, detyrime të trashëguara që nga viti 2004, nuk janë mbartur dhe nuk janë pasqyruar në fund të vitit ushtrimor 2023, duke mospasqyruar gjendjen e saktë të saj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën nr. 2, neni 7 “Dokumenti kontabël” dhe pika nr. 1, neni 23 “Përgjegjësitë”, të Ligjit nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Me nenin 9, “Përgjegjësia menaxheriale e nëpunësit autorizues”, neni 12, “Përgjegjësia menaxheriale e nëpunësit zbatues”, i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022. Si dhe me nenet 71-75, “Drejtoria e Taksave dhe Tarifave”, nenet 49-50 “Drejtoria e Menaxhimit Financiar”, të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Vorë.

Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Taksave dhe Tarifa Vendore në Bashkinë Vorë ka marrë masa në fillim të vitit 2024, për: bllokim të llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë; njoftim për vendosje të barrës së sigurisë në DPSHTRR; si dhe vendosje e barrës hipotekore në ASHK, vetëm për subjektet: “O” me NIPT JU, “C P” me NIPT KN, “A D” me NIPT JW, si dhe “D” me NIPT JJ.

Ndërsa për debitorët e tjerë, për periudhën nën auditim, kjo Drejtori nuk ka kryer asnjë analizë për të evidentuar klasifikimin e atyre që kanë shpresë arkëtimi dhe atyre debitorë pa shpresë arkëtimi, duke ndjekur të gjitha hapat dhe shkallët ligjore për arkëtimin e tyre.

**Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”** në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 42,523,807 lekë. Ndërsa në fund të vitit 2023, paraqitet në vlerën 43,973,168 lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2023, që trashëgohen në vitin 2024. Kjo llogari duhet të kuadrojë me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare, por që paraqitet në bilanc me shumën 0 lekë.

| Llogaria 4342 në mënyrë analitike                          |  | Në lekë           |
|------------------------------------------------------------|--|-------------------|
| Emërtimi i llogarive                                       |  | Vlera             |
| Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”    |  | 14,449,780        |
| Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”                     |  | 21,434,991        |
| Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”       |  | 1,291,416         |
| Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”                          |  | 6,055,968         |
| Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”                       |  | 737,264           |
| Llogaria 437 “Organizma të tjera shtetërore”, Suplementari |  | 3,750             |
| <b>Totali</b>                                              |  | <b>43,973,168</b> |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë, përpunuar nga audituesi.

**Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** në fund të vitit 2023, paraqitet në vlerën 363,290,371 lekë, e cila përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera, por të pa likuiduara në vitin ushtrimor. Kjo llogari ka si kundërparti gjendjen e llogarisë 467

“Kreditorë të ndryshëm” e cila përbëhet nga vlera 363,290,371 lekë për detyrime të prapambetura.

| Lëvizjet e llogarisë          | Në lekë            |
|-------------------------------|--------------------|
| Gjendja në 01.01.2023         | 412,867,557        |
| Shtesa gjatë vitit 2023 (D)   | -                  |
| Pakësime gjatë vitit 2023 (K) | 49,577,186         |
| <b>Gjendja në 31.12.2023</b>  | <b>363,290,371</b> |

Likuidimet në investime llogaria 231, si dhe në shpenzime llogaria 602, deri më datë 31.12.2023, paraqiten si më poshtë:

**Pakësimet në llogarinë 486**

| Nr. | Përshkrimi                                                                            | Përfituesi | Në lekë           |
|-----|---------------------------------------------------------------------------------------|------------|-------------------|
| 1   | Lik. Situacioni nr.1 me objekt Ndertimi I Kanalit B/A ndricim ne rrugen Miqesia Domje | S          | 4,123,708         |
| 2   | Lik. Situacioni nr. 1 Sistemim Asfaltim Rruga Mojre Fjore Gjec-Koder Njesia Preze     | G          | 6,000,000         |
| 3   | Lik. Situacion Sistemim Asfaltim Rruga Mojre dhe Fjore Gjec-Koder                     | G          | 6,648,907         |
| 5   | Lik. per stc nr. 2 rikonstruksion I rrugeve mucaj sheraj dhe veseleve fshati mucaj    | B sh.p.k   | 2,916,368         |
| 6   | Lik. stc prf pjesor rikonstruksion I rrugeve mucaj sheraj dhe veseleve                | B sh.p.k   | 12,083,632        |
| 7   | Lik. per situacionin nr. 1 perfundimtare shtese e rruges 1-qershori njs ad berxulle   | L k shpk   | 11,896,956        |
| 8   | Lik. per situacionin nr. 1 perfundimtar per objektin ndertim I rrjetit kuz            | L k shpk   | 2,255,054         |
| 9   | Likuidim vendim gjyqesor                                                              | I K        | 3,085,280         |
| 10  | Likuidim vendim gjyqesor                                                              | F Z        | 567,281           |
|     | <b>TOTALI</b>                                                                         |            | <b>49,577,186</b> |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë, përpunuar nga audituesi.

**Inventarizimi i aktiveve.**

Nga auditimi u konstatua se titullari i Bashkisë Vorë, ka nxjerrë urdhrin nr. 116, datë 07.11.2023, “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve në Bashkinë Vorë, për vitin 2023”, në të cilin janë përcaktuar 4 (katër) grupe pune. 2 (dy) grupe pune me nga 8 (tetë) anëtarë, si dhe 2 (dy) grupe me nga 5 (pesë) anëtarë, për inventarizimin e aktive materiale dhe jomateriale për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023.

Nga auditimi u konstatua se, në inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të Njesisë Administrative Prezë, fletët e inventarit të materialeve, si dhe procesverbalet e vlerësimit të tyre, janë firmosur nga kryetari i komisionit të inventarizimit znj. E. M, e cila është njëkohësisht edhe përgjegjëse e materialeve. Veprim ky në kundërshtim me paragrafin nr. 82, të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë Publike”, i ndryshuar.

Me urdhrin nr. 147, datë 22.12.2023, titullari i institucionit ka urdhëruar “Ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve të Bashkisë Vorë” i përbërë nga 1 (një) kryetari znj. A. D, i cili është edhe Nëpunësi Zbatues dhe 4 (katër) anëtarë z. O. F, z. A. P, znj. L. T, dhe z. L. D. Grupi i punës ka kryer vlerësimin e gjendjes fizike të aktiveve dhe kanë mbajtur procesverbalin e vlerësimit me nr. prot.,7032/1, datë 22.12.2023 të nënshkruar nga kryetari i bashkisë. Nga auditimi u konstatua se, në procesverbalet e mbajtur me zërat e materialeve të vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimi, nuk ishin pasqyruar të dhënat: viti i vënies në punë, koha e përdorimit, vlerën e mbetur, si dhe normën e amortizimit të aktiveve, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 95, kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”, të ndryshuar.

Me përfundimin e procesit të vlerësimit, nga komisioni janë hartuar përmbledhëset e aktiveve të propozuara për nxjerrje nga përdorimi: për llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 79,762,666 lekë, për llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” në vlerën 235,577,903 lekë, për llogarinë 213 “Rrugë, rrjete e vepra ujore” në vlerën 416,071,652 lekë, për llogarinë 218

“Inventar ekonomik” në vlerën 13,211,244 lekë, për llogarinë 327 “Inventar i imët” në vlerën 8,349,056 lekë, në total vlere 21,560,300 lekë.

Komisioni i vlerësimit ka cituar në procesverbal se nxjerrja jashtë përdorimi i aktiveve të llogarive 210, 212 dhe 213 ka ardhur nga prishja dhe shembja sipas planit të detyruar vendor PDV dhe tërmetit të datës 26.11.2019, sipas vendimeve të Këshillit Bashkiak Vorë me nr. 24, datë 21.04.2022 dhe nr. 26, datë 28.04.2020.

Me urdhrin nr. 7129 prot., datë 29.12.2023 titullari i institucionit ka urdhëruar “Ngritjen e komisionit të asgjësimit të aktiveve të Bashkisë Vorë” i përbërë nga 1 (një) kryetari znj. E. E. dhe 6 (gjashtë) anëtarë znj. E. H, z. T. F, z. E. T, znj. A. H, znj. B. S. znj. R Ç.

Nga auditimi i procedurës së asgjësimit të aktiveve të Bashkisë Vorë për vitin 2023, u konstatua se, bashkëngjitur Relacionit të mbajtur nga komisioni i asgjësimit nuk rezultojnë asnjë dokument mbi procedurën e ndjekur dhe gjurmën e auditimit për riciklimin, gruposjen apo djegien e aktiveve jashtë përdorimi, veprim ky në kundërshtim me pikën nr. 109, 118 dhe 121 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”, të ndryshuar.

Aktivet që janë nxjerrë jashtë përdorimi, janë hequr nga regjistri i aktiveve në përdorim. Vlerat e aktiveve të asgjësuar janë pasqyruar në kolonën “Pakësimeve gjatë vitit 2023”, te Pasqyra Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata vlere neto), Format nr. 7/b.

## II. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE (AAJM)

**Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale”** përbëhet nga:

**Llogaria 202 “Studime dhe Kërkime”** në mbyllje të vitit 2022, paraqitet në vlerën 101,503,377 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023, paraqitet në vlerën 86,277,870 lekë. Po kështu dhe sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022, në vlerën 101,503,377 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023, paraqitet në vlerën 86,277,870 lekë.

| Lëvizjet e llogarisë          | Vlera në lekë     |
|-------------------------------|-------------------|
| Gjendja në 01.01.2023         | 101,503,377       |
| Shtesa gjatë vitit 2023 (D)   | -                 |
| Pakësime gjatë vitit 2023 (K) | 15,225,507        |
| <b>Gjendja në 31.12.2023</b>  | <b>86,277,870</b> |

Pasqyra analitike e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” deri më datë 31.12.2023, është paraqitur në rubrikë Aneks PF5, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

## AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (AAM)

**Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022, me vlerë neto 103,355,126 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023, në vlerën 23,592,460 lekë. Me procesin e asgjësimit të aktive për vitin 2023, është asgjësuar/ndryshim destinacioni llog. 210, për vlerën 79,762,666 lekë.

Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”

| Nr            | Emërtimi                                          | Vlera në lekë     |
|---------------|---------------------------------------------------|-------------------|
| 1             | Masterplani dhe Plani Rregullues i Bashkisë Vorë  | 4,999,500         |
| 2             | Qendra Sportive Marikaj                           | 15,003,408        |
| 3             | Shesh Ambiente Sportive Shkolla Marqinet          | 238,100           |
| 4             | Rrethimi i Ish Repartit Ushtarak Marqinet         | 366,450           |
| 5             | Rrethim Dhe Sistemim i Fushes së Sportit Marqinet | 2,985,002         |
| <b>Totali</b> |                                                   | <b>23,592,460</b> |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë.

Nga dëmtimet e shkaktuara në ndërtesa dhe pasuri të paluajtshme të tërmetit të 26 nëntor 2019, është kryer riorganizimi dhe riklasifikim i pasurive të regjistruara, në llogarinë 210. Procesi i riklasifikimit ka përfshirë zbritjen e vlerës kontabël të pasurive të shkatërruara, si dhe transferimin e vlerave në llogari të tjera si "Llogaria e Hyrjeve të Pasurisë" apo "Llogaria e Investimeve në Proces" për ndërtimet e reja të pa finalizuara.

Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Vorë ka marrë certifikatat e pronësisë për 55 pasuri (troje), nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), por nuk janë të regjistruara në kontabilitet. Veprim ky i cili nuk paraqet situatën e saktë financiare dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, Ligjin nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme". Tabela analitike e trojeve të certifikuara është paraqitur në rubrikën Aneksi PF6, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Llogaria 211 "Pyje, Kullota, Plantacione"** paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, në shumën totale prej 49,692,984 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023, në vlerën 49,692,984 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2022 dhe vitit 2023, në të njëjtën vlerë prej 49,692,984 lekë.

Llogaria 211 "Pyje, Kullota, Plantacione"

| Nr            | Emërtimi                  | Vlera në lekë     |
|---------------|---------------------------|-------------------|
| 1             | Pyllëzim Me Fidanë Shege  | 22,137,020        |
| 2             | Pyllëzim Me Arror (Shege) | 8,335,964         |
| 3             | Pyje e Kullota Bërxullë   | 19,220,000        |
| <b>Totali</b> |                           | <b>49,692,984</b> |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë.

**Llogaria 212 "Ndërtesa Konstruksione"** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, 507,675,819 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023, në vlerën 225,751,994 lekë e cila përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor. Kjo llogari kuandron edhe në Formatin nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)". Pasqyra analitike e llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" deri më datë 31.12.2023, është paraqitur në rubrikën Aneksi PF7, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Llogaria 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore"** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, 3,865,253,858 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023, në vlerën 3,301,670,645 lekë e cila përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor. Pasqyra analitike e llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" deri më datë 31.12.2023, është paraqitur në rubrikën Aneksi PF8, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune"** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, për 26,949,687 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023, në vlerën 19,085,131 lekë. E paraqitur në mënyrë analitike si më poshtë:

Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune"

| Nr | Viti | Emërtimi            | Në lekë   |
|----|------|---------------------|-----------|
| 1  | 2006 | Tabela Sinjalistike | 141,823   |
| 2  | 2006 | Stabilizator        | 300,000   |
| 3  | 2006 | Turbina             | 150,000   |
| 4  | 2007 | Bazamente kazanesh  | 1,880,434 |
| 5  | 2007 | Pemë Dekorative     | 400,000   |
| 6  | 2007 | Tabela Sinjalistike | 391,824   |
| 7  | 2008 | Pemë Dekorative     | 396,000   |

|    |      |                                                                         |                   |
|----|------|-------------------------------------------------------------------------|-------------------|
| 8  | 2008 | Gjenerator                                                              | 1,878,000         |
| 9  | 2008 | Vendosje Tabela Kufizuese Shpejtesie                                    | 1,595,004         |
| 10 | 2008 | Pajisje banjo për bashkinë                                              | 152,580           |
| 11 | 2008 | Program Kompjuteri Financa 5                                            | 390,000           |
| 12 | 2008 | Kazanë Mbeturinash                                                      | 6,000,960         |
| 13 | 2016 | Blerje Kabulli Dhe Ndriçues Për Linjat E Ndriçimit Publik               | 822,000           |
| 14 | 2016 | Vendosja E Matësive Të Ujit Në Qytetin E Vorës                          | 446,982           |
| 15 | 2017 | Blerje, furnizim, vendosje mat. elektrike për linjat e ndriçimit publik | 2,473,200         |
| 16 | 2017 | Ndërt. bazamentash kazanash për koshat në Vorë, Prezë, Bërxullë         | 1,995,387         |
| 17 |      | Transferime Prezë e Bërxullë                                            | 19,908,585        |
|    |      | <b>Totali</b>                                                           | <b>39,322,779</b> |
|    |      | <b>*Amortizimi i Akumuluar për këtë llogari është 20,237,648 lekë.</b>  |                   |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë.

Nga auditimi u konstatua se, në gjendjen e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”, janë përfshirë aktivi “Pemë dekorative” me kosto historike 796,000 lekë, si dhe aktivi “Program kompjuteri Financa 5” me kosto historike në vlerën 390,000 lekë, duke bërë klasifikim të gabuar të këtyre aktiveve. Veprime këto në kundërshtim me pikat nr. 2, 10 dhe 21 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” të *Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit*, i përmirësuar, si dhe udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**Llogaria 215 “Mjete transporti”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, në vlerën 25,356,897 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023, në vlerën 18,448,505 lekë.

Llogaria 215 “Mjete transporti”

| Nr. | Emërtimi                                                               | Vlera në lekë     |
|-----|------------------------------------------------------------------------|-------------------|
| 1   | Autoveturë Fuoristradë për Titullarin e bashkisë                       | 7,988,400         |
| 2   | Eskavator                                                              | 9,055,196         |
| 3   | Automjet Zjarrfikës                                                    | 5,580,000         |
| 4   | Automjet Për Nevojat E Bashkisë Vorë                                   | 1,438,560         |
| 5   | Bot Uji                                                                | 2,400,000         |
| 6   | Blerje makine e re ngarkuese me goma (Fadrome per Nevojat e Bashkise)  | 2,486,164         |
| 7   | Fuoristradë X5                                                         | 3,180,000         |
| 8   | Automjet Kama                                                          | 533,600           |
| 9   | Kamion Riportabel Plehrash Reno                                        | 1,880,040         |
|     | <b>Totali</b>                                                          | <b>34,541,960</b> |
| 10  | Eskavator                                                              | 4,680,000         |
|     |                                                                        | <b>39,221,960</b> |
|     | <b>*Amortizimi i Akumuluar për këtë llogari është 16,093,455 lekë.</b> |                   |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë.

Në inventarin e llogarisë 215 “Mjete transporti”, rezultoi gjendje edhe aktivi Eskavator, sasia 1 (një) copë, blerje e Bashkisë Vorë me faturën nr. 29, datë 28.12.2023, vlera 4,680,000 lekë. Ky aktiv është kontabilizuar në bilanc në llogarinë 218, në zbatim të VKM nr. 290, datë 17.05.2023, “Për një ndryshim të VKM nr. 414, datë 08.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

**Llogaria 218 “Inventari ekonomik”** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022, 66,420,577 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023, në vlerën 45,474,414 lekë. Kjo llogari kuandron edhe në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”.

Në analizë të kësaj llogarie, gjatë vitit 2023, janë kryer hyrje (blerje) me pagesë, në vlerën 7,618,227 lekë, si dhe shtesa pa pagesë (dhurim) nga z. S. K, për kopshtin Vorë, në vlerën 455,175 lekë, të paraqitura më poshtë:

Hyrje aktive shtesa pa pagesë (dhurim)

| Nr. | Emërtesa         | Njësia | Sasia     | Vlera në lekë  |
|-----|------------------|--------|-----------|----------------|
| 1   | Dollap           | Copë   | 4         | 398,972        |
| 2   | Tavolina nxënësi | Copë   | 8         | 56,203         |
|     | <b>Totali</b>    |        | <b>12</b> | <b>455,175</b> |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë, përpunuar nga audituesi.

Nga auditimi u konstatua se, nga llogaria 218 “Inventari ekonomik” ishin asgjësuar me procedurën e asgjësimit të aktiveve për vitin 2023, edhe aktivi “Kondicionerë” me vlerë totale 281,000 lekë.

Ky aktiv është klasifikuar në llogarinë e gabuar dhe ka sjellë mospasqyrim të saktë të gjendjes dhe vlerës së plotë të llogarisë 218. Veprime këto në kundërshtim me pikat nr. 2, 10 dhe 21 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” të *Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit*, i përmirësuar, si dhe udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM”.** Në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”, formati nr. 7/B, vlerat e aktiveve në tepricat neto në fillim të vitit nuk përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor. Si pasojë edhe vlera e amortizimit vjetor të aktiveve, është e pasaktë. Amortizimi i vitit 2023 është 249,886,676 lekë.

Amortizimi i aktiveve afatgjata është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36.

- Për aktivet afatgjata, materiale si: ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, është zbatuar norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;

- Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softet e sistemeve informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;

- Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale është zbatuar norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe

- Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi është llogaritur me metodën lineare me normë amortizimi 15%”.

#### **Testi substancial i amortizimit.**

Nga auditimi i pasqyrës statistikore formati 7, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” u konstatua se, amortizimi vjetor është llogaritur e kontabilizuar i ndarë si më poshtë:

Llog. nr. 202 “Amortizim, studime dhe kërkime” = 15,225,507 lekë;

Llog. nr. 212 “Amortizim ndërtime dhe konstruksione” = 13,972,027 lekë;

Llog. nr. 213 “Amortizim Rruge, Ura, Rrjete, Rezervuare” = 190,107,874 lekë;

Llog. nr. 214 “Amortizim Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” = 7,864,556 lekë;

Llog. nr. 215 “Amortizim Mjete transporti” = 6,908,392 lekë;

Llog. nr. 218 “Amortizim Inventar ekonomik” = 15,808,321 lekë.

Për aktivet e llogarive 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe llogaria 218 “Inventar Ekonomik”, llogaritja e amortizimit është bërë aktiv për aktiv sipas formatit të miratuar.

Pasqyra e Gjendjes dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto të tyre, është paraqitur në rubrikën Aneksi PF9, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Llogaria 231 "Investime" për aktivet afatgjata materiale** më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 48,564,301 lekë, ndërsa më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 452,560,372 lekë, e cila përfaqëson vlerën e investimeve në proces të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 “Aktive afat gjata materiale”.

| Nr. | Llogaria 231/Objekti     | Vlera në lekë      |
|-----|--------------------------|--------------------|
| I   | Gjendja ne fillim        | 48,564,301         |
| II  | Blerje me pagesë         | 403,996,071        |
| III | Shtesë pa pagesë         |                    |
| IV  | Lëvizjet brenda sistemit |                    |
|     | <b>Totali</b>            | <b>452,560,372</b> |

## PASIVET (DETYRIMET)

### Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë paraqitur në vlerën 778,322,584 lekë. Këto janë llogari të pagueshme të cilat paraqesin detyrimet e Bashkisë Vorë më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagave të punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, organizma të tjerë shtetërorë (suplementare), kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj. Pasivi i bilancit kontabël 2023, paraqitet në rubrikën Aneksi PF10, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

|                                                                                 |                   |
|---------------------------------------------------------------------------------|-------------------|
| <b>Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në fund të vitit</b> | <b>21,015,346</b> |
| Shtesa (K)                                                                      | -                 |
| Pakësime (D)                                                                    | 6,565,566         |
| <b>Gjendja në 31.12.2023 (K)</b>                                                | <b>14,449,780</b> |

Gjendja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në shumën 14,449,780 lekë përbëhet nga:

Faturat e palikuiduara deri më 31.12.2023

| Viti             | Përshkrimi i faturave                           | Detyrimi në lekë  |
|------------------|-------------------------------------------------|-------------------|
| 2006             | Materiale te ndryshme                           | 384,423           |
| 2007             | Kancelari materiale ndërtimi                    | 99,324            |
| 2008             | Materiale ndertimi, çimento                     | 336,744           |
| 2009             | Karburant, materiale ndërtimi                   | 906,828           |
| 2010             | Materiale dezifektues, vulë                     | 12,330            |
| 2013             | Karburant, materiale ujësjellësi                | 42,360            |
| 2014             | Mat. sherb. publike dhe mat ekipit te futbollit | 7,063             |
| 2015             | Dru zjarri, materiale ujesjellesi               | 457,292           |
| 2017             | Fikese zjarri                                   | 226,800           |
| 2018             | Fadrome/makine                                  | 7,611,836         |
| 2019             | Pajisje kompjuter, vaj filtri                   | 1,409,544         |
| 2020             | Materiale, shtypshkronje                        | 11,520            |
| <b>Totali I</b>  |                                                 | <b>11,506,064</b> |
| 2023             | Kancelari, materiale djegëse                    | 2,943,716         |
| <b>Totali II</b> |                                                 | <b>14,449,780</b> |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë, përpunuar nga audituesi.

Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Menaxhimit Financiar nuk ka likuiduar faturat e viteve 2006-2020, për vlerën 11,506,064 lekë, ndaj disa furnitorëve të cilët nuk i kanë ofruar Bashkisë Vorë, shërbimet dhe produktet në përputhje me kontratat e nënshkruara. Disa nga furnizimet e kryera nuk kanë pasur mbështetje të mjaftueshme dokumentare që të vërtetonin dorëzimin fizik të mallrave, ndërsa disa fatura përmbanin shërbime që nuk janë realizuar.

Përderisa nuk janë kryer furnizimet sipas kontratave të nënshkruara mes palëve, këto fatura nuk duhej të kontabilizoheshin e të njiheshin si detyrime të Bashkisë Vorë. Gjithashtu, pagesat me vonesë në shlyerjen e detyrimeve kontraktore e ekspozojnë njësinë ndaj risqeve gjyqësore. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë Publike”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”. Tabela përmbledhëse e furnitorëve për vitet 2006-2020 dhe të vitit 2023, është pasqyruar në rubrikën Aneksi PF11, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”**, sipas pasqyrave financiare të paraqitura, është në vlerën 21,434,991 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor 2023, për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

|                                 |                   |
|---------------------------------|-------------------|
| <b>Çelja e vitit 2023</b>       | <b>15,773,375</b> |
| Shtesa (K)                      | 232,566,344       |
| Pakësime (D)                    | 226,904,729       |
| <b>Gjendja në 31.12.2023(K)</b> | <b>21,434,991</b> |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë

Tabela e detajuar e urdhër shpenzimeve sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2024, është pasqyruar në rubrikën Aneksi PF12, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Llogaria 431 “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 1,291,416 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit, për muajin dhjetor 2023.

|                                  |                  |
|----------------------------------|------------------|
| <b>Çelja e vitit 2023</b>        | <b>608,291</b>   |
| Shtesa (K)                       | 11,983,028       |
| Pakësime (D)                     | 11,299,903       |
| <b>Gjendja në 31.12.2023 (K)</b> | <b>1,291,416</b> |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë

Sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2024, ka rezultuar:

| Urdhër shpenzimi |            | Vlera në lekë    |
|------------------|------------|------------------|
| Numër            | Datë       |                  |
| 35               | 10.01.2024 | 770,233          |
| 39               | 22.01.2024 | 521,183          |
| <b>Totali</b>    |            | <b>1,291,416</b> |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë

**Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqesin vlerën e pa paguar të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, për pagat e muajit dhjetor 2023, që paguhen në muajin janar 2024.

|                                          |                   |
|------------------------------------------|-------------------|
| <b>Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"</b> |                   |
| Çelje e vitit 2023                       | <b>3,068,0708</b> |
| Shtesa                                   | 69,792,525        |

|                                             |                  |
|---------------------------------------------|------------------|
| Pakësime                                    | 66,801,515       |
| <b>Gjendja në 31.12.2023</b>                | <b>6,059,718</b> |
| <b>Llogaria 436 "Sigurime shëndetësore"</b> |                  |
| Çelje e vitit 2023                          | <b>2,058,087</b> |
| Shtesa                                      | 8,504,487        |
| Pakësime                                    | 9,825,310        |
| <b>Gjendja në 31.12.2023</b>                | <b>737,264</b>   |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë

Konkretisht, sipas dokumentave të bankës të muajit Janar 2024, ka rezultuar:

| Urdhër shpenzimi |            | Vlera në lekë    |
|------------------|------------|------------------|
| Numër            | Datë       |                  |
| 19               | 10.01.2024 | 732,511          |
| 24               | 04.01.2024 | 3,111,939        |
| 25               | 04.01.2024 | 183,944          |
| 26               | 10.01.2024 | 64,170           |
| 27               | 10.01.2024 | 314,791          |
| 28               | 10.01.2024 | 1,028,907        |
| 29               | 10.01.2024 | 98,733           |
| 30               | 10.01.2024 | 322,746          |
| 31               | 10.01.2024 | 11,160           |
| 2                | 10.01.2024 | 22,320           |
| 33               | 10.01.2024 | 11,160           |
| 34               | 10.01.2024 | 894,601          |
| <b>Totali</b>    |            | <b>6,796,982</b> |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë

**Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje”** sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar në fund të vitit 2023, paraqitet në vlerën 68,233,588 lekë e cila përfshin garancitë 5% të ngurtësuar për investime të kryera. Nga auditimi u konstatua se mbi gjendjen e kësaj llogarie, është bërë raportimi në Degën e Thesarit Tiranë.

|                              |                   |
|------------------------------|-------------------|
| <b>Çelja e vitit 2023</b>    | <b>56,077,560</b> |
| Shtesa                       | 23,084,759        |
| Pakësime                     | 10,928,731        |
| <b>Gjendja në 31.12.2023</b> | <b>68,233,588</b> |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë

Në vitin 2023, vlera prej 68,233,588 lekë, është vendosur në disponibilitete në thesar, në masën 5% garanci, për investimet e kryera sipas situacioneve përfundimtare. Pasqyra analitike e llogarisë 466, deri më datë 31.12.2023, është paraqitur në rubrikën Aneksi PF14, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022, në vlerën 412,867,557 lekë, si dhe në mbyllje të vitit 2023, në vlerën 363,290,371 lekë. Ajo përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2023, paraqitet si më poshtë:

|                              |                    |
|------------------------------|--------------------|
| <b>Çelja e vitit 2023</b>    | <b>412,867,557</b> |
| Shtesa                       | -                  |
| Pakësime                     | 49,577,186         |
| <b>Gjendja në 31.12.2023</b> | <b>363,290,371</b> |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë

Nga auditimi u konstatua se, në listën analitike të kreditorëve të Bashkisë Vorë, për vlerën totale prej 363,290,371 lekë, rezultuan subjekte me emër, vlerë dhe datë detyrimi të njëjtë, si

dhe vlera në lekë të cilat nuk kanë destinacion subjekti apo individ i kreditor. Për pasojë vlera e llogarisë 467, nuk paraqitet e saktë në bilancin e vitit 2023, si dhe rrit në mënyrë artificiale detyrimet e prapambetura të Bashkisë Vorë. Veprim ky në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”. Pasqyra analitike deri më datë 31.12.2023, është paraqitur në rubrikën Aneksi PF13, bashkëngjitur Raportit Përfunditar të Auditimit.

**Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”** paraqitet me tepricë kreditore në vlerën 431,043,019 lekë dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që Bashkia Vorë trashëgon për t’u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me aktrakordin e mbajtur me degën e thesarit mbi fondet që trashëgojnë.

## **PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE (F2).**

Auditimi i pasqyrave së të ardhurave dhe shpenzimeve, do të përfshijë verifikimin e të gjitha llogarive në aspektin e pohimeve të auditimit. Nëse totali i të ardhurave është i barabartë me shumën e totalit së të ardhurave nga taksat dhe tatimet, totalit të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, totalit së të ardhurave jo-tatimore, totalit së të ardhurave financiare, totalit të granteve korrente, totali së të ardhurave të tjera, si dhe ndryshimit të gjendjes së inventarit të produkteve. Nëse totali i shpenzimeve është i barabartë me shumën e totalit të shpenzimeve për pagat dhe përfitimet e punonjësve, totalit të shpenzimeve për kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, totalit të shpenzimeve për blerje të mallrave dhe shërbimeve, totalit të shpenzimeve për subvencione, totalit të shpenzimeve për transferime korrente, totalit të shpenzimeve financiare, totalit të shpenzimeve për kuota amortizimi dhe shuma të parashikuara, totalit të shpenzimeve që rrjedhin nga ndryshimi i gjendjes së inventarit, si dhe totalit të shpenzimeve të tjera; nëse pasqyra e performancës financiare përfaqëson tepricën apo deficitin e periudhës (rezultatit e veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur). Pasqyra e Performancës Financiare 2023, paraqitet në rubrikën Aneksi PF15, bashkëngjitur raportit të Auditimit.

### I. Të ardhurat nga taksat e tatimet

| Nr. | Nr. Llog. | Përshkrimi                                      | Viti ushtrimor 2023  | Viti i mëparshëm 2022 |
|-----|-----------|-------------------------------------------------|----------------------|-----------------------|
| 1   | Klasa 7   | <b>TË ARDHURAT</b>                              | <b>1,238,412,556</b> | <b>1,698,273,713</b>  |
| 2   | 70        | <b>I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</b>      | <b>306,534,683</b>   | <b>322,974,845</b>    |
| 3   | 700       | 1. Tatimi mbi të Ardhurat                       | 7,413,417            | 8,785,869             |
| 4   | 702       | 2. Tatimi mbi Pasurinë                          | 135,859,817          | 147,673,319           |
| 5   | 703       | 3. Tatime mbi mallrat e shërbimit brenda vendit | 163,261,449          | 87,646,691            |
| 6   | 708       | 6. Të tjera Tatime e Taksa kombëtare            | -                    | 10,962,715            |

**Llogaria 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2023, në vlerën 306,534,683 lekë.

**Llogaria 700 “Tatim mbi të ardhurat”**, paraqet në bilanc më datë 31.12.2022 vlerën 8,785,869 lekë, ndërsa më datë 31.12.2023, paraqitet me vlerën 7,413,417 lekë, e cila është gjendja e nënlllogarisë 7002 “Tatimi mbi biznesin e vogël”. Kjo vlerë rakordon me degën e thesarit.

**Llogaria 702 “Tatim mbi pasurinë”** e cila përfaqëson taksën mbi ndërtesën dhe truallin, pasqyrohet në bilanc për vitin 2023, në shumën 135,859,817 lekë. Kjo gjendje përbëhet nga llogaria 7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme” në vlerën 130,753,109 lekë, llogaria 7021

“Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme” në vlerën 5,106,709 lekë, si dhe llogaria 7029 “Të tjera tatime mbi pasurinë” në vlerën 0 lekë.

**Llogaria 703 “Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit”** përfaqëson taksën vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie. Ajo paraqitet në mbyllje të vitit 2022, në vlerën 87,646,691 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023, në vlerën 163,261,449 lekë, me një rritje prej 75,614,758 lekë ose 54%. Në këtë llogari janë përfshirë taksat e hotelerive, e reklamës, e ndriçimit, zënie hapësire publike, taksë për therje të bagëtisë.

### III. Të ardhura jo tatimore

| Nr. | Nr. Llog. | Përshkrimi                                           | Viti ushtrimor 2023 | Viti i mëparshëm 2022 |
|-----|-----------|------------------------------------------------------|---------------------|-----------------------|
| 1   | 71        | III. Të ARDHURA JO TATIMORE                          | 73,125,449          | 67,906,251            |
| 2   | 710       | 1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia                      | 1,636,530           | -                     |
| 3   | 711       | 2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare | 67,388,919          | 67,906,251            |
| 4   | 719       | 3. Të tjera të ardhura jo tatimore                   | 4,100,000           | -                     |

**Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”** paraqitet në bilancin e vitit 2023, në vlerën 73,125,449 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin e Degës së Thesarit.

**Llogaria 711 “Shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare”** paraqitet në bilancin e vitit 2023, në vlerën 67,388,919 lekë, e cila përfshin tarifa për leje transporti, tarifa të pastrimit dhe gjelbërimit, gjoba të Inspektoriatit Ndërtimor, gjoba të Policisë bashkiake etj.

**Llogaria 719 “Të tjera të ardhura jo tatimore”** paraqitet në bilancin e vitit 2023, në vlerën 4,100,000 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin e Degës së Thesarit.

### V. Grante korente

| Nr. | Nr. Llog. | Përshkrimi                                      | Viti ushtrimor 2023 | Viti i mëparshëm 2022 |
|-----|-----------|-------------------------------------------------|---------------------|-----------------------|
| 1   | 72        | V. GRANTE KORENTE                               | 858,752,424         | 1,307,392,617         |
| 2   | 720       | 1. Grant korent i brendshëm                     | 858,752,424         | 1,307,392,617         |
| 3   | 7200      | Nga Buxheti per NJQP (Qendrore)                 | 829,448,655         | 1,041,657,782         |
| 4   | 7201      | Nga Buxheti per NJQP (Vendore)                  | 18,932,193          | 223,211,028           |
| 5   | 7204      | Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale | 10,371,576          | -                     |
| 6   | 7206      | Financim i pritshem nga buxheti                 | -                   | 42,523,807            |

**Llogaria 720 “Grant korent i brendshëm”** paraqitet në bilancin e vitit 2023, në vlerën 858,752,424 lekë.

**Llogaria 7200 “Nga buxheti për NJQP (Qendrore)”** paraqitet në bilancin e vitit 2023, në vlerën 829,448,655 lekë, ku pasqyrohen grandet korente dhe jokorente nga qeveria e përgjithshme.

**Llogaria 7201 “Nga buxheti për NJQP (Vendore)”** paraqitet në bilancin e vitit 2023, në vlerën 18,932,193 lekë, e cila përfshin 1% taksën e automjeteve.

**Llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 42,523,807 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit 2023 me 0 lekë. Bashkia Vorë nuk ka trashëguar fonde përmes degës së thesarit, nga Ministria e Financave për llogarinë 7206.

### **Llogaritë e shpenzimeve 600, 601, 602, 604, 606 për vitin 2023.**

Në vitin 2023, shpenzimet paraqiten në vlerën 807,369,537 lekë, në rënie në krahasim me vitin e mëparshëm, për vlerën 518,223,319 lekë.

**Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”** për vitin 2023, paraqitet në bilanc dhe sipas akt-rakordimit me thesarin në vlerën 250,035,110 lekë, ku janë paraqitur shpenzimet për pagat e personelit të përhershëm e të përkohshëm.

**Llogaria 601 “Kontribute të Sigurimeve”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 si dhe sipas akt-rakordimit me thesarin në vlerën 41,219,123 lekë, e ndarë në vlerën 37,023,164 lekë për kontributet e sigurimeve shoqërore, si dhe në vlerën 4,195,959 lekë, për kontributet e sigurimeve shëndetësore.

**Llogaria 602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 dhe sipas akt-rakordimit me thesarin në vlerën 218,473,888 lekë. Nga auditimi konstatohet se nuk janë paraqitur në bilanc vlerat e shpenzimeve të nënllogarive që përfaqëson llogaria 602.

**Llogaria 604 “Transferime korente të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 dhe sipas akt-rakordimit me degën e thesarit në vlerën 30,105,869 lekë.

**Llogaria 606 “Transferime për buxhetet familjare e individët”** në vlerën 265,464,530 lekë, e cila përfaqëson ndihmë paaftësie, ekonomike, grante nga tërmeti, bonus qiraje, bursa shkolle etj.

Gjendja e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” është e barabartë me ndryshimin e gjendjes së inventarit qarkullues, klasa 3, në pasqyrën e pozicionit financiar, ku për vitin 2023 është në vlerën -2,071,017 lekë.

**Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës. Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”.**

Bazuar te gërma “j”, neni 64, i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 19, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Kryetari i Bashkisë Vorë, me urdhrin nr. 36, datë 18.05.2022, ka miratuar strukturën organizative të Bashkisë Vorë dhe Njësi Administrative Prezë dhe Bërxullë për vitin 2022, me numër total të punonjësve 487.

**Paraqitja në formë tabelle e burimit të financimit**

| Periudha  | Plan        | Fakt        | %  | Burimi i financimit |                      |             |                     |                      |
|-----------|-------------|-------------|----|---------------------|----------------------|-------------|---------------------|----------------------|
|           |             |             |    | Trans. e Pakush.    | Fonde te trashëguara | Të ardhura  | Trans. e Kushtëzuar | Transferte specifike |
| Viti 2023 | 354,475,702 | 291,254,233 | 82 | 133,526,384         | 1,078,384            | 140,844,026 | 7,638,500           | 71,387,936           |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Bashkia Vorë

**Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë**

| Nr. | Emërtimi               | Viti 31/12/2023 |             |     |
|-----|------------------------|-----------------|-------------|-----|
|     |                        | Plani           | Fakti       | %   |
| 1   | Fondi i Pagave         | 292,392,072     | 250,035,110 | 86% |
| 2   | Fondi i Sig. Shoqërore | 49,422,196      | 41,219,123  | 83% |
| 3   | Fondi i Veçantë        | 12,661,434      | -           |     |

**Rakordimi të ardhura, shpenzime dhe rezultati**

|     | Emërtimi                    | Pasqyra              | Situacioni           | Diferenca |
|-----|-----------------------------|----------------------|----------------------|-----------|
| I   | <b>Totali të ardhura</b>    | <b>1,238,412,556</b> | <b>1,238,412,556</b> | -         |
| II  | Shpenzime                   | 861,736,328          | 861,736,328          | -         |
| III | Rezultati i vitit ushtrimor | 376,676,228          | 376,676,228          | -         |

**Pasqyra e flukseve monetare Cash Flow (F3)**

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2023.

| Nr Rubrike | PERMBAJTJA                                                | Periudha Raportuse | Periudha Paraardhëse |
|------------|-----------------------------------------------------------|--------------------|----------------------|
| (b)        | (c)                                                       | (1)                | (2)                  |
| I          | Veprimtaritë e shfrytëzimit                               | 397,937,555        | 739,993,671          |
| II         | Veprimtaritë e investimeve                                | -470,400,631       | -352,502,503         |
| III        | Transferta e te tjera                                     | -5,121,089         | -14,810,181          |
| IV         | Teprica ne fillim te vitit ushtrimor                      | 428,758,417        | 51,315,794           |
| <b>V</b>   | <b>Teprica e likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor</b> | <b>351,174,252</b> | <b>497,287,786</b>   |

Teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2023, e paraqitur më lart, rezulton në shumën 351,174,252 lekë dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Mjetet monetare dhe ekujvalentët e tyre" e cila paraqitet në shumën 351,174,252 lekë. Nga auditimi u konstatua se plotësimi i Pasqyrës së flukseve monetare (Cash Flow) nuk është kryer në të gjitha rubrikat e pasqyrës, duke mosparaqitur informacion të detajuar të llogarive, veprim në kundërshtim me udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, kapitulli III, pika 3.6 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetare". Pasqyra e plotë paraqitet në rubrikën Aneksi PF16, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4)**

| Ref.        | E M Ë R T I M I                                               | Fonde bazë dhe Grante | Reze rva | Fonde te tjera te veta | Rez.e mbart ura Tepric e/Deficit | Rez.e ushtrimit Teprice/Deficit | Gjithsej Aktive/neto Fonde/ Neto |
|-------------|---------------------------------------------------------------|-----------------------|----------|------------------------|----------------------------------|---------------------------------|----------------------------------|
| b           | c                                                             | 1                     | 2        | 3                      | 4                                | 5                               | 6                                |
| 101         | <b>I. AKTIVET NETO/FONDET NETO</b>                            | 5,263,913,452         |          |                        |                                  | 1,168,467,320                   | 4,095,446,132                    |
|             | <b>II. NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO (1+2)</b>           | 0                     | 0        | 0                      | 0                                | 431,043,019                     | 431,043,019                      |
|             | <b>1. NGA BURIME TE BRENDSHME</b>                             | 0                     | 0        | 0                      | 0                                | 431,043,019                     | 431,043,019                      |
| 105         | Nga grantet e brendshme kapitale (+)                          |                       |          |                        |                                  |                                 |                                  |
| 1016 , 1059 | Nga transfertat e brendshme të AAGJ, dhurata në natyre, (+/-) |                       |          |                        |                                  |                                 |                                  |
| 85          | Nga Rezultatet e vitit ushtrimor (+, -)                       |                       |          |                        |                                  | 431,043,019                     | 431,043,019                      |
| 115         | Nga Fondet e veta te investimeve (+, -)                       |                       |          |                        |                                  |                                 |                                  |
| 1013        | Nga konsumi i AAGJ (-)                                        |                       |          |                        |                                  |                                 |                                  |
| 1015        | Nga nxjerrjet jashtë përdorimit dhe dëmtimet (-)              |                       |          |                        |                                  |                                 |                                  |
|             | <b>2. NGA BURIME TE JASHTME</b>                               | 0                     | 0        | 0                      | 0                                |                                 |                                  |
|             | <b>TOTALI I FONDEVE TE VETA(I+II)</b>                         | 5,263,913,452         | 0        | 0                      | 0                                | -737,424,301                    | 4,526,489,151                    |

Nga auditimi, rezultoi se vlera totale e aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar", në shumën 4,526,489,151 lekë. Në këtë pasqyrë është paraqitur rezultati i vitit të mëparshëm, si dhe rezultatet e ushtrimit.

Vlera prej 431,043,019 lekë, përfaqëson shtesat e aktiveve neto/fonde neto gjatë vitit ushtrimor. Nga auditimi u konstatua se plotësimi i Pasqyrës së Aktiveve neto/Fonde neto nuk është kryer në të gjitha rubrikat e pasqyrës, duke mosparaqitur informacion të detajuar të llogarive, veprim në kundërshtim me udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, kapitulli

III, pika 3.6 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto”, i ndryshuar. Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivet Neto/Fondet neto paraqitet në rubrikën Aneksi PF17, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Pasqyra statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimet i financimit"**

| Nr. llog.  | Emërtimi                                 | Vlera D             | Vlera K  | Teperica            |
|------------|------------------------------------------|---------------------|----------|---------------------|
| <b>I</b>   | <b>Shpenzimet për Investime</b>          | <b>403,996,071</b>  | <b>0</b> | <b>452,560,372</b>  |
| 230        | Shpenzime afatgjata jomateriale          |                     |          |                     |
| 231        | Shpenzime afatgjate materiale            | <b>403,996,071</b>  | <b>0</b> | <b>452,560,372</b>  |
| <b>II</b>  | <b>Burimet për Investime</b>             |                     |          |                     |
| 1050       | Grante kapitale nga buxheti              |                     |          |                     |
| 1051       | Grante kapitale nga nivele të tjera      |                     |          |                     |
| 1059       | Grante të brendshme kapitale në natyrë   |                     |          |                     |
| <b>11</b>  | <b>Fonde të tjera të veta</b>            |                     |          |                     |
| 115        | Caktim fondi për investime nga rezultati |                     |          |                     |
| <b>III</b> | <b>Balanca</b>                           | <b>-403,996,071</b> | <b>0</b> | <b>-452,560,372</b> |

Vlera prej 452,560,372 lekë përfaqëson shpenzimet për investime të cilat janë të rakorduara me Degën e Thesarit Tiranë. Plotësimi i Pasqyrës së Aktiveve neto/Fonde neto nuk është kryer në të gjitha rubrikat e pasqyrës, veprim në kundërshtim me udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar. Pasqyra e plotë paraqitet në rubrikën Aneksi PF18, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Pasqyra statistikore nr. 8 “Numri i punonjësve dhe Fondi i pagave”.**

Në këtë pasqyrë është dhënë informacion mbi numrin e punonjësve, fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat. Për periudhën objekt auditimi u morën për verifikim 3 listëpagesa të bashkisë e konkretisht, listëpagesat për muajt janar, prill dhe shtator 2023, nga ku rezultoi se, plotësimi i Pasqyrës së Statistikore “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave” është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, kapitulli III, pika 3.8.4 “Rregulla për plotësimin e pasqyrës statistikore mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave”.

Është mbajtur dhe përditësuar libri i pagave dhe ditari i pagave. Nga auditimi i listëpagesave u konstatua se listëpagesat hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto, si dhe kanë të bashkëngjitur listëprezencat e plotësuara e të firmosura nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Përmbledhëset janë të kuadruara me listëpagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga specialisti i pagave, nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues.

U verifikuan përcaktimi i niveleve të pagave dhe pagesat e tyre, ku rezultoi se ato ishin në përputhje me nivelet e përcaktuar për shtesat e pozicionit si dhe shtesat e pagës së grupit përputheshin me nivelin e arsimit sipas përcaktimeve të VKM nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

**2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.**

**Pyetësi dhe shënime shpjeguese (F5).**

Nga auditimi u konstatua se, plotësimi i kësaj pasqyre nuk është bërë në përputhje me kërkesat e pikës nr. 3.7 “Rregullat për dhënien e shpjegimeve për pasqyrat financiare individuale”, të udhëzimit nr. 8, datë 03.09.2018, i ndryshuar, pasi rezultuan të pa analizë pikat 14 dhe 15 të saj.

### **3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.**

#### **Rregullshmëria e veprimeve me bankë:**

Nga kontrolli i kryer mbi dokumentacionin e bankës rezultoi se transaksionet financiare janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues, të konfirmuar nga nëpunësi i thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Çdo muaj është kuadruar ditari dhe gjendja kontabël është e barabartë me gjendjen e ekstraktit të fund muajit të thesarit.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listëpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Nga verifikimi i shumave të urdhër shpenzimeve për periudhën 12 mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e shpenzimeve të aktrakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin.

#### **Rregullshmëria e veprimeve me arkë:**

Nga kontrolli për periudhën objekt auditimi u konstatua se veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore, kategoria familjarë, në njësinë administrative. Derdhjet e të ardhurave të realizuara, janë bërë ditore në bankë, në llogarinë likuiduese të institucionit. Për të ardhurat e arkëtuara janë prerë mandatarkëtimet përkatëse të cilat janë pasqyruar në librin e arkës. Kontabilizimi i të ardhurave është bërë i saktë në llogaritë e klasës 7, sipas llojeve të të ardhurave.

### ***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

1. z. B. Sh, me detyrë Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e nëpunësit autorizues;
2. z. S. B, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar, për periudhën 01.01.2023-22.08.2023;
3. A. D, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe nëpunës zbatues, për periudhën 22.08.2023 e në vijimësi;
4. znj. L. S, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Buxhetit;
5. z. D. K, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit dhe Zbatimit të Buxhetit;
6. znj. E. M, me detyrë Administratore në Njësinë Prezë, në cilësinë e kryetarit të komisionit të inventarizimit të aktiveve;
7. znj. E. E, me detyrë zv. Kryetar i Bashkisë Vorë, në cilësinë e kryetarit të komisionit të asgjësimit të aktiveve;
8. z. R. M, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave, për periudhën 01.01.2023-31.12.2023;
9. znj. K. O, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Familjare.

Në lidhje me këtë drejtim të auditimit, nuk janë paraqitur pretendime/observacione nga subjekti i audituar Bashkia Vorë, për Projektraportin e auditimit të dërguar me shkresën nr. 1089/6 prot., datë 16.12.2024.

## **2.4. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (Aseteve dhe Pyjeve Kullotave) të transferuara sipas VKM.**

Për trajtimin e pikave sa më sipër, nga grupi i auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

- Listat e inventarëve sipas VKM-ve përkatëse;
- Gjendjen e inventarit të pasurive të paluajtshme dhe regjistrimin e tyre në Drejtorinë Vendore të DVASHK-së, Kamzë-Vorë;
- Listat e inventarit të regjistruar/pa regjistruar pranë DVASHK (Kamzë-Vorë).

### ***Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.***

Bashkia Vorë, me urdhrin e Kryetarit të saj, z. B. SH, me nr. 67, datë 18.05.2022, i administruar me nr. 2647 prot., datë 18.05.2022, ka miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve dhe strukturën organizative sipas drejtorive/sectorëve. Struktura e cila merret me administrimin e pasurive (aseteve), është pjesë e Drejtorisë së Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës (këtu e më poshtë DAMMT). Kjo drejtori, ka në varësi referuar rregullores së brendshme të bashkisë 3 sektorë: Sektori i Bujqësisë, Kullimit, Vadtje, Diga, Veterinarisë; Sektorin e Pyjeve dhe Sektorin e Kadastrës, që kanë përgjegjësi për dokumentimin dhe përditësimin e të dhënave për asetet e Bashkisë Vorë. Sektorët sa më sipër, mbikëqyrin procesin e inventarizimit në bazë të urdhrit të titullarit dhe arkivojnë inventarët, sigurojnë dokumentimin dhe ruajtjen e mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit përkatës financiar kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të inventarit kontabël të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese. Gjithashtu, përpilojnë fletët e inventarit të aktiveve të qëndrueshme sipas zyrave në bashki, institucioneve të arsimit, çerdheve, gjendjes civile, ndriçimit rrugor dhe mbajnë kartelat për aktivet e qëndrueshme dhe inventarin e imët.

Bashkia Vorë, ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si: pronat, tokat dhe pasuritë natyrore. Një pjesë të konsiderueshme të pronave dhe tokave, Bashkia Vorë i ka fituar nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, shpronësimeve, si dhe një pjesë të tyre nga shkrirja e ish-komunave, aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Vorë. Me qëllim pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Vorë, duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme, që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia etj...

### ***Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:***

**a)** Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Vorë dhe Njësi Administrative: Vorë, Prezë dhe Bërxullë, paraqitet si më poshtë informacioni mbi gjendjen e pronave në disponim të Bashkisë Vorë.

Gjatë vitit 2023, është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve, të cilat janë transferuar në Bashkinë Vorë dhe Njësitë Administrative, por nuk është kryer dërgimi i tyre në zyrat e ASHK-së, për pajisjen me dokumentacion pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika nr. 1, ku përcaktohet që: “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të

inventarizuara, apo të transferuara në favor të tyre brenda 18-muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

**b)** Sa më sipër, grupi i auditimit kërkoi regjistrin e pronave, tokave dhe pasurive natyrore të cilat janë në pronësi të Bashkisë Vorë. Nga auditimi u konstatua se regjistri kontabël ishte në formatin “Excel”, jo sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar. Konkretisht në të nuk evidentohet data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia. Gjithashtu nuk është përmbushur detyrimi ligjor për krijimin e një regjistri fizik në zbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, pikat 26-30, si dhe pronat e transferuara me VKM-të, nuk janë të evidentuara saktësisht në regjistrat të cilat Bashkia Vorë i mban në programin “Excel”.

**c)** Me VKM-të përkatëse gjatë periudhës 2008-2021, janë transferuar në total **669 pasuri** si: ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat **576 pasuri në pronësi dhe 93 pasuri në përdorim**, si më poshtë:

**- Bashkia Vorë**

Me VKM-në nr. 577, datë 28.05.2009, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vorë, Qarku Tiranë”, (lidhja 1), është miratuar lista e inventarit me 257 pasuri në total, nga të cilat 177 pasuri në pronësi dhe 80 pasuri në përdorim.

Me VKM-në nr. 1108, datë 30.12.2015, “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”, i është miratuar lista e inventarit me 23 prona në total, që i kalojnë në pronësi Bashkisë Vorë. Kjo listë fillon me numër 1 dhe mbaron me nr. 23 dhe përbëhet me 1 fletë.

Me VKM-në nr. 134, datë 03.03.2021, për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në Administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish-Komunave/Bashkive”, të ndryshuar, i është miratuar lista e inventarit me 107 parcela në total, nga të cilat në pronësi 107 prona.

**- Ish-Komuna Bërxullë, sot Njësia Administrative Bërxullë, Bashkia Vorë**

Me VKM-në, nr. 1495, datë 12.11.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Bërxullë, të Qarkut Tiranë”, (lidhja 1), i është miratuar lista e inventarit me 92 prona në total, nga të cilat 84 pasuri në pronësi dhe 8 pasuri në përdorim.

**- Ish-Komuna Prezë, sot Njësia Administrative Prezë, Bashkia Vorë**

Me VKM-në nr. 792, datë 16.11.2011, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Prezë, të Qarkut Tiranë”, (lidhja 1), i është miratuar lista e inventarit me 190 prona në total, transferuar Njesisë Administrative Prezë, prej të cilave 185 pasuri në pronësi dhe 5 pasuri në përdorim.

Bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga subjekti, në tabelën e mëposhtme është pasqyruar numri i pronave sipas VKM-ve dhe listës së inventarit të njësive Administrative dhe të Bashkisë Vorë.

**Pronat e transferuara në Bashkinë Vorë me VKM**

| Nr. |              | VKM   |            | Në pronësi<br>Në numër | Në përdorim<br>Në numër | Nga këto<br>regjistruar |
|-----|--------------|-------|------------|------------------------|-------------------------|-------------------------|
|     |              | Numër | Datë       |                        |                         |                         |
| 1   | Bashkia Vorë | 134   | 03.03.2021 | 107                    | -                       | 12                      |
| 2   |              | 1108  | 30.12.2015 | 23                     | -                       | -                       |
| 3   |              | 577   | 28.05.2009 | 177                    | 80                      | 100                     |

| Nr. |                    | VKM  |            | Në pronësi | Në përdorim | Nga këto   |
|-----|--------------------|------|------------|------------|-------------|------------|
| 4   | <b>NJA Prezë</b>   | 792  | 16.11.2011 | 185        | 5           | 8          |
| 5   | <b>NJA Bërxull</b> | 1495 | 12.11.2008 | 84         | 8           | 1          |
|     | <b>TOTAL</b>       |      |            | <b>576</b> | <b>93</b>   | <b>121</b> |

Burimi: Bashkia Vorë

*Në Njësinë Administrative Bërxullë, për shkak të procesit të rindërtimit, “Shkolla 9- vjeçare dhe kopshti Bërxullë”, është certifikuar sipas VKM-së me 493, datë 30.7.2021, “Për transferimin në pronësi të Bashkisë Vorë, për Njësinë Administrative Bërxullë, të pasurisë 303/1, me vendndodhje në zonën kadastrale 1167”.*

Inventarët e pronave të paluajtshme të miratuara me VKM përgjatë viteve, për Njësitë Administrative, nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Vorë, nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së, Kamëz-Vorë, mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm që kanë pësuar këto pasuri, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit, apo vendimet gjyqësore. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua se, në **pronësi të Bashkisë Vorë janë 576 pasuri në total, nga të cilat 121 pasuri janë të pajisura me certifikatë dhe 455 pasuri nuk janë të pajisura me titull pronësie**. Për sa më sipër, për periudhën në proces auditimi, u konstatua se nuk është marrë asnjë masë apo kryer ndonjë procedurë, që do të ndjekë zbatimin e këtyre VKM-ve, si edhe regjistrimin e pronave në ASHK. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, u konstatua se gjatë vitit 2023, janë regjistruar 0 prona nga DAMMT në Bashkinë Vorë, ndërsa është aplikuar për t’u pajisur me titull pronësie për 26 pasuri, si më poshtë vijon:

- Me shkresën me nr. 6029 prot., datë 01.11.2023, me lëndë: “Kërkesë për regjistrim të pasurisë publike me nr. 259 (Truall), të Njësisë Administrative Prezë, Bashkia Vorë.
- Me shkresën me nr. 6031 prot., datë 01.11.2023, me lëndë: “Kërkesë për regjistrim të pasurisë publike me nr. 157 (Truall) të Njësisë Administrative Prezë, Bashkia Vorë.
- Me shkresën me nr. 6080 prot., datë 01.11.2023, me lëndë: “Kërkesë për regjistrim të pasurisë publike me nr. 231 (Truall) të Njësisë Administrative Prezë, Bashkia Vorë.
- Me shkresën me nr. 6664 prot., datë 01.12.2023, me lëndë: “Kërkesë për regjistrim të pasurisë publike (rrugë vendore), të Njësisë Administrative Prezë, fshati Ahmetaq, Bashkia Vorë (pasuri nr. 369).
- Me shkresën me Nr. 6663 prot., datë 01.12.2023, me lëndë: “Kërkesë për regjistrim të pasurisë publike (rrugë vendore) të Njësisë Administrative Prezë, fshati Ahmetaq, Bashkia Vorë (pasuri nr. 377).
- Me shkresën me nr. 5817 prot., datë 23.10.2023, me lëndë: “Kërkesë për regjistrim të pasurisë publike (truall+ndërtesë) të Njësisë Administrative Prezë, Bashkia Vorë.
- Me shkresën me nr. 5937 prot., datë 27.10.2023, me lëndë: “Dërgohen për regjistrim pasuri publike, fusha e përdorimit (infrastrukturë dhe shërbime publike).
- Me shkresën me nr. 5928 prot., datë 27.10.2023, me lëndë: “Dërgohen për regjistrim pasuri publike, fusha e përdorimit (infrastrukturë dhe shërbime publike-rrugë).
- Me shkresën me nr. 5923 prot., datë 27.10.2023, me lëndë: “Dërgim për regjistrim pasuri publike, fusha e përdorimit (Infrastrukturë dhe shërbime publike-rrugë), ZK 3127.

Për sa trajtuar më sipër, nga Bashkia Vorë, nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjitha pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve, të sipërpërmendura. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV, neni 37, pika nr. 1 dhe 2, gërma “a” dhe “b”, Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”,

nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat nr. 26-30.

Me VKM-në nr. 134, datë 03.03.2021, për disa ndryshime në VKM-në 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave e Bashkive”, sipërfaqet pyjore dhe kullosore në pronësi të Bashkisë Vorë janë:

- Sipërfaqe totale **1790,93 ha**, e ndarë në:

- Pyje: **1397,31 ha**

- Kullota: **329,99 ha**

- Sipërfaqe shkëmbore: **63,63 ha**

Si dhe numër parcela totale **107**, e ndarë në:

- Pyje: **91**

- Kullota: **7**

- Sipërfaqe shkëmbore: **9**

| VKM | Sipërfaqet      | Pyll       | Kullotë   | Shkëmbore | Sip . Totale          |
|-----|-----------------|------------|-----------|-----------|-----------------------|
| 134 | Sipërfaqet      | 1397,31 ha | 329,99 ha | 63,63 ha  | 1790,93 ha            |
| VKM | Nr. Parcelave   | Pyll       | Kullotë   | Shkëmbore | Nr. i Parcelave total |
| 134 | Nr. i Parcelave | 91         | 7         | 9         | 107                   |

Burimi: Bashkia Vorë

### **Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura**

#### **Detyrimet nga qiratë e sipërfaqeve pyjore/tokave bujqësore**

Bashkia Vorë deri në 31.12.2023, nuk ka sipërfaqe bujqësore, pyjore dhe kullosore, të dhëna me qira personave fizikë, juridikë apo individëve. Referuar dokumentacionit shkresor dhe informacionit të vënë në dispozicion nga DAMMT në Bashkinë Vorë, rezultoi se kjo drejtori i ka dërguar çdo vit Këshillit të Qarkut Tiranë, Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, informacionin mbi treguesit kadastral të përditësuar, për ndryshimet në nivel vendor të fondit pyjor e kullosor.

Megjithëse Bashkia Vorë zotëron sipërfaqe të pyjeve prej 1397,31 ha, nuk kanë plane mbarështimi, çka do të thotë se nuk kanë edhe të ardhura nga ekonomia pyjore, duke i konsideruar si një aset të rëndësishëm.

#### **Kontrata për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve**

Për periudhën nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, Bashkia Vorë nuk ka lidhur kontrata të reja për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve. Deri në këtë periudhë kanë qenë aktive 4 kontrata. Nga auditimi konstatohet se, për këto kontrata ka vetëm 1 (një) debitor. Analiza e detajuar mbi subjektet të cilët kanë nënshkruar kontratë qiraje për ndërtesa/objekte me Bashkinë Vorë, si dhe likuidimet e detyrimeve për këto kontrata paraqiten në tabelën më poshtë:

#### **Kontrata qiraje të subjekteve**

| Nr. | Subjekti | Kontrata                    | Data       | Afati në vite | Sipërfaqe në m <sup>2</sup> /ha. | Vlera e kontratës/në vit | Vlera e paguar gjatë vitit 2023 | Debitor vetëm viti 2023 | Debitor/ Progresiv 31.12.2023 |
|-----|----------|-----------------------------|------------|---------------|----------------------------------|--------------------------|---------------------------------|-------------------------|-------------------------------|
| 1   | E M      | Nr. 5482 Rep. Nr. 3563 Kol. | 02/11/2022 | 10 vite       | 29,500 m <sup>2</sup>            | 195,800 L                | 195,800 L                       | 0                       | 0                             |
| 2   | A D      | -                           | 01/06/1994 | 99 vite       | 9,240 m <sup>2</sup>             | 3,049 USD                | 0                               | 3049 USD Qira 105,456   | 7,921,949                     |

|                                                       |         |                                                 |            |         |                       |            |            |                                            |                   |
|-------------------------------------------------------|---------|-------------------------------------------------|------------|---------|-----------------------|------------|------------|--------------------------------------------|-------------------|
|                                                       |         |                                                 |            |         |                       |            |            | Lekë Truall<br>498,108<br>Lekë<br>Ndërtesë | Lekë              |
| 3                                                     | V L sha | Nr. 1 prot., dt.06.01.2023                      | 11/01/2022 | 1 vit   | 200 m <sup>2</sup>    | 232,800 L  | 197,880 L  | 0                                          | 0                 |
| 4                                                     | K A     | Shkresë transferimi<br>nr. 266/1, dt.10.04.2017 | 19/12/1992 | 99 vite | 50,000 m <sup>2</sup> | 13,250 USD | 1,242,850L | 0                                          | 0                 |
| Totali, detyrime nga mospagimi i kontratave të qirave |         |                                                 |            |         |                       |            |            | 603,564<br>Lekë +3049<br>USD               | 7,921,949<br>Lekë |

Burimi: Bashkia Vorë, përpunoi grupi i auditimit.

Për sa më sipër, rezultoi se Bashkia Vorë ka lidhur kontrata qiraje me 4 subjekte, për afate të ndryshme kohore, nga të cilat, 3 subjekte kanë paguar detyrimin kontraktor. Ndërsa 1 subjekt, “A D” sh.p.k nuk ka paguar detyrimin i cili deri më 31.12.2023, është në vlerën progresive prej 7,921,949 lekë (e cila përfshin debinë për vitet 2016-2023, për qiranë vjetore 2,653,361 lekë, qira ndërtesë 4,424,940 lekë dhe qira truall 843,648 lekë). Për vitin 2023, subjekti “A D” sh.p.k, është debitor në shumën totale 603,564 lekë (qira truall dhe ndërtesë), si dhe 3,049 USD qira vjetore, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e pa arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Vorë dhe të shtetit.

Në rubrikën Anekse, sipas drejtimit të Programit nr. 4, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit paraqiten tabelat me emërtimin: **4/1** Lista e pronave të regjistruara sipas objekteve dhe certifikatës së pronësisë, si dhe **4/2** Informacion mbi pronat e aplikuara nga Bashkia Vorë, gjatë vitit 2023.

Në lidhje me këtë drejtim të auditimit, nuk janë paraqitur pretendime/observacione nga subjekti i audituar Bashkia Vorë, për Projektraportin e auditimit të dërguar me shkresën nr. 1089/6 prot., datë 16.12.2024.

## 2.5. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Hartimi i programit (Plan veprimi) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve;

Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor;

Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

### Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Në zbatim të nenit 15, gërma “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Vorë ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresë nr. 135 Prot., date 09.01.2024, duke respektuar kështu afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve.

### Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Bashkia Vorë nuk ka marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, ku përcaktohet që: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

### Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak Vorë, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Nga auditimi u konstatua, mungesë e gjurmës së raportimit në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, siç përcaktohet në nenin 50 - Auditimi i jashtëm, pika 4 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

### Rekomandimet e KLSH-së

Për auditimin e ushtruar në Bashkinë Vorë, sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së me nr. 520/10 prot., datë 18.12.2023, janë rekomanduar **67 rekomandime**, si me poshtë:

1. Masa organizative, **28 rekomandime**;
2. Shpërblim dëmi, **1 rekomandim** në shumën 205 mijë lekë;
3. Masa për uljen e borxhit tatimor, **5 rekomandime** në shumën 358,226 mijë lekë;
4. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, **2 rekomandime**;
5. Masa Disiplinore **29 rekomandime**;
6. Masë njoftim për DAP dhe KMSHC, **1 rekomandim**;
7. Masë për vendosjen e sanksioneve administrative, **1 rekomandim**.

### Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së dërguar nga KLSH me shkresë nr. 520/10 prot date 18.12.2023, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është 100% si më poshtë:

000 lekë

| Masat                                                                                     | Rekomanduar | Pranuar   | Pa Pranuar |
|-------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|-----------|------------|
| Masa organizative                                                                         | 28          | 28        | 0          |
| Shpërblim dëmi ( nr )                                                                     | 1           | 1         | 0          |
| Shpërblim dëmi (mije leke)                                                                | 205         | 205       | 0          |
| Masa për uljen e borxhit tatimor                                                          | 5           | 5         | 0          |
|                                                                                           | 358         | 358       |            |
| Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike | 2           | 2         | 0          |
| Masa Disiplinore                                                                          | 29          | 29        | 0          |
| Masë njoftim për DAP dhe KMSHC                                                            | 1           | 1         | 0          |
| Masë për vendosjen e sanksioneve administrative                                           | 1           | 1         | 0          |
| <b>Totali</b>                                                                             | <b>67</b>   | <b>67</b> | <b>0</b>   |

Burimi: Bashkia Vorë, përpunoi grupi i auditimit

### Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Vorë.

000 lekë

| Masat                                                                                     | Rekomanduar | Te zbatuara | Te zbatuara Pjesërisht | Në proces zbatimi | Te pazbatuara |
|-------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|-------------|------------------------|-------------------|---------------|
| Masa organizative                                                                         | 28          | 7           | -                      | 18                | 3             |
| Shpërblim dëmi ( nr )                                                                     | 1           | -           | -                      | -                 | 1             |
| Shpërblim dëmi (mije leke)                                                                | 205         | -           | -                      | -                 | 205           |
| Masa për uljen e borxhit tatimor                                                          | 5           | -           | -                      | 4                 | 1             |
|                                                                                           | 358         |             |                        | 322               | 36            |
| Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike | 2           | -           | -                      | -                 | 2             |
| Masa Disiplinore                                                                          | 29          | -           | -                      | -                 | 29            |
| Masë njoftim për DAP dhe KMSHC                                                            | 1           | -           | -                      | -                 | 1             |
| Masë për vendosjen e sanksioneve administrative                                           | 1           | -           | -                      | -                 | 1             |
| <b>Totali</b>                                                                             | <b>67</b>   | <b>7</b>    | <b>-</b>               | <b>22</b>         | <b>38</b>     |
| <b>Totali (%)</b>                                                                         | <b>100%</b> | <b>10%</b>  | <b>0%</b>              | <b>33%</b>        | <b>57%</b>    |

Burimi: Bashkia Vorë, përpunoi grupi i auditimit

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, të marrë masa për të plotësuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm sipas strukturës me auditues të kualifikuar, me qëllim përmbushjen e misionit dhe arritjen e objektivave.

Drejtuesi i Njesisë së auditimit të brendshëm, duhet të krijojë dhe të mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të rekomanduara për t'ia përcjellë menaxhimit, nëpërmjet raporteve informuese të dhëna mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***në proces zbatimi***.

**Statusi: Në proces zbatimi**

**4.1. Rekomandimi:** Në Bashkinë Vorë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***në proces zbatimi***.

**Statusi: Proces zbatimi**

**5.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave/Bashkia Vorë të marrin masat për implementimin e programeve kompjuterike si pjesë e rëndësishme infrastrukture, për miradministrimin e informacionit tatimor dhe për të maksimizuar vjeljen e taksave; kjo duke krijuar një regjistër elektronik që të përmbajë gjithë të dhënat e tatimpaguesve, me të gjitha detyrimet të klasifikuara sipas kategorisë së detyrimit, kohës së krijimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit, për një menaxhim në kohë reale të informacionit.

**5.2. Rekomandimi:** Kryetari i bashkisë, GMS dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masa për një planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e planifikimit të të ardhurave dhe jo atij faktik.

**5.3. Rekomandimi:** Kryetari i bashkisë të caktojë një person përgjegjës për të lidhur marrëveshjet me ato institucione të cilat do të jenë në rolin e agjentit tatimor.

**5.4. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Bashkia Vorë të marrë masat për të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Vorë nga taksat që mblidhen nga këta agjentë. Në rast se agjentët tatimor nuk realizojnë saktë mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Vorë të fillojë procedurat për penalizimin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

**5.5. Rekomandimi:** Bashkia Vorë dhe drejtoritë përgjegjëse të marrin masat për të krijuar si praktikë të punës së tyre, procedurën e përlllogaritjes së vlerës së detyrimeve për ato taksa e tarifa, të cilat bazuar në VKB për miratimin e paketës fiskale vjetore, përjashtojnë disa kategori sociale, kjo për të analizuar efektin financiar që ka në buxhetin e bashkisë nga njëra anë, dhe atë social për komunitetin nga ana tjetër.

**5.6. Rekomandimi:** Kryetari i bashkisë, GMS dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të analizojnë situatën e detyrimeve të atij grupi debitorësh familjarë dhe biznesi, objektet e banimit apo të ushtrimit të aktivitetit tregtar të cilëve, janë dëmtuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, me qëllim hartimin e një plani masash për të definuar statusin e debisë për këtë kategori debitorësh.

**Komenti i grupit të auditimit:**

**Për Rekomandimin 5.1,** Në PBA 2023-2025, në parashikimin e investimeve për buxhetin 2023, Bashkia Vorë ka parashikuar informatizimin e programit të kontabilitetit dhe taksave dhe tarifave vendore, blerjen e pajisjeve elektronike për implementimin e tyre, me kod programi 01110, parashikuar me fond investimi 6,536,984 lekë me burim financimi nga të ardhurat e bashkisë. Nga Bashkia Vorë në vitin 2024 është kryer procedura me objekt “Blerje sistem i integruar i menaxhimit të taksave publike për Bashkinë Vorë”. Objekti i procedurës së prokurimit është marrë në dorëzim nga komisioni përkatës. Për momentin sistemi është në fazë kolaudimi. Deri në këtë fazë të auditimit programet janë në fazë implementimi dhe procesi nuk ka përfunduar, arsye për të cilën rekomandimi konsiderohet **në proces zbatimi**.

**Lidhur me Rekomandimin 5.2,** për periudhën 2023 e në vazhdimësi bashkia Vorë ka hartuar program buxhetor afatmesëm PBA 2023-2025, duke përdorur të dhëna të realizimeve të viteve të mëparshme, duke parashikuar të ardhurat në vlerën totale 562,000,000 lekë. Realizimi i të ardhurave është në masën 76 %. Disa taksa edhe pse janë parashikuar nuk janë realizuar, për pasojë mos përputhje midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave (trajtuar me hollësisht në pikën 2.6 të programit të auditimit, arsye për të cilën rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

**Lidhur me Rekomandimin 5.3,** Me Vendimin nr. 16, datë 25.03.2024, Këshilli Bashkiak ka caktuar Ujësjiellës Kanalizime Vorë si agjent tatimor për mbledhjen e të ardhurave për kategorinë familjare, por akt marrëveshja nuk është nënshkruar nga UKV . Në paketën fiskale 2023 nuk janë përcaktuar agjentet tatimore për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në buxhetin e bashkisë të taksës së “taksën mbi ndërtesën, “mbi kalimin e të drejtës së pronësisë”, “tarifa e pastrimit”, “Tarifa e shitjes së tokës bujqësore”, arsye për të cilën rekomandimi konsiderohet pa zbatuar.

**Për Rekomandimin 5.4,** Punonjësit e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Vorë ka rakorduar në mënyrë periodike mujore me agjentët tatimorë në këtë rast me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke përdorur formularin e miratuar nga Ministria e Financave (12 rakordime) për Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin, arsye për të cilën rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

**Për Rekomandimin 5.5,** në VKB 77/2022 për paketën fiskale vjetore për periudhën 2023, janë parashikuar kategoritë që përjashtohen nga tarifatat dhe taksat vendore, por është vlerësuar që ndikimi financiar në buxhet për këto familje, arsye për të cilën rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

**Për Rekomandimin 5.6,** Kryetari i Bashkisë, GMS, dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave kanë analizuar situatën e detyrimeve të grupit të debitorëve të prekur nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Është hartuar një plan masash për përcaktimin e statusit të debisë për këtë kategori debitorësh. Deri më tani janë identifikuar 337 familje të prekura, dhe plani parashikon zbritjen e 618,071 lekëve për taksën e ndërtesës. Për familjet që kanë banesa të dëmtuara në shkallën DS 5, sipas Institutit të Ndërtimit, taksa e ndërtesës do të zbritet deri në rindërtimin dhe bërjen e banueshme të këtyre banesave, për të lehtësuar situatën e tyre., arsye për të cilën rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

**Statusi: Proces zbatimi**

**7.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Vorë të marrë masa që nëpërmjet strukturave të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur, ndërsa Drejtoria e Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme si dhe të në mënyrë të saktë kryejë kontabilizimin e llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **proces zbatimi**.

**Statusi: Proces zbatimi**

**11.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e Titullari të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në komisionet e ngritura për hartimin e fondit limit të vendosen specialistë të fushës të mire trajnuar, si dhe të përdoren eksperiencat më të mira të fushës, me qëllim mire përdorimin e fondeve publike dhe minimizimin e shpenzimeve të cilat nuk janë të domosdoshme.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga informacioni rezulton se Bashkia Vorë nuk mund të zbatojë rekomandimin menjëherë, por në vazhdimësi sqaron se do të marrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimit. Gjithsesi mosveprimi me akt administrativ nga Bashkia Vorë, deri në momentin e mbajtjes së aktit e konsideron rekomandimin të pa zbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**

**Statusi: Pa zbatuar**

**12.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen e OE fitues të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike.

**Komenti i grupit të auditimit:** Masa Organizative, Kryetari i Bashkisë Vorë ka lëshuar Urdhrin nr. 78, datë 22.02.2024, "Për Zbatimin e Masave Organizative Nr. 12 të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit", ku urdhërohet zbatimi i rekomandimit dhe raportimi në lidhje me të. Për zbatimin e këtij urdhri është ngarkuar Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

**Statusi: Në proces zbatimi**

**13.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

**Komenti i grupit të auditimit:** Masa Organizative, Kryetari i Bashkisë Vorë ka lëshuar Kryetari i Bashkisë Vorë ka lëshuar Urdhrin nr. 79, datë 22.02.2024, "Për Zbatimin e Masave Organizative Nr. 13 të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit", ku urdhërohet zbatimi i rekomandimit dhe raportimi në lidhje me të. Për zbatimin e këtij urdhri është ngarkuar Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik. Në ngritjen e komisioneve janë marrë masat për vendosjen e kriteve në përputhje me aktet ligjore, duke përfshirë në këto procedura vendosjen e të paktën të një anëtar komisioni specialist i fushës që lidhet me objektin e prokurimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

**Statusi: Në proces zbatimi**

**14.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa që e gjitha praktika e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke filluar nga urdhër prokurimi dhe deri në lidhjen e kontratës të protokollohet në protokollin e Bashkisë Vorë dhe jo me protokoll apo regjistër të veçantë.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga Bashkia Vorë janë marrë masa që gjithë procedurat e ndjekura nga zyra e prokurimit për vitin 2023 e në vazhdim janë marrë masat nga komisionet përkatëse që të gjithë praktikantët e zhvillimit të procedurës së prokurimit të protokollohen në protokollin e Bashkisë Vorë duke ndjekur të gjitha parashikimet ligjore të legjislacionit në fuqi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

**Statusi: Në proces zbatimi**

**15.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të verifikuar të gjithë elementët e nevojshëm në planvendosjen e paraqitur, përfshirë numrat e kateve të objekteve me të cilat kufizohet ndërtimi i ri dhe të dhënat e sakta të treguesve të zhvillimit, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

**Komenti i grupit të auditimit:** Kryetari i Bashkisë Vorë ka lëshuar Urdhrin nr. 81, datë 22.02.2024, "Për Zbatimin e Masave Organizative Nr. 15 të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit", ku urdhërohet zbatimi i rekomandimit dhe raportimi në lidhje me të. Për zbatimin e këtij urdhri është ngarkuar Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit., e cila nuk ka realizuar plotësisht rekomandimin konform plan veprimit miratuar me Urdhrin nr. 81, datë 22.02.2024 nga kryetari i Bashkisë Vorë. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

**Statusi: Në proces zbatimi**

**16.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi pa verifikuar distancat ndërmjet ndërtimeve dhe të respektohet distanca minimale për aksesin ndërmjet dy ndërtimeve që gjenden përballë njëri-tjetrit.

**Komenti i grupit të auditimit:** Lidhur me rekomandimin nr.16.1. DPKZHT-së ka marrë masa që të gjitha lejet e miratuara të jenë në përputhje me ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, duke respektuar distancat ndërmjet pronave kufitare, distancat nga kufiri i rrugës, nga objektet ekzistuese si dhe duke respektuar lartësitë e objekteve. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

**Statusi: Në proces zbatimi**

**17.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë në përputhje me kriteret ligjore dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

**Komenti i grupit të auditimit:** Lidhur me rekomandimin nr.17.1 rezultoi se Kryetari i Bashkisë Vorë ka lëshuar Urdhrin nr. 83, datë 22.02.2024, "Për Zbatimin e Masave Organizative Nr. 17 të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit", Ecuria e zbatimit të rekomandimit do të ndiqet në vazhdimësi në miratimin e lejeve të ndërtimit, deri në zbatimin e plotë rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

**Statusi: Në proces zbatimi**

**18.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të verifikuar të dhënat e treguesve të zhvillimit të pasqyruara në planvendosje, të cilat duhet jenë në përputhje me projektin e ndërtimit dhe me kondicionet urbane të lejuara sipas njësisë përkatëse.

**Komenti i grupit të auditimit:** *Nga ana e DPKZHT-së janë marrë masa që të gjitha lejet e miratuara të jenë në përputhje me kriteret dhe treguesit e zhvillimit sipas pasaportës së Njërive Strukturore përkatëse të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vorë, të miratuar me Vendim Nr.3, datë 17.05.2019 të KKT-së. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe në proces zbatimi.*

**Statusi:** Në proces zbatimi

**19.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e lejes së ndërtimit, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

**Komenti i grupit të auditimit:** *Kryetari i Bashkisë Vorë ka lëshuar Urdhrin nr. 90, datë 22.02.2024, për "Zbatimin e Masave Organizative lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit," ku urdhërohet zbatimi i rekomandimit Nr.19 dhe raportimi në lidhje me të. Për Zbatimin e Këtij Urdhri është ngarkuar Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Nuk ka raportim për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe në proces zbatimi.*

**Statusi:** Në proces zbatimi

**20.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të marrë miratimet e nevojshme nga institucionet përkatëse gjatë fazës së aplikimit për leje ndërtimi dhe të vijohet me miratimin e lejes së ndërtimit pas konformitetit të tyre.

**Komenti i grupit të auditimit:** *Kryetari i Bashkisë Vorë ka lëshuar Urdhrin nr. 90, datë 22.02.2024, për zbatimin e tij është ngarkuar Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Nuk ka raportim për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe në proces zbatimi.*

**Statusi:** Në proces zbatimi

**21.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të verifikuar dokumentacionin e pronësisë, në përputhje me kriteret e përcaktuara për zhvillimin e zonës përkatëse.

**Komenti i grupit të auditimit:** *Kryetari i Bashkisë Vorë ka lëshuar Urdhrin nr. 88, datë 22.02.2024, për "Zbatimin e Masave Organizative" rekomandimi Nr.21, për zbatimin e tij është ngarkuar Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.*

*Nuk ka raportim për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe në proces zbatimi.*

**Statusi:** Në proces zbatimi

**22.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, të marrë masa për të plotësuar strukturën e IMTV-së me staf të kualifikuar, kryesisht të profilit inxhinierik dhe në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, si dhe Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, të marrin masa për implementimin e një sistemi elektronik për regjistrimin në kohë të akteve të përpiluara nga inspektorët e IMTV-së.

Kryeinspektori dhe inspektorët e IMTV-së të hartojnë e miratojnë te titullari planet mujore e vjetore të aktivitetit të tyre, të mbajnë akte kontrolli për të gjitha inspektimet që kryejnë në ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse dhe jo vetëm, me qëllim zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.

**Komenti i grupit të auditimit:** Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka publikuar listën e vendeve vakante përfshirë këtu edhe 3 vendet vakantë të IMT-së në standat e Informimit pranë Bashkisë Vorë me qëllim plotësimin e strukturave përkatëse, proces i pa përfunduar. Kryeinspektori dhe inspektorët e IMTV-së nuk paraqitën informacion mbi hartimin e planeve mujore e vjetore të aktivitetit të tyre, nuk paraqitën informacion mbi mbajtjen e akte kontrolli për të gjitha inspektimet që kryejnë në ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse dhe jo vetëm, me qëllim zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

**Statusi: Në proces zbatimi**

**23.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, të analizojë situatën e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën **nr. 372/30 prot., datë 26.09.2022**, duke nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe të përshpejtojë zbatimin e masave në proces.

#### **Masa organizative:**

**1.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për përditësimin e rregullores duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicion pune, të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

**2.2. Rekomandimi:** Përgjegjësi i Auditimit Brendshëm të marrë masa për hartimin e Kartës së Auditimit, çeljen e dosjes së përhershme të auditimit si dhe të vendosë dhe të mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuar menaxhimit sipas Manualit AB.

Gjithashtu në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Vorë.

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Vorë të ndjekë hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, si dhe të analizohet brenda afateve, të dokumentojë se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

**6.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë në proces zbatimi, si dhe të raportojë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, mbi nivelin e zbatimit të tyre.

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

**12.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë, të marrë masat e nevojshme, që të krijohet e mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

**13.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr. 230 dhe nr. 231 “Investime në proces” dhe llogarive nr. 213/212/202 sipas rastit, për objekte të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë së aktivitetit afatgjatë dhe në kredi të llogarisë së investimeve në proces.

**16.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kritere sipas llojit të procedurës dhe dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

**17.1. Rekomandimi:** Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit Bashkia Vorë, të marrë masa për shmangien e kritereve të tilla, të cilat nuk mbështeten në kritere ligjore, por krijojnë pengesë për operatorët ekonomikë për të konkurruar në procedurat e prokurimit publik.

**22.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vorë, të marrë masa që gjatë shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit, të respektohen distancat ndërmjet pronave kufitare, pronave nga kufiri i rrugës, si dhe lartësitë e objekteve.

**23.1. Rekomandimi:** Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Vorë, të merren masa që në shqyrtimin e lejeve ndërtimit të saktësohen volumet e pasqyruar në projektin e ndërtimit, me qëllim përcaktimin e saktë të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë dhe respektimin e kritereve sipas pasaportës së njësive strukturore.

#### **Masa për shpërblim dëmi:**

**1.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **591,560 lekë pa tvsh** nga BOE “B” sh.p.k & “A” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 8 prot datë 15.04.2019, me objekt “Ndërtim i rrjetit KUZ, Rruga e Vromit Ahmetaq, NjA Prezë”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**3.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,001,402 lekë pa tvsh** nga OE “B I” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1298/5 prot datë 03.06.2019, me objekt “Rikonstruksion i rrugëve Muçaj, Sheraj dhe Veselëve, Fshati Muçaj”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**4.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **200,675 lekë pa tvsh** nga BOE “S F” sh.p.k & “V E” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1 prot datë 29.05.2019, me objekt “Ndërtimi i kanalit b/a dhe ndriçim në rrugën Miqësia Domje, NjA Bërxullë”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**5.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **252,500 lekë pa tvsh** nga BOE “G” sh.p.k & “E K” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1 prot datë 05.06.2019, me objekt “Sistemim-Asfaltim Rruga Mojre dhe Fioret Gjec Kodër, NjA Prezë”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**6.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **271,405 lekë pa tvsh** nga OE “A” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 377/5 prot datë 05.04.2019, me objekt “Sistemim-Asfaltim Rruga Pashtriku dhe ndërtimi i rrjetit KUZ, Rruga e Liqenit, NjA Bërxullë, Domje”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me **vlerë 164,353,316 lekë**. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Vorë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën 29,250,000 lekë.

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **213,133,571 lekë** nga taksapaguesit privatë dhe familjarë.

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për subjektet që ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizimin përkatës të pajisen menjëherë me autorizim për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën **11,072,761 lekë** ndaj Bashkisë Vorë.

**Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike:**

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Vorë të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, të raportojë periodikisht në MFE si dhe të saktësojë vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga informacioni i dhënë rezulton se Bashkisë Vorë nuk ka analizuar situatën e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 372/30 prot., datë 26.09.2022, nuk ka marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, nuk ka nxjerrë përgjegjësitë për personat përgjegjës lidhur me shkeljen e konstatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

**Statusi: Pa zbatuar**

**B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Vorë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **240,672 lekë** nga kontraktori BOE “B I” sh.p.k & “L K” sh.p.k, për punime të likuiduara por të parealizuara.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga informacioni i dhënë rezulton se Bashkia Vorë nuk ka marrë masa arkëtimin e vlerës 240,672 lekë nga kontraktori BOE “B I” sh.p.k & “L K” sh.p.k, për punime të likuiduara por të parealizuara.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

**Statusi: Pa zbatuar**

**C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFЕКTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e menaxhimit financiar, të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrit të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjeve të detyrimeve të reja, monitorimit të zbatimit të kontratave të investimeve/shërbimeve si dhe për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme, duke zbatuar aktet ligjore /nënligjore në likuidimin e tyre në afat, për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim zvogëlimin e detyrimeve të prapambetura.

**1.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e burimeve njerëzore dhe inovacionit të marrin masa dhe të analizojnë rastet e punonjësve të larguar nga puna, të nxjerrin personat përgjegjës me qëllim mospërsëritjen e tyre në të ardhmen, duke parandaluar kështu efektet negative në buxhetin e bashkisë.

**Komenti grupit të auditimit:** Bashkia Vorë nuk paraqiti informacion për masat e duhura për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për të paguar “*dëmshpërblim page*”, “*shpronësime*”, “*dëmshpërblime*” në vlerë prej 8,298,940 lekë, arsye për të cilën rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar;

Bashkia Vorë nuk paraqiti informacion për çështje gjyqësore në “proces”, të cilat deri në fund të viti 2022 kanë rezultuar 24 çështje, duke riskuar rritjen e vlerës së detyrimit të prapambetur të akumuluar.

Në PBA 2023-2025/Planin vjetor 2023 dhe tabelën e programeve buxhetore të planifikuara për vitin 2023, rezulton se nuk është planifikuar fond për programin 04960 “*planifikim për detyrimet e prapambetura*”.

Bashkia Vorë nuk paraqiti informacion për pagesat e shumës 325,018,779.94 lekë trashëguar për t’u likuiduar në vitin 2023 sipas planit të likuidimeve të miratuar me VKB nr. 21/2022; si detyrimeve të prapambetura ndaj subjekteve, duke respektuar radhën për likuidimin me Metoden FIFO.

Bashkia Vorë nuk paraqiti informacion mbi likuidimin e detyrimeve “*për mallra e shërbime*” ndaj 14 subjekteve me 39 fatura në vlerë totale 81,789,394.80 lekë.

Sa më sipër Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar, nuk ka marrë masa për hartimin e strategjive dhe regjistrit të riskut me vlerësim real të tij për parandalimin e lindjeve të detyrimeve të reja, për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

**Statusi: Pa zbatuar**

## **D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)**

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Bashkia Vorë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit mbi vlerësimet tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore progresive në vlerën totale 275,768,705 lekë (familjarë dhe biznese), duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon:

- T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.
- Të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme/Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshime, neni 181 “*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*”.

- Drejtoria e Taksa e Tarifave Bashkia Vorë, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke i njoftuar nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) dhe ndjekjen e konfirmimit prej familjeve, të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit etj me qëllim vjeljen e detyrimit në rastet e paraqitjes së tyre për shërbime të ndryshme në sportelet e bashkisë;

**1.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksa e Tarifave dhe Drejtorinë Ligjore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtime pa leje në vlerën 42,885,729.1 lekë dhe t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**1.3. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksa e Tarifave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore ndaj 14 subjekteve për arkëtimin e vlerës 3,200,000 lekë krijuar nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre; si dhe ndaj 5 subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e tyre pa u pajisur me autorizimin përkatës.

**1.4. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksa e Tarifave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për të arkëtuar vlerën progresive prej 21,343 \$, që subjekti "V A" nuk ka paguar vlerën e përcaktuar në kontratën e qirasë me Bashkinë Vorë.

**1.5. Rekomandimi:** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojnë në Gjykatë zbardhjen e vendimeve për gjobat e vendosura, duke llogaritur edhe kamatëvonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar, për të arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Vorë vlerën totale 36,350,000 lekë;

#### **Komenti grupit të auditimit.**

Sipas informacionit dhe Dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Vorë, rezulton se Titullari dhe strukturat e bashkisë kanë filluar zbatimin e rekomandimeve, por nuk kane realizuar plotësisht rekomandimin e lënë.

Për sa më sipër për **rekomandimet nr. 1.1;1.2;1.3;1.4** rekomandimet konsiderohen të pranuar nga subjekti dhe **në proces zbatimi.**

**Statusi: Proces Zbatimi**

Për sa më sipër për **rekomandimet nr. 1.5** nga subjekti i audituar nuk u paraqit informacion arsye për të cilën rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe **pa zbatuar.**

**Statusi: Pa Zbatuar**

## **E. NJOFTIM PËR DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIN PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Vorë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecursë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

**Komenti grupit të auditimit;** Bashkia Vorë nuk paraqiti dokumentacion fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore për shkeljet e konstatuara nga KLSH.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**  
**Statusi: Pa zbatuar**

## **G. MASA ADMINISTRATIVE**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12, Kreu III, nenet 15 e 16 të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe UKM nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, pika 1, shkronja (a) të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar me nenin 12 të Ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2014, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, i rekomandojmë Titullarit të Bashkisë Vorë, t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, sipas kontratave respektive, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të nxjerrë vendime për marrjen e masave përkatëse dhe sanksioneve administrative ndaj:

Operatorit Ekonomik “D” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori z. V.T, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara në kontratën me objekt: “Sistemim, asfaltim i rrugëve Kodra e Miut dhe rindërtimi i fshatit Marqinet 2, Bashkia Vorë”, datë 22.02.2022, për punime të deklaruara më tepër, të përfituara padrejtësisht nga kontraktori në vlerën 240,672 lekë me tvsh.

**Komenti grupit të auditimit;** Bashkia Vorë nuk ka vlerësuar shkeljet e konstatuara dhe të nxjerrë vendime për marrjen e masave përkatëse dhe sanksioneve administrative ndaj Operatorit Ekonomik “D” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori z. V. T.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi/et konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**  
**Statusi: Pa zbatuar**

**Konkluzion:** Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar nga KLSH me shkresën nr. 520/10 prot date 18.12.2023, ku janë lënë për zbatim **67** rekomandime nga të cilat zbatuar plotësisht 36 rekomandime ose 53,73%, ne proces zbatimi 22 rekomandime ose 32.84% dhe pa zbatuar 9 rekomandime ose 13.43%. si me poshtë vijon:

1.a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **28 masa organizative**, pranuar plotësisht, nga të cilat, **7 masa** janë zbatuar plotësisht, 18 masa në proces zbatimi dhe **3 masa nuk janë zbatuar**.

2.b) Masa për shpërblim dëmi **1 rekomandim** për kërkimin në rrugë ligjore duke ndjekur procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyimit, arkëtimin e vlerës **204,672 lekë**, pranuar plotësisht, dhe kanë ecurinë **1 rekomandim pa zbatuar**.

3.c) Masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara), janë lënë **5 rekomandime** në shumën **358,226 mijë lekë**, të pranuar plotësisht dhe kanë ecurinë **4 masa** në proces zbatimi, dhe **1 rekomandim pa zbatuar**.

4.d) Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike, janë lënë **2 rekomandime**, të cilat janë pranuar plotësisht, dhe të **2 masat janë pa zbatuar**.

5.e) **29 masa** disiplinore, të pranuar dhe **29** rekomandime të **zbatuar** plotësisht.

f) Njoftimi Departamentin të Administratës Publike dhe Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, **1 masë** rezultoi e pa zbatuar.

g) **1 masë administrative për vendosjen e sanksioneve administrative ndaj Operatorit Ekonomik “D” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori z. V. T., pa zbatuar.**

Nga Bashkia Vorë nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në KLSH duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “c”, neni 30, pika 2.

Në lidhje me këtë drejtim të auditimit, nuk janë paraqitur pretendime/observacione nga subjekti i audituar Bashkia Vorë, për Projektraportin e auditimit të dërguar me shkresën nr. 1089/6 prot., datë 16.12.2024.

## IV. REKOMANDIME

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të Bashkisë Vorë, u konstatua se planifikimi fillestar i buxhetit për zërin shpenzime nga vlera 1,748,708 mijë lekë të planifikuara, është realizuar në vlerën 1,275,699 mijë lekë ose 73%, për shkak të mos analizimit të shkaqeve që kanë shkaktuar të njëjtat situata në vitet e mëparshme, kryesisht për mosrealizim të të ardhurave.

Të ardhurat e veta për vitin 2023, nga 565,300 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 408,964 mijë lekë ose 73%, nga të cilat 390,141 mijë lekë të ardhura tatimore dhe 18,823 mijë lekë të ardhura jo tatimore.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 32, “Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore”, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; pikat 6, 97, 101 dhe 103 të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; nenet 34, 36 dhe 38, të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar; si dhe pikën 8, Kreu 1, në UMFE nr. 8, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të theksuara midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të marrin masa për saktësimin e hartimit të tij, mbështetur në realizimet e mëparshme dhe mundësitë objektive të të ardhurave dhe shpenzimeve, për të vijuar me analiza periodike të veprimtarisë për realizimin e buxheteve, për të siguruar buxhete reale në shërbim të qytetarëve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare, në llogaritë e detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata të Bashkisë Vorë ndaj palëve të treta, u konstatua se stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022, është paraqitur në pasqyrat financiare për vlerën 412,868 mijë lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura raportuar në MFE në dhjetor të vitit 2023, është për vlerën 363,290 mijë lekë, e cila rakordon me vlerën e paraqitur në pasqyrat financiare.

Situata financiare e Bashkisë Vorë, sipas të dhënave të shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 dhe gjendjes së faturave të pa likuiduara në fund të periudhës ushtrimore paraqitet në nivelin 34.67% të shpenzimeve vjetore të miratuara, të dhënat të cilat tregojnë se kjo bashki është në gjendjen e vështirësisë financiare.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 50-51 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 , i ndryshuar; neni 3, pika 2; pika 101 dhe 102 të UMFE nr. 2, datë 06.02.2012, i ndryshuar; neni 47 të Ligjit nr. 68/2017 i ndryshuar; nenet 79, 80, 81 dhe pikat 8 dhe 184 të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, si dhe pikën 15 në UMFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, si dhe UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Këshilli i Bashkisë Vorë, të marrë në analizë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar në vështirësitë e gjendjes financiare.

**2.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit, të marrin masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë stokun e detyrimeve të papaguara gjatë viteve paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e njësisë vendore gjatë viteve në vazhdim.

### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**3. Gjetje nga auditimi:** Niveli i planifikimit buxhetor të të ardhurave për vitin 2023, në total u planifikua në vlerën 565,300 mijë lekë, me parashikim në ulje për rreth 68,403 mijë lekë ose 10.79% më pak, krahasuar me planin 2022. Të ardhurat nga administrimi i taksave dhe tarifave vendore u realizuan në shumën 408,964 mijë lekë ose në masën 72.34%, ose 156,336 mijë lekë më pak se parashikimi buxhetor.

Në analizën e realizimit të taksave dhe tatimeve u konstatua se:

- Të ardhurat nga taksa dhe tarifa vendore u planifikuan 268,825 mijë lekë dhe u realizuan 325,467 mijë lekë ose në masën 121.07%. Në këtë grupim me mosrealizim rezultuan: taksa mbi pasurinë (ndërtesë) në masën 81.81%, taksa e tokës bujqësore 80.73%; taksa e truallit u realizua 87.30% etj.

- Nga tarifat lokale u planifikuan 199,533 mijë lekë të ardhura dhe u realizuan 64,674 mijë lekë, ose në masën 32.41%. Në këtë grupim me mosrealizim rezultuan: Tarifë për shërbime publike (pastrimi + ndotje ambienti) 97.20%; tarifë ndriçimi publik në masën 95.38%; tarifë për leje transporti 50.42% dhe tarifa administrative në masën 43.48%.

- Të ardhurat nga “Të tjera” u planifikuan 96,941 mijë lekë dhe u realizuan 18,823 mijë lekë, ose realizuar 19.42%. Në këtë grupim rezultuan me mosrealizim: Të ardhura nga qiraja realizuar në masën 72.57%; arkëtime nga detyrimet e prapambetura realizuar 1,163 mijë lekë ose 11.63%; arkëtime nga gjoba të inspektoratit të ndërtimit 1,163 mijë lekë ose në masën 11.63%; arkëtime nga gjoba të inspektoratit ndërtimor dhe policisë bashkiake realizuar 758 mijë lekë ose 3.70%.

Mos realizmi i të ardhurave në masën 156,336 mijë lekë prek kufirin minimal për të ardhurat e miratuara me Vendim të Këshillit për buxhetin vjetor 2023, veprime këto që bien ndesh me Ligjin nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 42, pika 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandim:** Grupi i Menaxhimit Strategjik, të marrë masa për hartimin e metodologjisë për parashikimin e të ardhurave vendore bazuar në faktorët përkatës, duke

identifikuar dhe vlerësuar kontrollin e risqeve që cenojnë arritjen e objektivave për realizimin e të ardhurave të planifikuara.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave të regjistruara për “taksën e ndërtesës” në bashki dhe njësitë administrative, të ardhurat u planifikuan 139,250 mijë lekë dhe u realizuan 113,924 mijë lekë ose realizuar 81.81%.

Nga të dhënat e regjistrimeve për taksën e ndërtesës rezultoi se duhet t’i nënshtrohen taksës pavarësisht nivelit të shfrytëzimit të tyre 783 subjekte të biznesit të madh, 1059 subjekte të biznesit të vogël dhe 4798 kategoria familjarë.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka vlerësuar taksën e ndërtesës për 402 subjekte biznesi të madh në shumën 22,984 mijë lekë, 461 subjekteve biznesi të vogël në shumën 6,623 mijë lekë, 488 subjekteve familjare 11,923 mijë lekë, duke mos llogaritur në total 41,530 mijë lekë vlerën e taksës mbi ndërtesën ose përjashtim prej tyre sipas kriterëve të Ligjit nr. 9632/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 22, pika 6.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për taksapagues “Biznes” dhe “Familjarë” nuk ka përditësuar të dhënat e regjistrimit të saj me të dhënat e regjistrimit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra) për mbledhjen dhe menaxhimin e informacionit të përditësuar mbi ndërtesat objekt taksimi, sipas kërkesave të Ligjit nr. 9632/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 22/5 pika 1, gërma “b”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Kryetari i bashkisë, GMS dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të vlerësojnë, analizojnë dhe nxjerrin përgjegjësitë për taksën mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj, për mos përditësimin e të dhënave të regjistrimit të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme me të dhënat e regjistrimit elektronik të pasurisë (Kadastra Fiskale) për të definuar individët, personat fizikë ose juridikë që i nënshtrohen taksimit/përjashtimit për këtë kategori taksapaguesish.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, në gjendjen e Llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”, është përfshirë aktivi “Pemë dekorative” me kosto historike 796,000 lekë, i cili duhej të klasifikohej në Llogarinë 211 “Pyjet, Kullota, Plantacionet”. Gjithashtu, në Llogarinë 214, është përfshirë aktivi “Program kompjuteri Financa 5” me kosto historike në vlerën 390,000 lekë, i cili duhej të klasifikohej në Llogarinë 218 “Inventar ekonomik”.

-Në Llogarinë 218 “Inventar ekonomik” është përfshirë aktivi “Kondicioner”, i cili duhej të klasifikohej në Llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”. Në procedurën e asgjësimit të aktiveve, kryer nga grupi i punës së Bashkisë Vorë, u konstatua se janë asgjësuar kondicionerë me vlerë totale 281,000 lekë.

Veprimet e mësipërme kanë sjellë klasifikim të aktiveve në llogaritë e gabuara, si dhe mos pasqyrim të saktë të gjendjes dhe vlerës së plotë të tyre në llogari. Veprime këto, në kundërshtim me pikat nr. 2, 10 dhe 21 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” të *Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit*, i përmirësuar dhe me kapitullin III, të Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 64-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Vorë, të marrë masa për klasifikimin e saktë të aktiveve, sistemit e vlerave me kosto historike së bashku me vlerën e amortizimit të përlogaritur, në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

#### ***Me mbylljen e PF të vitit 2024***

**6. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në fund të vitit 2023, paraqitet në vlerën 14,449,780 lekë. Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Menaxhimit Financiar nuk ka likuiduar 67 fatura në total, të viteve 2006-2020, për vlerën 11,506,064 lekë, ndaj disa furnitorëve të cilët nuk i kanë ofruar Bashkisë Vorë, shërbimet dhe produktet në përputhje me kontratat e nënshkruara. Disa nga furnizimet e kryera nuk kanë pasur mbështetje të mjaftueshme dokumentare që të vërtetonin dorëzimin fizik të mallrave. Për sa më sipër, këto fatura nuk duhej të kontabilizoheshin në sistem, e të njiheshin si detyrime të Bashkisë Vorë, për aq sa nuk janë kryer furnizimet sipas kontratave të nënshkruara mes palëve. Gjithashtu, kryerja e pagesave me vonesë nga Bashkia Vorë, në shlyerjen e detyrimeve kontraktore e ekspozojnë njësinë ndaj risqeve gjyqësore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 64-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Këshilli Bashkiak Vorë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për shërbimet kontraktore ndërmjet institucionit dhe furnitorëve.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**6.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë të marrë masa që për çdo shërbim kontraktual i cili kryhet për nevoja të institucionit, personat përgjegjës të ndjekin të gjithë procedurat ligjore të marrjes në dorëzim të mallit me lënien e gjurmës së auditimit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**6.3. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar të kryejë sistemimin e Llogarisë nr. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, për vlerën 11,506,064 lekë duke i kontabilizuar në Llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, si detyrime të prapambetura.

***Brenda vitit 2025***

**7. Gjetje nga auditimi:** -Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se, Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, paraqitet për vitin 2022 në vlerën 302,988,134 lekë. Në këtë vlerë janë përfshirë detyrime të 125 debitorëve në vlerën 27,219,428 lekë, të trashëguara që nga viti 2004. Vlerën më të madhe të debisë me 18,731,163 lekë ose 68.8%, e zë ish Komuna Bërxullë. Nga auditimi rezultoi se vlera 27,219,428 lekë, nuk është mbartur në vitin ushtrimor 2023, veprim i cili ka sjellë mospasqyrim të saktë të gjendjes së kësaj llogarie.

-Gjendja e Llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2023, për kategorinë biznesi i madh paraqitet: në vlerën 222,639,000 lekë për 166 biznese debitorë; kategoria biznesi i vogël paraqitet: në vlerën 29,239,895 lekë për 390 biznese debitorë; si dhe kategoria familjare paraqitet në vlerën 50,946,561 lekë.

Në informacionin e përcjellë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifa Vendore në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, për kontabilizimin e vlerave të debisë më 31.12.2022, u konstatua se për vlerën 50,946,561 lekë, nuk janë dhënë detajime të emrave dhe vlerave përkatëse për çdo debitor. Ndërsa në vitin 2023, Drejtoria e Menaxhimit Financiar nuk ka marrë asnjë informacion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifa Vendore mbi gjendjen debitorë të kategorisë familjare, për lëvizjet e kësaj llogarie gjatë vitit, në shtesa apo pakësime.

- Drejtoria e Taksave dhe Tarifa Vendore ka marrë masa shtrëngimi, vetëm për 4 subjekte debitorë të kategorisë biznesi i madh, ndërsa për subjekte të tjera debitorë nuk ka kryer asnjë analizë për të evidentuar klasifikimin e atyre që kanë shpresë arkëtimi dhe debitorëve pa shpresë arkëtimi. Veprimet e mësipërme kanë sjellë mospasqyrim të saktë të gjendjes së Llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më 31.12.2023, si dhe janë në kundërshtim me pikën nr. 2, neni 7 “Dokumenti kontabël”, pika nr. 1, neni 23 “Përgjegjësitë”, të Ligjit nr. 25, datë

10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; me nenin 9, “Përgjegjësia menaxheriale e nëpunësit autorizues”, neni 12, “Përgjegjësia menaxheriale e nëpunësit zbatues”, i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar; me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, si dhe me nenet 71-75, “Drejtoria e Taksave dhe Tarifave”, nenet 49-50 “Drejtoria e Menaxhimit Financiar”, të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Vorë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 64-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse mbi menaxhimin e debitorëve të bashkisë.

**Menjëherë**

**7.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vorë, të evidentojë listat emërore të debitorëve kategoria familjare në mënyrë elektronike, si dhe në zbatim të kuadrit ligjor, të përcjellë dokumentacionin e nevojshëm në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, për kontabilizimin e detyrimeve në pasqyrat financiare.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2025**

**7.3. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar të marrë masa të menjëhershme në sistemin e Llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke kontabilizuar të gjithë vlerat debitore të trashëguara në vite.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2025**

**8. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk kryen rakordimet me DRSHTRR-në për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, në kundërshtim me nenin 4, të Ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për sistemin e taksave kombëtare”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008 “Për sistemin e taksave kombëtare”, i ndryshuar, neni 23.1.

- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, nuk ka të rakorduar me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë për arkëtimet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Në mungesë të një data baze të saktë për numrin e subjekteve aktive, të regjistruar rishtazi, apo të mbyllur gjatë vitit ushtrimor, në mungesë edhe të një Sistemi IT, nuk disponon një bazë të dhënash të xhiros së subjekteve.

- DTTV nuk ka vlerësuar si burim të ardhurash për buxhetin e saj tatim fitimin e thjeshtuar mbi biznesin e vogël, për rrjedhojë nuk e ka parashikuar si të ardhur për vitin buxhetor 2023, megjithëse ka arkëtuar prej saj 1,056 mijë lekë, transferuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Drejtorive rajonale tatimore, e cila nuk është në përputhje me Ligjin nr. 9632/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 15, pika 5.

- Vjelja e Taksës mbi kalimin e së drejtës së kalimit të pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mbliidhet dhe kalohet në buxhetin e bashkisë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamëz - Vorë. Për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, nuk janë kryer rakordimet me ASHK Vendore Tiranë, duke marrë të mirëqena arkëtimet nga Dega e Thesarit Tiranë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9632/2006, i ndryshuar, neni 28, pika 4.

- Dispozitat e Ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 2 germa “ç”; neni 5; Ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” neni 5 përcakton se agjentet e taksave caktohen me ligj, ndërsa agjentët e tarifave përcaktohen nga titullarët e vetë institucioneve përkatëse. Rregullat e ligjit të procedurës tatimore janë bazë për funksionimin e agjentëve tatimore, ndërsa rregullorja e brendshme e bashkisë përcakton mënyrat dhe procedurat specifike për zbatimin e këtyre rregullave në nivel lokal.

Në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, të miratuar me Urdhrin e Kryetarit nr. 214 prot., datë 01.12.2022, nuk është përcaktuar punonjësi të cilit i ngarkohet detyrë për ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt rakordimeve me agjentët tatimorë, duke krijuar një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Vorë të marrë masat për të kryer rakordim periodik mujor / 3- mujor me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Vorë nga taksat që mbledhen nga këta agjentë. Në rast se agjentët tatimor nuk realizojnë saktë mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Vorë të fillojë procedurat për penalizmin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

**8.2. Rekomandimi:** Grupi i menaxhimit Strategjik të marrë masat e duhura për ndryshimin e Rregullores së Brendshme të institucionit, të miratuar me Urdhrin e Kryetarit nr. 214 dhe me nr. 6910 prot., datë 01.12.2022, për përcaktimin e pozicionit të punës së punonjësit të cilit i ngarkohet detyrë ndjekja e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt rakordimeve me ta, duke krijuar një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**9. Gjetje nga auditimi:** Sipas të dhënave nga Drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Tokës, sipërfaqja e tokës së ndarë rezulton 2,814 Ha, ndërsa sipas të dhënave të DTTV/Sektori Familjar, numri i familjeve të trajtuara me tokë bujqësore rezulton 1,364 familje, me sipërfaqe toke të ndarë 4,851 Ha, të cilët duhet të arkëtojnë taksën mbi tokën bujqësore sipas klasifikimi të kategorive të tokës bujqësore, bërë nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Sipas të dhënave mbi sipërfaqen e tokës bujqësore u konstatua se të dhënat e regjistruara nga Drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Tokës dhe DTTV/Sektori Familjar, kanë mospërputhje në sipërfaqen e tokës bujqësore, pasi ato nuk kanë rakorduar dhe nuk kanë përditësuar regjistrat e tokës për një periudhë të gjatë kohore me ndryshimet në të dhënat e sipërfaqeve dhe kategorinë e tokave, duke ndikuar në saktësinë e bazës së taksueshme dhe numrin e familjeve, objekt taksën e tokës bujqësore, Ligjin nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23.

Në regjistrat e subjekteve për taksën e tokës bujqësore nuk janë regjistruar sipërfaqe së tokës për të cilën është regjistruar dhe paguar taksa, ka mos llogaritje detyrimi për emigrant, dëmtuar nga tërmeti etj., në kundërshtim me Ligjin nr. 9632/2006, neni 23, pika 2, dispozitë ligjore që përcakton përjashtimin nga taksa e tokës bujqësore, në rast se mbillet me kultura dru frutore dhe vreshtari, për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1. Rekomandimi:** GMS dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të analizojnë situatën e të dhënave për administrimin e taksës mbi tokën bujqësore, për të definuar individët, personat fizikë ose juridikë që nënshtrohen taksimit/përjashtimit për këtë kategori taksapaguesish.

**9.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Tokës dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore/Sektori Familjar, të përditësojnë regjistrat e tokës bujqësore, me ndryshimet e të dhënave të sipërfaqeve dhe kategorinë e tokave, për të saktësuar bazën e taksueshme dhe numrin e familjeve objekt i saj.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**10. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” e cila përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa

financuara paraqitet në bilanc në mbyllje të vitit 2023, në vlerën 363,290,371 lekë. Nga auditimi u konstatua se, në listën analitike të kreditorëve të Bashkisë Vorë, për vlerën totale prej 363,290,371 lekë, rezulton 1 subjekt me emër, datë dhe vlerë detyrimi të njëjtë, në total 888,000 lekë. Gjithashtu, rezulton vlera 60,000 lekë i cila nuk ka destinacion subjekti apo individ kreditor. Për pasojë vlera e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, nuk paraqitet e saktë në bilancin e vitit 2023, si dhe rrit në mënyrë artificiale detyrimet e prapambetura të Bashkisë Vorë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 64-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse mbi menaxhimin e detyrimeve të prapambetura, ndaj kreditorëve.

**10.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar të marrë masa në saktësimin e kreditorëve dhe vlerave kreditore pa adresë, ndaj Bashkisë Vorë. Të kryejë kontabilizimin e duhur të Llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm, si dhe të vazhdojë me likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

***Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2025***

**11. Gjetje nga auditimi:** Gjatë periudhës 2008-2021, nëpërmjet VKM janë transferuar 669 pasuri në total. Nga pasuritë e transferuara, 121 janë të pajisura me certifikatë pronësie, 93 pasuri janë të pajisura me certifikatë përdorimi dhe 455 pasuri nuk janë pajisura me certifikatë pronësie.

Nga auditimi u konstatua se inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuara, nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të tyre, për shkak se nga ana e Drejtorisë së Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës nuk është rakorduar me Zyrën Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me nenin 37, të Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me nenin 122-125 “Detyrat dhe Përgjegjësitë” e Drejtorisë së Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Vorë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 83-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Vorë të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse në lidhje me pajisjen me certifikatë pronësie të pasurive të transferuara me VKM.

Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Bashkinë Vorë, të marrë masa të menjëhershme dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK të pasurive pa certifikatë pronësie dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, të përllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare, Llogaria nr. 210 “Toka, troje, terrene” paraqitet në mbyllje të vitit 2022, me vlerë neto 103,355,126 lekë, si dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 23,592,460 lekë. Me procesin e asgjësimit të aktive për vitin 2023, është pakësuar llogaria 210, për vlerën 79,762,666 lekë. Nga dëmtimet e shkaktuara në ndërtesa dhe pasuri të paluajtshme të tërmetit të 26 nëntor 2019, është kryer riorganizimi dhe riklasifikimi i pasurive të regjistruara, në këtë llogari. Procesi i riklasifikimit ka përfshirë zbritjen e vlerës kontabël të pasurive të shkatërruara, si dhe transferimin e vlerave në llogari

të tjera si "Llogaria e Hyrjeve të Pasurisë" apo "Llogaria e Investimeve në Proces" për ndërtimet e reja të pa finalizuara.

Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës nuk ka dorëzuar në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, praktikën e plota për 55 pasuri (lloji troje), nga 121 në total të certifikuara pas përfundimit të procedurës në ASHK, veprim ky i cili nuk paraqet situatën e saktë financiare të Llogarisë nr. 210 "Toka, troje, terrene" në bilancin e vitit 2023, si dhe në kundërshtim me pikën nr. 1 dhe 2, neni 37, kreu IV i Ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020; germa "a" dhe "b" të Ligjit nr.139/2015; Nenet 35-41, të VKM nr. 510, datë 10.06.2015, Kreu VI "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme"; Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, ; si dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, pikat 26-30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 83-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Vorë të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse në lidhje me gjendjen reale të pasurisë "troje" në sistemin financiar të institucionit. Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës të marrë masa për plotësimin dhe dorëzimin e të gjithë praktikave të pronave të certifikuara, në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, në përputhje me legjislacionin, për të pasur informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

#### ***Brenda 6 mujërit të parë të vitit 2025***

**13. Gjetje nga auditimi:** Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore në projektbuxhetin vjetor 2023, nuk ka paraqitur për miratim në Këshill, numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe Njësi Administrative në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 78, datë 27.12.2022 "Miratimi Projekt Buxhetit Afatmesëm 2023-2025 dhe detajimi buxhetit të vitit 2023", në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar neni 40, pika 3, germa "ç"; me nenin 54 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", me nenin 73 të "Rregullores për Funksionimin e Këshillit Bashkiak Vorë".

Nga verifikimi i numrit të punonjësve në Bashkinë Vorë në strukturën e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore rezultuan 5 punonjës mbi numrin e punonjësve të kësaj drejtorie, por pa tejkaluar numrin total të punonjësve për vitin 2023 të përcaktuar në Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 67, datë 18.05.2022 "Për miratimin e strukturës së Bashkisë Vorë dhe Njësi Administrative Prezë dhe Bërxullë për vitin 2022", në zbatim edhe përgjatë vitit 2023.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Vorë të paraqesë për miratim në Këshillin Bashkiak, numrin e punonjësve buxhetorë, për çdo njësi shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Vorë të marrë masa për zbatimin me korrektësi të strukturës së miratuar nga Kryetari Bashkisë, për çdo vit buxhetor.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore (DTTV), Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës përdorin program "Excel" për regjistrimin e të dhënave për tatimpagues të biznesit të madh, biznesit të vogël dhe kategorinë familjarë; për regjistrimet e veprimeve kontabël; për mbajtjen e regjistrit të aseteve të njësisë vendore.

Veprimet e kryera nuk paraqesin besueshmëri, pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë, mund të ndikojnë në pasaktësi të veprimeve e rrjedhimisht në rezultate jo korrekte. Kjo gjë rrit

riskun e moskuadrimin të drejtë dhe të saktë, si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore.

Mungesa e një programi të specializuar për menaxhimin e të dhënave, përveç gabimit njerëzor, mbart riskun e humbjes së të dhënave të rëndësishme për shkak të mungesës së backup-it automatik, veprime këto në mospërputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 12, germa “dh”; neni 29, pika 1; Ligjin nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4, pika 1; me pikat nr. 14 e 15, të nenit 3, si dhe neni nr. 11, i Ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; me pikat nr. 26-30 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-64, në pikën 2.3, faqe 64-83, pikën 2.4, faqe 83-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik për një menaxhim të sigurt dhe efikas të të ardhurave dhe shpenzimeve të njësisë, të marrë masa për kalimin në sisteme të avancuara dhe të integruara informatike, të cilët do të rrisin efikasitetin në menaxhim dhe kontrollin e brendshëm.

#### ***Brenda 6 mujërit të parë të vitit 2025***

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se njoftimet mbi detyrimet tatimore bëhen me shërbim postar ose dorazi, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat dhe informacionet e kërkuara dhe të vëna në dispozicion, rezultoi se, nuk janë analizuar si në total ashtu edhe për çdo zë tatimor nga ana e DTTV/ Bashkia Vorë.

Në Bashkinë Vorë, ndonëse numri i regjistrimeve të bizneseve të reja (244) ka ardhur në rritje, përsëri mbetet i lartë relativisht numri i bizneseve të mbyllura (106). Për këtë nga ana e Bashkisë Vorë, Koordinator i Riskut, GMS, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, nuk kanë bërë asnjë analizë mbi risqet që ndikojnë dhe që kanë krijuar këtë situatë, me qëllim marrjen e masave për hartimin e planeve periodikë e vjetorë, për minimizimin e rasteve të mbylljes së aktivitetit të subjekteve tatimpaguese, si dhe për të mbajtur në nivel të kënaqshëm të ardhurat që mbledhen nga aktiviteti i tyre, veprime këto që nuk janë në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 12, germa “dh”; neni 29, pika 1; Ligjin nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4, pika 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë të marrë masa për përmirësimin e marrëdhënies ndërmjet institucionit me komunitetin dhe biznesin, për njoftimin e tatimpaguesve për tarifa dhe taksa vendore, duke zëvendësuar njoftimin dorazi me njoftimin me postë ose me metoda bashkëkohore të komunikimit.

Njoftimet duhet të jenë të qarta, të sakta, si dhe të dërgohen në kohë për të ofruar mundësi të ndryshme në kryerjen e pagesave.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së inventarizimit fizik, vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve në Bashkinë Vorë për vitin 2023, u konstatua se fletët e inventarit të materialeve, si dhe procesverbalet e vlerësimit të tyre në Njësinë Administrative Prezë, janë firmosur nga kryetari i komisionit të inventarizimit, e cila është njëkohësisht edhe Përgjegjës materiale.

Në procesverbalet e mbajtur me zërat e materialeve të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi, nuk janë pasqyruar të dhënat: viti i vënies në punë, koha e përdorimit, vlerën e mbetur, si dhe norma e amortizimit të aktiveve.

Relacioni i përgatitur nga komisioni i asgjësimit të aktiveve dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë, nuk është i shoqëruar me asnjë dokument mbi procedurën e ndjekur dhe gjurmën e auditimit për riciklimin, groposjen apo djegien e aktiveve jashtë përdorimi.

Nga auditimi mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të aseteve, u konstatua se Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës në regjistrin e aseteve nuk evidentohet data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia. Për pasojë nuk është përmbushur detyrimi ligjor për krijimin e një regjistri fizik e të miratuar nga titullari i institucionit.

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me gërmën “ë” të pikës 4, neni 9, me gërmat “dh”, “e”, “f” të pikës 3, neni 12 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar. Me pikat nr. 26-30 dhe paragrafin nr. 82, 95 dhe 109, të kreut IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 64-83 dhe në pikën 2.4, faqe 83-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe Nëpunësi Zbatues i institucionit, të marrin masa që gjatë procedurave të inventarizimit, qarkullimit dhe nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve, të ndiqen të gjithë hapat sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor, me qëllim dokumentimin e gjurmës së auditimit dhe menaxhimin me efektivitet të tyre.

*Në vijimësi*

**16.2. Rekomandim:** Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës të marrë masa për krijimin e regjistrit fizik të aseteve, me të gjithë komponentët e duhur sipas kuadrit ligjor dhe të miratohet nga Kryetari i Bashkisë Vorë.

### ***Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2025***

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se plotësimi i Pasqyrës së Flukseve Monetare Cash Flow (F3) dhe Pasqyra e Aktiveve neto/Fonde neto (F4), nuk janë kryer në të gjitha rubrikat duke mosparaqitur informacion të detajuar të llogarive, veprim në kundërshtim me pikën 3.6 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto”, kapitulli III, i udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

Në Pyetëtorin dhe shënimet shpjeguese (F5) rezultuan të pa plotësuara e analizuar, pika 14 “Analiza për periudhën raportuese, përbërësit e aktiveve neto/fonde neto” dhe pika 15 “Zbërthimi me analizë e posteve të llogarive të investimeve në proces”. Veprimi nuk është bërë në përputhje me kërkesat e pikës nr. 3.7 “Rregullat për dhënien e shpjegimeve për pasqyrat financiare individuale”, i udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 dhe faqe 64-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar të marrë masa në plotësimin e të gjitha rubrikave dhe shënimeve në pasqyrat financiare, për të dhënë një pamje të përgjithshme e të plotë të tyre, në zbatim të kuadrit ligjor.

***Me mbylljen e PF të vitit 2024***

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, Bashkia Vorë ka ngritur një sistem pjesërisht efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, pasi nuk ka hartuar një

kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nga auditimi u konstatuan se nuk janë hartuar e miratuar: Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të vitit 2023, Plani i Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin të vitit 2023, Plani i Veprimit për arritjen e objektivave të vitit 2023 dhe Gjurmët standarde të auditimit të vitit 2023.

Në Bashkinë Vorë mungonte urdhri specifik, që përcakton në mënyrë të qartë personin që do të jetë koordinator i riskut, si dhe nuk rezultojnë të dokumentuara në formë shkresore, minutat e takimit për mbledhjet që ka kryer GMS, gjatë vitit 2023, veprime dhe mosveprime të cilat kanë sjellë risk në funksion të sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe mungesë të njohjes së plotë të kuadrit ligjor të kësaj fushe.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, 10, 16 dhe 27 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimit të Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nr. 16, datë 20.07.2016, pika 3, nënpika 3.2.2 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut në njësitë publike”; si dhe Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**18.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa në përditësimin dhe forcimin e aktivitetit të GMS, në mënyrë që GMS të ofrojë mbështetje dhe këshilla për vetë titullarin, si dhe të marrë masa për hartimin dhe miratimin e raporteve.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i organizimit dhe vlerësimit të veprimtarisë së auditit të brendshëm u konstatua se, NJAB në Bashkinë Vorë, është miratuar dhe ka funksionuar me Urdhër nr. 67, datë 18.05.2022, nr. 2647 prot., “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Vorë dhe njësive administrative Prezë dhe Bërxullë për vitin 2022” dhe ka vazhduar si e tillë edhe për vitin pasardhës 2023 (periudhën objekt auditimi), në të cilin përcaktohej se kjo njësi do përbëhej nga 4 punonjës, konkretisht 1 (një) përgjegjës dhe 3 (tre) specialistë ndërkohë që ka patur realisht 1 (një) punonjës përgjegjës për periudhën nga 31.05.2023 deri më 22.08.2023, 2 (dy) punonjës në pozicionin specialistë. Burimet në dispozicion të strukturës audituese kanë qenë të pa plota dhe me mungesë të përvojës së punës në auditim, me pasoja për arritjen e objektivave në sasi, por mund të çenojë dhe cilësinë e auditimeve nga NJAB. Për pjesën e mbetur të vitit 2023, struktura e NJAB ka qenë e pa plotësuar. Dy punonjësit në pozicionin e specialistit kanë respektivisht 3 dhe 4 vite eksperiencë në total, në fushën e auditimit, në kundërshtim me kërkesat e germës “c” të nenit 11, të Ligjit 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**19.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Vorë të marrë masa për plotësimin e pozicioneve vakante të strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm me auditues të kualifikuar dhe me përvojë, me qëllim përmbushjen e misionit dhe arritjen e objektivave të kësaj njësie.

#### ***Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2025***

**20. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Vorë, nuk ka përgatitur informacionin përkatës lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua, mungesë e gjurmës së raportimit në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, siç përcaktohet në nenin 50 - Auditimi i jashtëm, pika 4 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve dërguar nga KLSH me shkresën nr. 520/10 prot., datë 18.12.2023, janë lënë për zbatim 67 rekomandime nga të cilat:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 28 masa organizative, pranuar plotësisht, nga të cilat, 7 masa janë zbatuar plotësisht, 18 masa në proces zbatimi dhe 3 masa nuk janë zbatuar.
- b. Masa për shpërblim dëmi 1 rekomandim për kërkimin në rrugë ligjore duke ndjekur procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës 204,672 lekë, pranuar plotësisht dhe kanë ecurinë 1 rekomandim pa zbatuar.
- c. Masa për uljen e detyrimit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara), janë lënë 5 rekomandime në shumën 358,226 mijë lekë, të pranuar plotësisht dhe kanë ecurinë 4 masa në proces zbatimi, dhe 1 rekomandim pa zbatuar.
- d. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike, janë lënë 2 rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht, dhe të 2 masat janë pa zbatuar.
- e. 29 masa disiplinore, të pranuar dhe 29 rekomandime të zbatuar plotësisht.
- f. Njoftimi Departamentin të Administratës Publike dhe Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, 1 masë rezultoi e pa zbatuar.
- g. 1 masë administrative për vendosjen e sanksioneve administrative ndaj Operatorit Ekonomik “D” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori z. V. T., pa zbatuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 88-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**20.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, si dhe të marrë masat e nevojshme për zbatimin e masave pjesërisht të realizuara, të pa zbatuara dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe forcimin e disiplinës buxhetore dhe fiskale.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFЕКTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË TË ARDHURAT E MUNGUARA NGA TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, DHE NË MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENTË DHE EФЕКТИVITET TË TYRE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Përgjatë vitit 2023, listat e debitorëve nga “Taksa e Ndërtesës” për subjekte të biznesit të madh, rezultuan 22,983,583 lekë, debitorë biznes i vogël 6,623,381 lekë dhe debitorë familjarë 11,923,215 lekë, në total 41,530,179 lekë. Kjo ka ardhur si rezultat i veprimtarisë së pamjaftueshme të informimit dhe të sensibilizimit publik mbi pagesën e “taksës së ndërtesës” nga strukturat përgjegjëse të bashkisë, si dhe nga moszbatimi me rigorozitet i kërkesave të Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 i ndryshuar, neni 5; Aktiviteti i saj mjaftohet vetëm me njoftime të debitorëve, pa analizuar konfirmimin ose jo nga ana e tyre, duke çuar në mos marrjen e masave shtrënguese për të siguruar vjeljen e detyrimeve të prapambetura nga njëra anë dhe detyrimit vjetor në kohë nga ana tjetër, për të ulur si numrin e debitorëve edhe vlerën e detyrimit të akumuluar.

Listat e debitorëve nga taksa e ndërtesës, të krijuar gjatë vitit 2023, në vlerën 11,923,215 lekë, nuk janë dërguar në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar me qëllim kontabilizimin e detyrimeve vjetore dhe konsiderohen e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vorë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, gërma “dh”; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e

taksave vendore” i ndryshuar, nenin 4 pika 7, nenin 23 dhe 24; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenit 12 pika 1. VKB nr. 70/2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023” pika 3.2.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Vorë, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të pa kontabilizuar për tarifa dhe taksa vendore, të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimeve të pashlyera debitorë familjarë për vlerën 11,923,215 lekë, të nxjerrë njoftim vlerësimi për detyrimet e papaguara tatimore, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët për arkëtimin e tyre.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**2. Gjetje nga auditimi:** Listat e debitorëve nga taksa e tokës bujqësore, të krijuara gjatë vitit 2023, në vlerë 1,077,599 lekë, nuk janë dërguar në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar me qëllim kontabilizimin e detyrimeve vjetore dhe konsiderohen e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vorë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, germa “dh”; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, nenin 4 pika 7, nenin 23 dhe 24; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenit 12 pika 1; VKB nr. 70/2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023” pika 3.2.

Kryetari i Bashkisë nuk ka ngritur komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme për tokën bujqësore për verifikim e vërtetësisë së vetdeklarimit të sipërfaqes së tokës bujqësore të dorëzuar nga subjekti tatimpagues, në mospërputhje me Paketën Fiskale 2023, paragrafi I.2 “Taksa mbi tokën bujqësore”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandim:** Bashkia Vorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore në vlerën 1,077,599 lekë.

**2.2. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë të urdhërojë ngritjen komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme për tokën bujqësore për verifikim e vërtetësisë së vet deklarimit të sipërfaqes së tokës bujqësore të dorëzuar nga subjekti tatimpagues.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, lidhur me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për taksën e ndikimit në infrastrukturë, u konstatua se nga ASHK Drejtoria Vendore Kamëz - Vorë, janë dërguar listat e qytetarëve të shoqëruar me leje legalizimi.

Bashkia Vorë për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, nuk ka dërguar për kontabilizim në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, listat e detyrimeve të papaguara nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë, për Bashkinë Vorë në vlerë 1,226,188 lekë, për Njësinë Administrative Bërxullë në vlerë 1,141,617 lekë dhe për Njësinë Administrative Prezë në vlerë 524,469 lekë, në total 2,892,273 lekë, për rrjedhojë konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vorë dhe mos arkëtim nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, pasi nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 3/c, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, germa “dh”.

Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit në Bashkinë Vorë, nuk ka plotësuar paraprakisht regjistrin e vet elektronik me të dhënat që përmban vendimi për

lejen e legalizimit si numrin e Zonës Kadastrale, duke sjellë mungesë informacioni mbi detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për subjektet taksapagues persona juridik/fizik.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandim:** Bashkia Vorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 2,892,273 lekë.

**3.2. Rekomandim:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të regjistroje në kontabilitet detyrimet e pashlyera nga subjekte taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 2,892,273 lekë.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Tarifave dhe Taksave Vendore për vlerësimin dhe mbledhjen e të ardhurave nga “Tarifa e Pastrimit”, u konstatua se listat e debitorëve të subjekteve debitorë biznes i madh rezultuan 8,205,152 lekë, debitorë biznes i vogël rezultuan 2,703,296 lekë dhe debitorëve të kategorisë familjarë, rezultuan 7,397,258 lekë duke shtuar debitorët për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023, në total 18,305,705 lekë.

Listat e debitorëve nga tarifa e pastrimit, të krijuar gjatë vitit 2023, nga familjarë në shumën 7,397,258 lekë, nuk janë dërguar në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar me qëllim kontabilizimin e detyrimeve vjetore, të cilat konsiderohen e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vorë dhe mos arkëtim nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, nenin 4 pika 7 në, nenin 23 dhe 24; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenit 12, pika 1; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, gërma “dh”; VKB nr. 70/2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandim:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marri masa për arkëtimin e detyrimeve të pa kontabilizuar për tarifa e pastrimit në vlerë 7,397,258 lekë, duke nxjerrë njoftim vlerësimi për detyrimet e paguara tatimore, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve të pa kontabilizura për tarifa dhe taksa vendore.

**4.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të regjistrojë në kontabilitet detyrimet e pashlyera nga “Tarifa e Pastrimit” nga subjekte fizike, juridike dhe familjare në vlerë 18,305,705 lekë, duke nxjerrë njoftim vlerësimi për detyrimet e paguara tatimore, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve të pa kontabilizura për tarifa dhe taksa vendore.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**5. Gjetje nga auditimi:** Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vorë, u konstatua se në territorin nën juridiksionin e saj territorial ushtrojnë aktivitet të tregtimit me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre 15 subjekte të cilat duhet të jenë të pajisura me autorizim nga bashkia për tregëtim me pakicë të hidrokarbureve dhe duhet të paguajnë 6,400,000 lekë, detyrime për vitin 2023.

Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregëtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga 15 subjekte, subjekti “B T” nuk ka autorizim 5-vjeçar dhe për mungesë dokumentacioni nuk kanë përfutur autorizim. Gjatë vitit 2023, kanë autorizim dhe janë paguar pjesërisht detyrimet në vlerën 4,100,000 lekë total. Ndërsa 4

subjekte nuk kanë paguar detyrimin për ushtrimin e aktivitetin deri në 31.12.2023, në vlera 2,300,000 lekë, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 344, datë 19.04.2017, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vorë, pasi nuk rezultojnë debitorë në listat e debitorëve për vitin 2023, dërguar me shkresë nr. 608 prot., datë 13.05.2024.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandim:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për kontabilizimin e detyrimit, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur 2,300,000 lekë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **C. MASA PËR ULJEN E DETYRIMEVE TË PAPAGUARA TATIMORE DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave lidhur me detyrimet e pa arkëtuara në kohë nga të ardhurat tatimore vendore nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore; Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit u konstatua se për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023, debitorët e biznesit të madh u shtuan 39,133,169 lekë, debitorët biznes i vogël u shtuan 10,877,262 lekë, debitorët familjarë u shtuan 23,290,345 lekë. Debitorë ndër vite që i përkasin periudhës 2004 - 2020, nuk kanë pësuar ndryshim duke rezultuar në vlerën 27,219,428 lekë. Nga auditimi rezultoi se detyrimet e papaguara tatimore deri 31.12.2023, rezultuan në vlerën 376,288,910 lekë, kundrejt vlerës 302,825,456 lekë të raportuara nga Bashkia Vorë.

Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve nga taksat dhe tarifavat vendore të biznesit ose familjarë në shumën 46,244,026 lekë, si dhe mos raportimi për detyrimet e prapambetura që i përkasin periudhës 2004 - 2020 në shumën 27,219,428 lekë, në total +73,463,454 lekë, nuk paraqesin situatën reale të debitorëve. Mos regjistrimi i plotë i debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit mbi dokumentimin e proceseve dhe transaksioneve për vijueshmërinë nga lindja deri në arkëtimin e detyrimit.

Për debitorët e mësipërm të kategorisë biznese dhe familjarë, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore; Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nuk ka aplikuar masa shtrënguese në mënyrë shteruese, të tilla si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokim i shitjes së aktiveve në QKB, sipas kërkesave të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreun XI. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, i ndryshuar, nenet 88-107; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 2; Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 9 pika 1.3; Ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, neni 12 pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Grupi i Menaxhimit Strategjik të marrë masa për rakordimin e stokut të detyrimeve të papaguara për të gjitha strukturat e Bashkisë Vorë.

**1.2. Rekomandimi:** Grupi i Menaxhimit Strategjik të marrë masa për uljen e stokut të detyrimeve të papaguara, nga mos pagesa e tarifave dhe taksave vendore nga subjekte fizike, juridike dhe familjare, në vlerën 376,288,910 lekë, të krijuar deri 31.12.2023, duke aplikuar në mënyrë shteruese masa shtrënguese të tilla, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokim i

shitjes së aktiveve në QKB, si dhe rritur informimin dhe sensibilizimit publik mbi pagesën e tyre në dobi të komunitetit.

**1.3. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore; Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe drejtoritë e tjera që administrojnë të ardhura vendore, të marrë masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pashlyera nga të ardhurat vendore, të krijuara nga 01.01.2023 - 31.12. 2023, në shumën 46,244,026 lekë dhe raportimin e stokut të trashëguar për detyrimet e prapambetura që i përkasin periudhës 2004 - 2020 në shumën 27,219,428 lekë, në total 73,463,454 lekë.

**1.4. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kriterëve ligjore për sistemimin e vlerave debitoare.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Në territorin e Bashkisë Vorë, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, në total janë aktive 4 kontrata për dhënie me qira truall/ndërtesë, të lidhura me subjekte të ndryshme. Nga auditimi u konstatua se subjekti “A D” sh.p.k, i cili ka lidhur kontratë me afat 99 vite, me sipërfaqe 9,240 m<sup>2</sup>, me vlerë 3,049 USD në vit, nuk e kishte paguar detyrimin kontraktor.

Për periudhën 2016-2023, detyrimi i papaguar është 7,921,949 lekë, e cila përfshin qira vjetore 2,653,361 lekë, qira ndërtesë 4,424,940 lekë dhe qira trualli 843,648 lekë. Vetëm për vitin 2023, subjekti “A D” sh.p.k paraqitet debitor ndaj Bashkisë Vorë, në shumën totale 603,564 lekë qira trualli dhe ndërtesë, si dhe 3,049 USD qira vjetore, vlera të cilat konsiderohen të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Vorë dhe të shtetit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 83-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandim:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik në Bashkinë Vorë, të marrin masa në ndjekjen e të gjitha hapave administrative e ligjore, për të arkëtuar vlerën prej 7,921,949 lekë nga subjekti debitor “A D” sh.p.k, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9396, datë 12.05.2005, “Për qiratë financiare”, i ndryshuar, neni 28 e vijues, me procedurat si vijon:

- T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.
- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit.
- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare, subjekti nuk paguan detyrimet, nga ana e Sektorit të Tatim-Taksave të merren masa administrative, deri në sekuestro.
- Të bashkërendojnë punën me Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).
- T’i drejtohet gjykatës kompetente për zgjidhje të kontratës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **D. MASA DISIPLINORE**

### **D.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE**

#### **D.1.1 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, gërma “c”; Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58 “Llojet e masave

disiplinore”; në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vorë dhe Komisionit Disiplinor të kërkojnë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

**“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58, germa “c” për nëpunësit e mëposhtëm:**

**1. Znj. A.D**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe me cilësinë e autorizuar si NZ, nga data 23.08.2023 e në vazhdim.

- Për mos marrjen e masave për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimin e detyrimeve të reja për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, sipas përcaktimeve në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin vjetor “Për buxhetin e shtetit”, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.

- Në mos kryerjen e klasifikimit të saktë të aktiveve si dhe sistemimin e vlerave me kosto historike së bashku me vlerën e amortizimit të përlllogarit, në kundërshtim me pikat nr. 2, 10 dhe 21 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, i përmirësuar. Si dhe me kapitullin III, të udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

- Për mos marrjen e masave në kontabilizimin e të gjithë vlerave debitore të trashëguara në vite.

- Në mos marrjen e masave gjatë procedurave të inventarizimit, qarkullimit dhe nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor me qëllim dokumentimin e gjurmës së auditimit dhe menaxhimin me efektivitet të tyre në kundërshtim me nenin 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit zbatues” të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Me paragrafin nr. 82, nr. 95 dhe 109 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë Publike”, i ndryshuar.

**2. Z. G. D**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

- Për mos dërgimin e detyrimeve të papaguara për kontabilizim, nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë, për Bashkinë Vorë në vlerën 1,226,188 lekë, për Njësinë Administrative Bërxullë në vlerën 1,141,617 lekë dhe për Njësinë Administrative Prezë në vlerën 524,469 lekë, në total 2,892,273 lekë, në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vorë, në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 3/c, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22.

- Për mos marrjen e masave dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore në vlerën 1,077,599 lekë dhe në arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 2,892,273 lekë.

**3. Z. I. D**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës.

- Për mos marrjen e masave në përgatitjen e dosjeve me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK të pasurive pa certifikatë pronësie, me qëllim pajisjen e pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

- Për mos krijimin e regjistrit fizik të aseteve, me të gjithë komponentët e duhur, sipas kuadrit ligjor.

- Për mos plotësimin dhe dorëzimin në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, e të gjithë praktikave të pronave të certifikuara, në përputhje me legjislacionin, në kundërshtim me nenin 37, të Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me nenin 122-125 “Detyrat dhe Përgjegjësitë” e Drejtorisë së Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Vorë.

**4. Znj. M. M,** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Teknologjisë dhe Inovacionit, nga data 01.01.2023 deri në 08.08.2023.

- Për mos zbatimin me korrektësi të strukturës së miratuar nga Kryetari Bashkisë, për çdo vit buxhetor.

- Për mos hartimin e programeve të trajnimeve për punonjësit lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës së institucionit si dhe vlerësimin periodik të nevojave për trajnimin e stafit në lidhje me zbatimin e instrumenteve të kontrollit të brendshëm.

**5. Znj. A.H,** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Teknologjisë dhe Inovacionit, nga data 08.08.2023 e në vazhdim.

Në detyrën e Drejtorit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Teknologjisë dhe Inovacionit

- Për mos hartimin e programeve të trajnimeve për punonjësit lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës së institucionit si dhe vlerësimin periodik të nevojave për trajnimin e stafit në lidhje me zbatimin e instrumenteve të kontrollit të brendshëm.

**6. Z. A. L,** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Biznesit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

- Për mos zbatimin e detyrave funksionale lidhur me hapat administrative dhe ligjorë në evidentimin e plotë të debitorëve të biznesit të madh e të vogël, krijuar në vitin 2023, si dhe mos dërgimin për kontabilizim në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar. Veprime në kundërshtim me nenin 23 “Përgjegjësitë”, të Ligjit nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe me nenet 71-75, “Drejtoria e Taksave dhe Tarifave”, të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Vorë.

**7. Znj. K. O,** me detyrë Përgjegjës i Sektorit Familjar, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

- Për mos zbatimin e detyrave funksionale lidhur me hapat administrative dhe ligjorë në evidentimin e listës së debitorëve kategoria familjarë, të mbartura dhe krijuar gjatë vitit 2023, nga taksa e ndërtesës, nga taksa e tokës bujqësore, nga tarifa e pastrimit, si dhe mos dërgimin për kontabilizim në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni nr. 4; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 12; VKB 70/2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023” pika 3.2, si dhe me nenet 71-75, “Drejtoria e Taksave dhe Tarifave”, të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Vorë.

**8. Znj. M. D,** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Statistikave dhe Menaxhimit të Borsit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

- Për mos zbatimin e detyrave funksionale lidhur me hapat administrative dhe ligjorë në për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga taksat e tarifave vendore, veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;

Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI, si dhe me nenet 71-75, “Drejtoria e Taksave dhe Tarifave”, të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Vorë.

**“Vërejtje” neni 58, germa “a” për nëpunësit e mëposhtëm:**

**1. Znj. L. S,** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Buxhetit, në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar.

- Për moszbatimin e detyrave funksionale lidhur me hapat administrative dhe ligjorë në planifikimin e buxhetit të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025, sipas përcaktimeve në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin vjetor “Për buxhetin e shtetit”, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit; nenet 49-50, “Drejtoria e Taksave dhe Tarifave”, të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Vorë.

**2. Z. D. K,** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit dhe Zbatimit të Buxhetit, në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar.

- Për moszbatimin e detyrave funksionale lidhur me hapat administrative dhe ligjorë në monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025, sipas përcaktimeve në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin vjetor “Për buxhetin e shtetit”, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit; nenet 49-50, “Drejtoria e Taksave dhe Tarifave”, të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Vorë.

**D.1.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:**

Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kontratën individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vorë që, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

**“Vërejtje”, për punonjësit e mëposhtëm:**

**1. Znj. E. E,** me detyrë zv/Kryetar i Bashkisë Vorë, në cilësinë e Kryetarit të komisionit të asgjësimit të aktiveve për vitin 2023.

- Për mos dokumentimin e procedurës së ndjekur dhe gjurmën e auditimit për riciklimin, groposjen apo djegien e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi. Veprim ky në kundërshtim me pikën nr. 109, 118 dhe 121 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”, të ndryshuar.

**2. Znj. E. M,** me detyrë Administrator i Njësine Prezë, në cilësinë e Kryetarit të komisionit të inventarizimit të aktiveve të vitit 2023.

- Për mos zbatimin e saktë të procedurave në inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të Njësise Administrative Prezë, pasi ka nënshkruar në cilësinë e kryetarit të komisionit të inventarizimit dhe njëkohësisht edhe si përgjegjës i materialeve në këtë njësi. Veprim ky në kundërshtim me paragrafin nr. 82, të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë Publike”, i ndryshuar.

## **D.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR**

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

## **D.3. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Vorë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Teknologjisë dhe Inovacionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecursë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**